Rruga e Arbërit

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 8 (124). GUSHT 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Te çdo fis e kullë nën kurorën e Runjës…
Nga **Mevlud Buci**



Mali i Robit, mes dibranëve gazmorë
Nga **Abdurahim Ashiku**



Kooperativa **Tifeku**, një shembull i rrallë
Nga **Osman Xhili**



■ **Kandidatët** nuk i përgjigjen ftesës për botimin e programeve elektorale ■ **Peshkopia**, qyteti në agoni ■ **Muhurri**, vështrim ekonomik, historik dhe etnokulturor ■ **Gjeologët** dibranë që i dhanë atdheut thesare… ■ **Dibra e Arbrit** ■ **Një libër** që përcjell mesazhe mbresëlënëse ■ **"Takimet e Rekës së Epërme"** rikthejnë gjallërinë në vendbanimet e boshatisura ■ **Mes refugjatëve** dibranë në Tiranë ■ **Hasan Çipuri**, "ky është vetëm fillimi…" ■ **Dy gëzimet** e Selman Mëziut ■ **Okshtuni** në këngët e trimërisë ■ **Promovimi** i librit 'Blegërimat e dashurisë'… ■ **Më fal** Floran! ■ **I kishte** hije fjala dhe pritja

Premtime për Rrugën e Arbrit

■ **Rruga e Arbrit, premtim i pambajtur i qeverive në 20 vite**
■ **'Mbështesim çdo vendim që do të çojë në nisjen e punimeve në Rrugën e Arbrit'**
■ **Fjala e Edi Ramës duhet të jetë plasja e minave në tunelin e Qafë Murrizës**



Pamje nga punimet pranë Urës së Vashës. Foto e datës 4.09.2016

2-3

KNAUF Bashkëpunon me komunitetin
www.knauf.al

cyan magenta yelloë black 1

KUJTOJMË BASHKËPUNËTORËT tanë se çdo shkrim i botuar në një media tjetër apo rrjete sociale nuk ka përparësi botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

Faleminderit për mirëkuptimin!

REDAKSIA U KËRKON NDJESË LEXUESVE TË SAJ, VEÇANËRISHT ATYRE QË JANË TË PAJTUAR, PËR DALJEN ME VONESË TË KËTIJ NUMRI!

Faleminderit për mirëkuptimin!

Rruga e Arbrit, premtim i pambajtur i qeverive në 20 vite

Rruga e Arbrit, ajo që lidh shumë shkurt Dibrën me Tiranën, ia ka dalë edhe njëherë të bëhet çështje elektorale, ndoshta më shumë se ç'duhet. Të majtë e të djathtë përpiqen që me këtë çështje të bëjnë me faj kundërshtarët, por për pak e për shumë, të dyja janë të përfshira në atë që mund të quhet si "Premtimi i pambajtur" gjatë 20 viteve rresht.

Me herët, çështjen e rrugës e kishte përmendur Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, e cila disa muaj më parë organizoi një tubim elektoral në Dibër, ndërsa deputetja e kësaj partie, zgjedhur me votat e Partisë Demokratike në qarkun e Fierit, zhvilloi një interpelancë parlamentare në fillim të qershorit.

Por kur Presidenti i Republikës shpalli datën e zgjedhjeve për kreun e Bashkisë së Dibrës, të dyja partitë politike, PD dhe PS, së bashku me aleatët e tyre, iu kthyen çështjes së Rrugës së Arbrit. Ndoshta se rruga për t'i çuar në Peshkopi i lodhi, por edhe se e kuptuan se kjo është e vetmja çështje e ndjeshme për elektoratin dibran.

Më 23 gusht, ditën e çlirimit të Dibrës, PS dhe aleatët e saj zgjodhën të prezantonin kandidatin e tyre, dhe ishte deputeti i PDIU-së nga Elbasani, Aqir Rakipi, që e pyeti kryeministrin Rama: "Zoti Kryeministër, sot, a u lodhe me këtë rrugë apo jo? Ti sot erdhe dhe është gjithë ajo rrugë, po ky popull që e bën përditë këtë rrugë?!"

Më i drejtpërdrejtë ishte deputeti i LSI-së, Luan Rama, i cili ka një lidhje të fortë me Dibrën, që nga fëmijëria.

"I bashkohem zërit të dibranëve, - tha ai. Zoti kryeministër, ndërtoje Rrugën e Arbrit, sepse është një nder që e meriton Dibra, sepse është një detyrim që e kemi ndaj Dibrës. Në 25 vjet kemi premtuar për Rrugën e Arbrit, por nuk kemi bërë gjë".

"Për sa i përket Rrugës së Arbrit, Rama tjetër (Luan – B.K.) tha një të vërtetë, theksoi gjatë fjalës së tij kryeministri Rama, që në 20 e ca vjet, të gjithë e kemi premtuar dhe nuk e kemi bërë. Unë e kam premtuar, por akoma nuk mund të thoni që nuk e kam bërë. Sigurisht, unë kam barrën që të bëj gjërat që dëshirojnë të gjithë anëtarët e koalicionit, – kjo është detyra ime dhe unë nuk ankohem për këtë detyrë, sepse e kam marrë me dëshirë dhe vullnet të madh, – por unë po ju them këtu, që unë nuk do të largohem nga zyra e Kryeministrit , pa bërë Rrugën e Arbrit."

Fjala e kryeministrit ngjalli reagime në rrjetet sociale, por edhe te kundërshtarët politikë.

Rruga e Arbrit është përdorur si çështje elektorale edhe nga opozita. "Ne që e nisëm, ne do ta përfundojmë Rrugën e Arbrit. Ne e filluam Rrugën e Arbrit. Ne dhamë para nga Buxheti i Shtetit", - tha zoti Basha gjatë fjalës së tij në takimin prezantues më 26 gusht në Peshkopi.

Edhe në takime të tjera, zoti Basha është marrë me këtë çështje, duke shprehur angazhimin e tij për "të përfunduar Rrugën e Arbrit, e cila u nis nga qeveria e Partisë Demokratike dhe do të përfundohet prej saj."

Zoti Basha shkon edhe më tej duke akuzuar qeverinë se e ka përdorur këtë çështje për korrupsion.

"E gjetën gati projektin për Rrugën së Arbrit. E gjithë bota e ka marrë vesh që është prish me bankën kineze për shkak se kanë kërkuar ryshfet 40 milionë euro për të ndërtuar tunelin, prandaj nuk u ndërtu tuneli", - theksoi kryetari i opozitës gjatë një takimi me banorët e Shimçanit.

Nga ana tjetër, Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, e preku këtë çështje gjatë një takimi elektoral në fshatin Grevë të njësisë administrative Melan.

"Mos harroni se është një premtim prej 20 vitesh që për herë të parë konsiderohet si një projekt serioz në tryezë të qeverisë. Unë nuk kam nevojë ta përsëris, por e kam me shumë dëshirë ta theksoj se kjo qeveri ka për ta bërë rrugën e Dibrës, në daç Rrugën e Arbrit, në daç rrugën nga Librazhdi", theksoi Ahmetaj.

Për Rrugën e Arbrit është folur vazhdimisht se një kompani kineze ka shfaqur interesim, por negociatat kanë zgjatur më shumë se çfarë ishte parashikuar më parë.

As edhe ligji i miratuar në Parlament në prill 2015, nuk bëri të mundur që negociatat dhe fillimi i punimeve të përshpejtohej.

Kohët e fundit u fol se marrëveshja e negociuar ka qenë pa interes për qeverinë shqiptare, por gjatë një vizite të Ministrit të Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati në Kinë, është folur përsëri për këtë çështje.

Duke folur për marrëveshjet e bashkëpunimit dhe investimeve kineze në Shqipëri, Bushati theksoi për Radion e Jashtme të Kinës CRI, më 26 gusht se "Një projekt i rëndësishëm për ne në këtë drejtim është ai i Rrugës së Arbrit, për të cilin jemi në fazën finale të bisedimit me autoritetet kineze dhe arrijmë një marrëveshje të pranueshme dhe të zbatueshme nga palët. Ky është një projekt i rëndësishëm i ndërlidhjes, jo vetëm midis Shqipërisë dhe Maqedonisë, por shkon gjithashtu edhe në funksion të transformimit rrënjësor të Portit të Durrësit dhe krijimit të aksesit të duhur jo vetëm për shqiptarët, por përgjithësisht për qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke e kthyer Portin e Durrësit në portën kryesore hyrëse për vendet e Ballkanit Perëndimor".

Tashmë nuk ka asnjë dyshim se forcat politike në Shqipëri, por edhe qeveria, është e ndërgjegjshme se Rruga e Arbrit është një arterie kryesore që i mungon Shqipërisë. Tani veç mbetet të punojmë për realizimin e saj, në mënyrë që edhe partitë, në fushatat e ardhshme, të gjejnë çështje të tjera për të debatuar!

B.KAROSHI

EDI RAMA: "Për sa i përket Rrugës së Arbrit, Rama tjetër tha një të vërtetë, që në 20 e ca vjet, të gjithë e kemi premtuar dhe nuk e kemi bërë. Unë e kam premtuar, por akoma nuk mund të thoni që nuk e kam bërë. Sigurisht, unë kam barrën që të bëj gjërat që dëshirojnë të gjithë anëtarët e koalicionit, – kjo është detyra ime dhe unë nuk ankohem për këtë detyrë, sepse e kam marrë me dëshirë dhe vullnet të madh, – por unë po ju them këtu, që unë nuk do të largohem nga zyra e Kryeministrit , pa bërë Rrugën e Arbrit."

LULZIM BASHA: "Ne që e nisëm, ne do ta përfundojmë Rrugën e Arbrit. Ne e filluam Rrugën e Arbrit. Ne dhamë para nga Buxheti i Shtetit

ARBEN AHMETAJ: "Mos harroni se është një premtim prej 20 vitesh që për herë të parë konsiderohet si një projekt serioz në tryezë të qeverisë. Unë nuk kam nevojë ta përsëris, por e kam me shumë dëshirë ta theksoj se kjo qeveri ka për ta bërë rrugën e Dibrës, në daç Rrugën e Arbrit, në daç rrugën nga Librazhdi".

DITMIR BUSHATI: "Një projekt i rëndësishëm për ne në këtë drejtim është ai i Rrugës së Arbrit, për të cilin jemi në fazën finale të bisedimit me autoritetet kineze dhe arrijmë një marrëveshje të pranueshme dhe të zbatueshme nga palët".



Punimet në Rrugën e Arbrit. Foto: B.Karoshi / 14 qershor 2008

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 8 (124). 1 - 31 Gusht 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA

Kontribuan për këtë numër:
Xhafer MARTINI
Bujar M.Hoxha
Edison YPI
Nazmi KOÇI
Ramiz GJINI
Renato TOTRAKU
Mirdash SHEHU
Mevlud BUCI
Faik XHANI

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

URIM!

Kolegia jonë, znj. **Sashenka Ndreka**, u martua në fund të muajit me z. **Besfor Laçi**!

Ne i urojmë çiftit Jetë të lumtur dhe me Trashëgime!

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Reagim i Grupit të Lobimit në lidhje me komentin e Edi Ramës për Rrugën e Arbërit në prezantimin në Peshkopi të kandidatit socialist për bashkinë e Dibrës

‘Mbështesim çdo vendim që do të çojë në nisjen e punimeve në Rrugën e Arbrit’

Gupi i lobimit për Rrugën e Arbrit ka ndjekur me interes të veçantë vizitën dhe fjalën e Kryeministrit Edi Rama në takimin prezantues të kandidatit të së majtës për drejtimin e Bashkisë së Peshkopisë dhe anëtarëve të tjerë të koalicionit.

Ne vëmë re me shqetësim se politikanët shqiptare nuk kanë mësuar të flasin me programe dhe në bazë të premtimeve, por sipas interesave të tyre të momentit.

Ne mendojmë se Kryeministrit do t’i shërbente më mirë heshtja rreth kësaj çështje. Duke folur dhe duke ripremtuar, ai i është bashkuar armatës së madhe të politikanëve majtas e djathtas, deputetëve, ministrave e kryeministrave paraardhës, duke dëshmuar kështu se rreth Dibrës askush nuk ka folur e punuar seriozisht deri më tani.

Edi Rama ka premtuar në fushatën e kaluar se Rruga e Arbrit është një nga prioritetet e kësaj qeveria dhe në programin e saj, zhvillimi i infrastrukturës në vend nis nga Rruga e Arbrit.

Premtimi se ai nuk largohet nga posti pa mbaruar rrugën e Arbrit është i papranueshëm për ne. Ne nuk na interesson se kush është kryeministër kur rruga të ndërtohet, por se cili kryeministër e çon procesin përpara.

Edi Rama u ripremton dibranëve premtimin për Rrugën e Arbërit ndërsa mandatit të tij po i vjen fundi,

Rama ka një tabor këshilltarësh, mes tyre edhe dibranë, por me sa duket asnjëri prej tyre nuk pati zemër t’i thonte se përse heshtja rreth çështjes së rrugës së Arbrit në takimin e fundit në Peshkopi do t’i bënte më mirë fushatës së tij. Rama nuk ka kohë të merret me intelektualë që nuk i bëjnë temenara. Por ne do të kemi kohë të merremi me të për aq kohë sa do të zgjas mandati aktual.

Në besojmë se çështja e ndërtimit të Rrugës nuk është çështje partie, por është një detyrim që qeveria shqiptare ua ka banorëve të këtyre krahinave. Dibra nuk ka kërkuar shumë nga qeveria: vetëm një rrugë prej 20 vitesh. Çdo premtim tjetër ka qenë i parëndësishëm.

Ne do të vazhdojmë lobimin rreth kësaj çështje. Tani që procesi po vonohet, ne kemi detyrim që angazhohemi më shumë, në mënyrë që ta bindim qeverinë se çdo vonesë në këtë proces është përpjekje për të lënë një Dibër të pazhvilluar e të paintegruar dhe një Shqipëri të prapambetur.

Më poshtë ju ftojmë të lexoni një koment rreth fjalës së Kryeministrit Rama në Dibër në lidhje me premtimet për rrugën e Arbrit, me konkluzionet e së cilës ne pajtohemi plotësisht.



Në besojmë se çështja e ndërtimit të Rrugës nuk është çështje partie, por është një detyrim që qeveria shqiptare ua ka banorëve të këtyre krahinave. Dibra nuk ka kërkuar shumë nga qeveria: vetëm një rrugë prej 20 vitesh. Çdo premtim tjetër ka qenë i parëndësishëm.

Ne do të vazhdojmë lobimin rreth kësaj çështje. Tani që procesi po vonohet, ne kemi detyrim që angazhohemi më shumë, në mënyrë që ta bindim qeverinë se çdo vonesë në këtë proces është përpjekje për të lënë një Dibër të pazhvilluar e të paintegruar dhe një Shqipëri të prapambetur.

Opinion

Nga ***BUJAR KAROSHI***

Fjala e Edi Ramës për Rrugën e Arbrit duhet të jetë plasja e minave në tunelin e Qafë Murrizës

Kryeministri ishte në Peshkopi për të prezantuar kandidatin e PS për bashkinë e Dibrës dhe, sigurisht, ka bërë bilancin e punëve të qeverisë së tij në këtë rreth për të përgatitur fjalimin.

Me siguri që rezultatet nuk kanë qenë pozitive, sidomos përsa i përket njërës nga çështjes më kryesore, ndërtimit të hidrocentraleve mbi Drin; Katundi i Ri dhe Skavicës. Kështu që për të mbushur fjalimin, i mjafton të merret me çështjen e Rrugës së Arbrit. Sepse kjo ka qenë një kërkesë e vjetër dhe e vetme e dibranëve dhe tani edhe gënjeshtër të thuash rreth saj, vijnë si ninulla dhe të vënë gjumë me ëndrrra të bukura.

Nga fjalimi i Ramës (Kryeministër) në prezantimin e Ramës (Muharem) për kryetar Bashkie në Dibër, po shkëpusim vetëm paragrafin më poshtë:

“Përsa i përket rrugës së Arbrit, Rama tjetër (Luan – B.K.) tha një të vërtetë, që në 20 e ca vjet, të gjithë e kemi premtuar dhe nuk e kemi bërë. Unë e kam premtuar, por akoma nuk mund të thoni që nuk e kam bërë. Sigurisht, unë kam barrën që të bëj gjërat që dëshirojnë të gjithë anëtarët e koalicionit, – kjo është detyra ime dhe unë nuk ankohem për këtë detyrë, sepse e kam marrë me dëshirë dhe vullnet të madh, – por unë po ju them këtu, që unë nuk do të largohem nga zyra e Kryeministrit , pa bërë Rrugën e Arbrit.”

Nuk mund të themi që kryeministri bën mirë që flet për Rrugën e Arbrit, por do të ishte më mirë që tani të mos fliste fare. Sepse ai me vetëdije ka heshtur gjatë tri viteve në qeverisje, duke krijuar përshtypjen se kjo çështjë është në dorën e tij dhe procesi do të vazhdojë sipas dëshirës së tij.

Nga pikëpamja politike Edi Rama mund të mos e mbajë premtimin për Rrugën, pasi partia e tij nuk i ka marrë shumicën e votave në këtë qark, por gjatë fushatës së kaluar ai kishte premtuar se nuk e shikonte këtë çështje si premtim partiak, por si “një projekt kombëtar shumë të rëndësishëm për Shqipërinë”.

Kryeministri do të flasë sërish deri më 11 shtator për Dibrën dhe, sigurisht, që do të përmendë edhe Rrugën e Arbrit, por ndoshta heshtja rreth kësaj çështje do t’i bënte më mirë fushatës së tij, sepse:

Së pari, Edi Rama nuk duhet ta fusë këtë premtim si një kërkesë të partive të koalicionit, se po të ishte për premtimet e LSI dhe PDIU, ne na mjaftonin gënjeshtrat e PD dhe paraardhësit të tij;

Së dyti, Edi Rama ka heshtur ndaj zërit të shoqërisë civile që ka kërkuar, së paku tri vitet e fundit një investim që të garantojë standardet e ndërtimt të rrugëve. Qeveria jo vetëm ka heshtur, por edhe ka investuar në disa segmente të filluara më parë në shkelje të këtyre standardeve. Edi Rama mund ta mbajë fjalën që të ndërtojë një rrugë që do të lidhë Zall Bastarin me Klosin e Bulqizën, por me këtë standard ndërtimi të reklamuar deri më tani, ajo nuk ka për të qenë Rruga e Arbrit – siç e ka edhe emrin;

Së treti, Rama kryeministër ka qenë jotransparent rreth kësaj çështje. Në negociatat me kompaninë kineze, në vend që të angazhonte një deputet dibran, edhe i PD të ishte, ai ia besoi negociatat Koço Kokëdhimës, deri dje njëri nga deputetët më të besuar të tij;

Së katërti, Edi Rama hoqi nga detyra e Ministrit të Financave deputetin e Dibrës pikërisht në kohën që pritej firma për Rrugën e Arbrit. Dhe heqja e tij ishte sinjal shumë i keq për Dibrën. Ishte Cani që kryesonte listën e PS në këtë qark, që bëri që e majta të fitonte pak më shumë vota në zgjedhjet e kaluara, sigurisht më pak se PD, por që i dhanë të majtës një deputet më shumë. Ishte emri i Canit që njerëzit besuan Edi Ramën për premtimet e Rrugës së Arbrit.

Së pesti, Edi Rama nuk duhet të fliste për Rrugën e Arbrit, pasi deputetët e tij prej tri vitesh i kanë etiketuar anëtarët e shoqërisë civile që lobojnë për këtë çështje si “ushtarë të SHQUP-it”, vetëm e vetëm se ata janë përpjekur ta nxisin qeverinë të ecë përpara në këtë proces dhe i kanë kujtuar vazhdimisht premtimet e pambajtura.

Së gjashti, Edi Rama nuk duhet të fliste për Rrugën e Arbrit në Dibër, pasi ai tri gjëra pati premtuar tre vite më parë për dibranët: Rrugën e Arbrit, Rrugën e Arbrit dhe Rrugën e Arbrit. Së paku, të martën duhet të kishte folur që njërën e ka realizuar ose sapo e ka filluar;

Së fundi, Edi Rama nuk duhet të flasë më për Rrugën e Arbrit sa kohë do të jetë në postin e Kryeministrit. Fjala e fundit e tij duhet të jenë “minat” në tunelin e Qafës së Murrizit. Në qoftë se nuk e bën këtë sa më shpejt, nuk ka asnjë arsye pse të mbahet mend në Dibër.

Ndërsa sa për Rrugën, shumë shpejt vjen fushata tjetër dhe historia e ndërtimit të saj do të fillojë nga e para… Siç ka ndodhur periodikisht çdo katër vjet, që nga viti 1996!



Më shumë rreth kandidatit të PS shih në linkun më poshtë: https://www.facebook.com/muharem.rama.official/



Më shumë rreth kandidatit të PD shih në linkun më poshtë: https://www.facebook.com/sherefedinshehu.al/?fref=ts

Kandidatët nuk i përgjigjen ftesës për botimin e programeve elektorale

Dy kandidatët për kreun e Bashkisë së Dibrës nuk iu përgjigjën ftesës së gazetës për të botuar programet e tyre elektorale.

Një mesazh i nisur më 26 gusht në profilet e tyre publike në FB mbeti pa përgjigje.

Në mesazh thuhej se "gazeta vendoste në dispozicion të tyre një hapësirë të konsiderueshme për botim të platformës së tyre elektorale".

Aty shprehej angazhimi ynë për të ruajtur pavarësinë në përcjelljen e informacionit, kështu që prisnim prej tyre një material të gatshëm për botim. Gjithashtu, shprehej edhe dëshira se lexuesit tanë, përtej debateve të ditës, janë të interesuar për programet e tyre elektorale dhe çështjet kryesore me të cilat ata do të përballeni gjatë muajve të parë të mandatit, në qoftë se do shpalleshin fitues.

Pavarësisht mungesë së dëshirës së tyre në lidhje me ftesën tonë, redaksia i ka ndjekur me vëmendje veprimtaritë e tyre gjatë kësaj fushate dhe ka ruajtur në arkivat e saj çdo premtim elektoral, në çdo fshat ku ata kanë shkuar dhe do të vazhdojnë të shkojnë deri më 11 shtator.

Në mbetemi të angazhuar edhe në të ardhmen për të parë realizimin në terren të premtimeve të tyre, duke i shërbyer kështu publikut: me informacion të paanshëm dhe të vërtetë!

Gazeta "Rruga e Arbërit", ashtu si edhe në të kaluarën, mbetet e angazhuar për të qenë një gazetë e lirë, e pavarur dhe në shërbim të publikut! Duke ruajtur këto parametra lirie, ajo do të bëjë përpjekjet edhe me kryetarin e ardhshëm të Bashkisë së Dibrës, ashtu si edhe me tre kryetarët e tjerë të bashkive të qarkut, Bulqizës, Klosit dhe Matit, në mënyrë që të përcjellë te publiku çdo informacion në shërbim të tyre!

Redaksia

Mediat e tjera për Dibrën — **tesheshi.com**

Peshkopia, qyteti në agoni

Nga **Bujar M. HOXHA**

Qyteti i ngjan një përshkrimi të Markezit... Rrugët, pluhuri, njerëzit, zbrazëtia, heshtja, të gjitha të duket sikur i përjeton në një vepër të tij.

Vdekja ka kohë që ka afruar, mbetet vetëm që ajo ta pushtojë me të dhënë shpirt dhe i fundit ish-banor i qytetit të vjetër, të atij plot dritë, plot pastërti, tërë gjallëri, me djem e vajza për t'i patur zili, me gjelbërim e erë bliri pa fund.

Në agoni është Peshkopia, në agoni duken të jenë njerëzit, ndërtesat, gjithçka e përbën një qendër të madhe të banuar.

Qyteti po shndërrohet në varrezë, ndërsa varreza është shndërruar në qytet. Ti i hedh hapat pa zemër, ngurrues, ndërsa ngado sheh një gri mjeruese. Kërkon të gjesh diçka nga fëmijëria, nga rinia, por më kot... I lebetitur kërkon ta kthesh pas të shkuarën, por nuk mundesh. Veçse ka një zgjidhje: shko në varreza!

Aty është qyteti i dikurshëm. Aty mund të ndeshësh ata me të cilët je rritur, ata që i ke dashur e ata që nuk i ke honepsur, ata me të cilët je përqafuar e ata me të cilët je zënë, dashuritë e shkuara, por edhe urrejtjet e shkuara. Aty je ti, edhe pse është thjesht çështje kohe kur do bashkohesh me ta. Me qytetin ku jetohet sot nuk të lidh asgjë. Eshtë çështje kohe kur ti të mos guxosh më as të hedhësh këmbë në atë vend.

Dikur, kur qyteti niste e shfaqej në horizont pas udhëtimit të gjatë, pritja ishte e mundimshme për t'iu afruar sa më pranë, për t'u gjendur në të.

Ishte provincë, por një provincë e tillë ku vërtet dëshiroje të jetoje. Ai qytet i vogël kishte gjithçka, jetën e gjallë, njerëzit e gjallë, kulturën, sportin, bulevardin, blirin, trëndafilin, hijeshinë, pastërtinë, bujarinë e mikpritjen. I ardhuri e ndjente menjëherë veten në shtëpi nga krahëhapja.

Qyteti ishte i shtresëzuar, çdokush gjendej në vendin e vet! Një rregullsi e pashkruar e mbante atë në binarë, për të mos shkelur askush përtej cakut të lejuar.

Me një industri të lehtë të përparuar për kohën, me llixhat e njohura, por edhe me jetën kulturore e sportive, Peshkopia ishte një vend ku ta kishte ënda të jetoje.

Dilemat ishin të vogla, por të këndshme. Të shkoje në kinema, në teatër, në një shfaqje estrade, apo ta kaloje mbrëmjen në të zakonshmen shëtitje në bulevard, të ndiqje një ndeshje futbolli apo volejbolli, t'i kaloje orët mes leximit apo t'u bashkoheshe shokëve për t'u freskuar në ujërat e Drinit, të rrëshqisje me ski apo të qëndroje mes të ngrohtit përkëdhelës të sobës dhe kërcitjes së gështenjave tek piqeshin, të prisje në qoshe të rrugës të kalonte princesha e ëndrrave të tua apo të meditoje për të në të voglën shtëpi.

Tollovia do të niste në fillim të viteve '90 të shekullit të shkuar, ndërkohë që rrëkeja e ndryshimit merrte përpara gjithçka.

Së pari qenë dyert e hapura të emigracionit, të shoqëruara me bartjet brenda vendit. Qytetarët filluan ta linin qytetin një nga një, edhe pse ikja do të ishte e ngadaltë gjer në 1997-tën famëkeqe.

E bashkë me ikjen, po zinin vend shëmtitë ndërtimore, që nuk kanë të sosur as sot. Vetëm në Peshkopi mund të ndeshësh ndërtesa me shtesa para e prapa, anash e lart!

Nuk ishte çizmja e gjermanit që po e kthente në pluhur gjithçka, ishte tjetër çizme...

Qyteti po shformohej dalëngadalë, por pakthyeshëm. Njerëz iknin, njerëz vinin, qyteti zbrazej, qyteti mbushej.

Tani ti je i huaj, askush nuk të njeh, askënd nuk njeh. Peshkopia nuk është më qytet, por nuk është as fshat. Katrahurë është fjala që i shkon më për shtat! Njerëz që thjesht gjallojnë!

Bashkë me autoktonët, me gjelbërimin, me agimin e papërsëritshëm, me buzëmbrëmjen magjepsëse, janë zhdukur dhe dilemat. Kush i ka mbijetuar së sotmes tragjike, ka vetëm një alternativë: ta japë frymën e fundit bashkë me qytetin, ose t'ia mbathë pa kthyer kokën prapa.

Bukuria ia ka lënë vendin shëmtisë, gjelbërimi ia ka lënë vendin pluhurit, rrugët e pastra ia kanë lënë vendin baltës...

Peshkopia ishte mbase i vetmi qytet që kërkonte veç mirëmbajtje, por kush e drejtoi atë bëri krejt të kundërtën. Prandaj nuk vlen më kush zgjidhet për ta qeverisur. I majtë a i djathtë, zemërndezur apo zemërfikur, me parime apo pa parime, me moral apo pa moral, qeverisësi i Peshkopisë është i kapitulluar që në ditën e parë të punës. Sepse qyteti është shkatërruar pakthyeshmërisht!

Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar... Të ishte gjallë Markezi, e të kishte mundësi ta shihte Peshkopinë e sotme, mbase do të nxirrte një tjetër perlë, një tjetër kryevepër, nga dora e tij. **/tesheshi.com/**



Shkrimin e plotë mund ta lexoni në linkun:
http://www.dritare.net/2016/08/31/ekskluzive-zgjedhjet-ne-diber-lufte-per-nje-vote-me-shume/1

profil

Rustemi, Dritani, Lahimi dhe Arseni, që të katër me familje dhe shtëpi në vete, por me ekonomi të përbashkët.

Ata kishin pak më tepër se një hektar tokë të lirë dhe vendosën ta mbjellin. Por për në tokën e tyre nuk kishte rrugë... Babai, Hekurani, u shkoi derë më derë të gjithë bashkëfshatarëve. U kërkoi pak rrugë, sa për të kaluar zetori... Ajo nuk do ti shërbente vetëm atyre, por gjithë atyre që kishin tokat aty pranë. Nuk ishin pak, por 30 hektarë tokë, e gjitha kjo, vetëm me rrugë këmbësore. Vetëm kur rruga i përshkoi parcelat nga fillimi në fund, fermerët e kuptuan se kishin bërë një punë të shkëlqyer, se së bashku mund të fitonin shumë beteja të tjera, sado të vështira që të ishin ato.



Kooperativa e vogël Tifeku, një shembull i rrallë

Nga **OSMAN XHILI**

Të gjitha këto investime garantojnë të ardhura të kënaqshme për vëllezërit Tifeku, që punojnë shumë e flasin pak. Megjithatë, ata do të donin të investonin sërish për diçka tjetër. Tokë nuk kanë më të tyren, ndoshta mund të marrin dhe pak me qira, nëse gjejnë sipërfaqe të lira. Kështu punojnë vëllezërit Tifeku me duar të bashkuara, si një trup i vetëm, duke dhënë një model, duke dhënë mesazhe bashkimi e bashkëpunimi.





Në të djathtë të rrugës që shkon për në Peshkopi dhe fare pranë saj, gjendet një karburant i vogël, dhe ngjitur me të, një bllok pesë dynymësh me mollë intensive. Pronarët e tyre janë katër vëllezër nga Greva me mbiemrin Tifeku.

Rustemi, Dritani, Lahimi dhe Arseni, që të katër të martuar, me familje dhe shtëpi në vete, por me ekonomi të përbashkët. Në fund të çdo muaji, ata bëjnë bilancin: hyrje – daljet dhe bëjnë pjesëtimin me katër, për secilën familje.

Kryetar i këtij kooperimi të vogël, nuk mund të jetë kush tjetër, veç babait të tyre, Hekuran Tifekut. Për shumë vite ai kishte qenë kryetar i këshillit të komunës së Melanit, dhe jo më kot. Dinte të drejtojë, dinte të menaxhojë, dinte të dëgjojë mendimet e të tjerëve dhe ti merrte në konsideratë, për të marrë më pas vendime kolegjiale. Ishte mjeshtër i punimit të drurit, dhe këtë punë kishte bërë gjithë jetën. Kishte krijuar, kishte fantazuar, kishte luajtur me format e drurit, bufe, dyer, dritare, dhoma gjumi dhe sërish e kishte kokën plot me ide.

Ishte viti 1994. Shumë njerëz akoma kishin sopatat nëpër duar për të prerë ndonjë pemë të mbetur, kurse Hekurani dhe pse pa shumë eksperiencë të mëparshme, mbolli pesë dynymë pemëtore. Ishin të llojit "Hajdaret". Ndoshta nuk ishte lloji shumë i përzgjedhur, por sidoqoftë, ishte prodhues dhe rezistent. Arriti të marrë deri 100 kv, që atëherë i dukeshin shumë, kurse tani qesh me këtë shifër.

Shumë vite më vonë, djali i vogël, Arseni, shkon të punojë në Bolzano, në Itali. Tjetër kulturë pune, tjetër teknologji, të tjera varitete. Arseni mendoi se duhej ta prishte pemtoren që kishin mbjellë më parë dhe të mbillte lloje intensive, që kishin prodhimtari të lartë, deri në 800 kuintalë për hektarë. Bisedoi me familjen dhe ashtu bënë. E thamë që më parë, se të gjitha vendimet i merrnin me dakortësi të plotë.

Fidanat erdhën nga Italia, me një vlerë katër euro copa, pa llogaritur transportin. Por as kjo dhe as shpenzimet e tjera për gropa, tela, bandjera, apo diçka tjetër, nuk i kthenin pas. Koha tregoi se investimi i bërë nuk kishte qenë i kotë. Tani fidanët janë në vit të tretë e të katërt dhe që tani ata morën 150 kuintalë, të cilat i shitën njëherësh, me një çmim 60 lekë për kilogram.

Teknologjia për llojet intensive është krejt e re. Para shumë vitesh mësonim se nuk duhej lënë asnjë llastar i pemës pa u pincuar në një të tretën e saj, tani rekomandohet të mos preket asnjë. Vetëm bëhet përkulja e tyre, duke i detyruar të kthehen në sytha frutorë. Sa e sa demonstrime me fermerë dhe specialistë të frutikulturës janë kryer në pemëtoren e tyre. Sa e sa filmime e xhirime nga kanale televizive. Vëllezërit Tifeku tregojnë ndonjë eksperiencë të tyren dhe po ashtu mësojnë diçka nga të ardhurit. Më pas ftojnë mysafirët për ndonjë kafe te lokali i tyre, ngjitur me karburantin.

Ndërkohë, vështrimi tyre ishte hedhur te qershia. Kuplani i Grevës, me një tokë tejet të përshtatshme dhe një ekspozicion të shkëlqyer, ishte i njohur kudo. Qershitë e çelura në pranverë janë një kartolinë që rrallëkund e gjen. Ata kishin pak më tepër se një hektar të lirë dhe vendosën ta mbjellin. Ndoshta ishin nxituar, kishin bërë llogaritë në letër e kaq. Kaq kilogramë, herë kaq lekë, kaq do të ishte fitimi. Nuk e dinin se gomoza do ti luftonte pa mëshirë pemët e reja dhe ata do të duhej ti mbronin me të gjitha mënyrat e mjetet. Ti lyenin një për një, me furçë, me vaj të djegur, me gur kali, për ti kthyer në normalitet. Po rruga? Si vallë kishin harruar, që për të shkuar deri te blloku i tyre duhej të përshkoje dy kilometër dhe duhej të shkelje në pronat e të tjerëve? Hekurani u shkoi derë më derë të gjithë këtyre njerëzve. U tha se duhej ti jepnin pak rrugë, sa për të kaluar zetori apo mjete të tjera. Se ajo nuk do ti shërbente vetëm atij, por gjithë atyre që kishin tokat aty pranë. Nuk ishin pak, por 30 hektarë tokë, e gjitha kjo, vetëm me rrugë këmbësore. Vetëm kur rruga i përshkoi parcelat nga fillimi në fund, fermerët e kuptuan se kishin bërë një punë të shkëlqyer, se së bashku mund të fitonin shumë beteja të tjera, sado të vështira që të ishin ato. Tani mund ti punonin pa vështirësi tokat e tyre, të dërgonin plehun, të sillnin prodhimet e lloj-lloj shërbimesh të tjera. Qershitë janë në vitin e tetë. Prodhimi tyre rritet vit pas viti me dhjetëra kuintalë, për ti kaluar shumë shpejt 100 kuintalët, që përkthehet në para shtesë në arkën e kooperativës së vogël.

Këtë vit, bllokut të qershive i është shtuar një sipërfaqe tjetër prej pesë dynymësh. Nuk janë më pemë me rritje të madhe e me distanca shtatë me shtatë, por lloje intensive, me distanca katër me dy dhe që hyjnë shumë më shpejt në prodhim. Janë mbjellë rreth 600 rrënjë që mendohet të prodhojnë mbi 100 kuintalë. Janë blerë rreth 4 euro copa, kurse totali i parave për mbjelljen e tyre, bashkë me gropa dhe bandiera, kap një shifër prej tetë milion lekë lekësh.

Në kooperativën e vogël me emrin Tifeku shtohen hyrjet dhe daljet. Shtohen të ardhurat çdo vit nga vjelja e prodhimeve dhe shitja e karburantit, por shtohen dhe investimet e menduara mirë, duke e bërë më të fuqishme fermën e tyre.

Krahas mbjelljes së qershive vegjetative, do të dëshironin të bënin një investim të ri. Të bëjnë sistemin e vaditjes me pika në bllokun prej një hektari të qershive. Sido që pemët janë rezistente ndaj thatësirës, të paktën dy vaditje i duan në periudhën e nxehtë të vitit. Ashtu me kova dhe me bidona i vaditën dy herë këtë vit, duke siguruar rritjen normale të kokrrës. Por kjo metodë primitive dhe e mundimshme, nuk ka pse të vazhdojë më, aq më tepër kur një burim i mjaftueshëm uji, është fare pranë bllokut të qershive.

Të gjitha këto investime garantojnë të ardhura të kënaqshme për vëllezërit Tifeku, që punojnë shumë e flasin pak. Megjithatë, ata do të donin të investonin sërish për diçka tjetër. Tokë nuk kanë më të tyren, ndoshta mund të marrin dhe pak me qira, nëse gjejnë sipërfaqe të lira. Kështu punojnë vëllezërit Tifeku me duar të bashkuara, si një trup i vetëm, duke dhënë një model, duke dhënë mesazhe bashkimi e bashkëpunimi.

Rruga e Arbërit nr. 123

reportazh

Mali i Robit, mes bukurisë së natyrës dhe dibranëve gazmorë

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**



Era



Natasha me Remen

Erdha nga larg t'i hedh mallit një dorë ujë me akull e ta shuaj, ta shoh avullin që del e ta thithë në mushkri duke mbushur gjoksin.

Vij çdo vit, vij një muaj të tërë, në gusht, atëherë kur Athina boshatiset e vargu i autobusëve në Kakavijë bëhet tërkuzë me lesh dhie sa orët e rrugës dhe orët e kalimit afrohen për tu bërë një.

E kam një shtëpizë familjare në një kompleks të bukur tek plazhi i Malit të Robit, shtëpizë që mbledh nipërit e fëmijët dhe bashkë me Natashën mbush jetën me ditë mbi ditët e jetës që na është shkruar nuk e di në çfarë defterësh.

Mëngjeseve kam në sy një pyll pishash thinjur nga degë të thara në natyrën e jetës së virgjër stisur nga dora vullnetare e njeriut që nuk e dinte se çfarë mrekullie do tu jepte brezave. Përmes trungjeve shoh kaltërsinë e detit që herë më vjen me shushurimë e herë me dallgë gjelbërimi e bardhësie.

Një oaz qetësie që desha ta kem në ditën time të perëndimit...

Jam turist, turist i regjistruar zyrtarisht në pikë hyrjen në vendin tim, turist në shtëpinë time !

E lë ballkonin me pamjen nanuritëse, hap derën dhe zbres shkallëve plot rreze dielli në zgjim të tokës e njerëzve.

Zbres dhe kundroj hapësirën ku tre pallate, si tri kuti shkrepëseje, tre kate plus papafingo janë rrethuar me një mur dekorativ, gjelbëruar anash me pemë e lule, me tre porta të mëdha hyrjeje e një të vogël dalje në plazh. Një oaz qetësues veçanërisht kur ke fëmijë të vegjël, nipër e mbesa që deri vonë luajnë me njëri tjetrin, pa frikën e prindërve e gjyshërve se dikush do tua prishë lojën e do tua rrëmbejë trupin për ta përcjellë rrugëve pa dritë të botës.

Një tabelë basketbolli është e reja e këtij viti, një lojë që mbush jetën e fëmijëve dhe të rriturve në garën se kush do të kalojë përmes rrethit sa më shumë topa...

Zabiti me Agimin, dy dibranë "Qytetarë nderi të Durrësit" kanë krijuar një mjedis pushimi veror, pse jo edhe jetese tërë muajt e vitit, mjedis që nuk e gjen në tërë hapësirën e plazhit të Malit të Robit, pse jo edhe në tërë vijën bregdetare që zgjatet nga Durrësi...

Komshiu im më i afërt është Jeton Shehu, dibran me rrënjë të thella jo vetëm në Dibrën e Poshtme por edhe në kryeqytetin e tërë trevës, fatkeqësisht nën krahë të huaj, Dibrën e Madhe apo siç njihet më gjerë, Shehri i Dibrës.

Jetoni ka një shtëpi modeste me një dhomë e një kuzhinë, me një ballkon nga ku shihet nëpërmjet pishave deti. Çdo javë Jetoni vjen në shtëpizën e tij të premteve pasdite pasi shkëputet nga puna në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, për të kaluar fundjavën. Vjen me një makinë të vogël familjare në hapësirën e ngushtë të së cilës, përveç të shoqes - Lizës, kurdoherë ka vend për "Nënë Remen", kujtesën e gjallë të familjes Shehu, nënën e Rizait, Jetonit dhe Bashkimit dhe Engjëllushes, gjyshen dhe stërgjyshen në rrjedhë të djalit të saj të madh Rizait. Remja ka një kujtesë të fortë ndonëse vitet vazhdojnë ta ngjisin e ta rrisin drejt shekullit. Çdo vit e fus në arkivin tim fotografik ashtu si edhe i mbledh me zë kujtime të jetës në gjirin e familjes Shehu...}

Redi, djali i Jetonit tash vjen më rrallë. Puna si specialist i lartë i mbush shumë kohë të jetës.

Olës, vajzës së Jetonit një vit më parë i uruam rrugë të mbarë për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke përjetuar një rrjedhë loti. Më 29 gusht, një ditë pasi zbriti nga udhëtimi i saj nga vendi i largët tej oqeanit, nuk mund të qëndronte në Tiranë pa u përqafuar me Natashën, hallën siç e quan, që një ditë më vonë do të nisej për në Athinë...

Në të njëjtin kat ndodhet Besi, arkitekti i kompleksit me familjen e tij. Një vizitë Huries bashkë me Natashën ishte dritare e kujtimeve të vjetra, ditëve kur ajo, ballë përballë kishte Hamit dhe Hazize Hodon me vajzën e tyre Imeldën, dy njerëz që mbetën një jetë të tërë mes peshkopiasve mikëpritës.

Në katin e sipërm, në të djathtë është Hekurani, i biri i ikonës dibrane të bujqësisë Jashar Bunguri, me Dozen, motrën e bashkëshortes së Jetonit.

Poshtë, në katin e dytë, është familja e mikut tim të vjetër Ismet Sopotit. Vite më parë pija kafe me të birin. Tash ai iku në përjetësi për tu kujtuar vit për vit me ardhjen nga Italia të familjes së tij.

Në të njëjtin kat është edhe e motra e Zabit Mudës me vajzat e saj që asnjëherë nuk harrojnë të përshëndesin të gjithë me buzëqeshjen e tyre gazmore.

Bim Bulku, i gjallë, gazmor, me histori udhëtimesh anë e mban globit është në pallatin e dytë.

Doktor Horeshka me familjen e tij asnjëherë nuk mungon në gusht e muhabeti me të në kafene është i çiltër e me mall për Dibrën.

Behar Beqiri, vëllai i mikut tim të maleve të Dibrës Meleq Beqiri është një biznesmen i suksesshëm në fushën e punimeve hidraulike...

Një Dibër e vogël njerëzish të malluar, njerëz të thjeshtë, mblidhet çdo verë në kompleksin ndërtimor "DIBRA AGZA"...

Jetoni nuk na le të ndarë as në plazh, bashkë gjithnjë, pranë e pranë me çadra, në ndeshjet gazmore me Erblinën në tabëll e me katërshen Jeton-Natasha-Liza-Dozi, në domino...

Nuk und të harroj Anën, motrën e Lizës dhe Dozit që çdo vit vjen nga Italia ku ka ndërtuar folenë e saj familjare, vajzën e saj të bukur që e flet shqipen si të ketë lindur e të jetë rritur në Shqipëri.

Gaz i të gjithëve është Era tre vjeçe, mbesa e Hekuranit dhe e Dozit, fjalët dhe fjalori i saj të befasojnë e të bëjnë ta përqafosh me dashuri...

Desh harrova dy nipërit e mi, Gurjonin dhe Eralin, njeri i vajzës dhe tjetri i djalit, gazi i jetës sime dhe i Natashës. Ata, por edhe fëmijët, janë gëzimi i jetës sime dhe i Natashës ditëve të bukura të çdo gushti. Ata tashmë po rriten, Gurjoni më 22 shtator mbush 12 vjeç kurse Erali më 5 mars mbushi 8 vjeç...

Ali Hoxhës, historian e Dibrës, kryetar nderi i shoqatës për mbrojtjen e Drinit të Zi në atë udhëtim mesdite me autobus nga Tirana tek rreth rrotullimi i Malit të Robit ia kam borxh respektin. Ai këmbënguli që të më takonte ta pinim një kafe bashkë e të bisedonim për Dibrën që duan ta mbysin e ta qesin fare.

Më erdhi keq kur dy ditë më vonë mësova lajmin e zi që është ndarë nga jeta bashkëshortja e tij pas një infakti të shpejtë. Qoftë e xhenetit. Ngushëllime miku im...

Avni Muça, ish nxënësi im në shkollën e mesme bujqësore të Peshkopisë, një njeri që nëpërmjet mjeteve të komunikimit sa e sa herë do të më përshëndeste dhe do të më përcillte vitet e bukura shkollore, nuk mungoi që së bashku ta gjerbnim një kafe e të shkëmbejmë respektin e ndërsjellë të nxënësit dhe mësuesit.

Me Veli Vraniçin jam takuar në plazh vit për vit. U takuam edhe këtë radhë me një kafe dhe raki përpara në shoqëri të një kavajasi që i kishte bashkuar kënga dhe vallja në dhjetëvjeçarë. Dy ditë më vonë mësova se e kishin pushuar nga puna si drejtues i qendrës kulturore të Peshkopisë !!!

Nuk e di pse këtë vit nuk u takova me mikun tim të vjetër të shtypit, me Luan Kabën. E kërkova disa herë në telefon me shpresën se do ti ishte diku fare pranë me familjen në breg të detit por nuk mu përgjigj njeri në telefon. U shqetësova...

Bim Bulku një mëngjes do të më merrte "për dore" për të gjerbur kafenë me një dibran të njohur, me Femi Abdiun. Nuk e dija se e kisha kaq pranë me shtëpi e për më tepër katër-pesë radhë çadrash larg. Do të bëheshin katër dibranë rreth tavolinës së bashku me Ejup Melanin një ekonomist i vjetër i Dibrës...

Kirurgun e njohur dibran Lul Pilafi nuk e takova në plazh kësaj vere por takova kolegun e tij, Arif Hasanin. E kisha përshëndetur në telefon Arifin çdo vit. Kësaj here veç zërit i preka edhe dorën, atë dorë që ka shëruar mijëra njerëz, mes të cilëve edhe mua. Nuk mund të përjetoja një çast që e lidhte në kujtime si dy deputetë dibranë me Femiun. Kapa çastin kur u takuan përmallshëm dhe e fiksova në fotoaparat.

Një kafe e zgjeruar me ta më solli në shpirt kujtime të hershme, kujtime tej njëzetë vjetëve në mërgim...

Në plazhin e Malit të Robit shuaj çdo vit mallin me njerëz që i dua dhe më duan...

E shuaj... Vërtet?

E ndez më shumë tek kaloj kufirin e ngulem në truall të huaj...



Me Ali Hoxhë, kryetar nderi i shoqatës për mbrojtjen e Drinit të Zi



Me Bim Bulkun, Ejup Melanin dhe Femi Abdiun

reportazh

Te çdo fis e kullë nën kurorën e Runjës...



Lukani e Runja. © Foto: Agim Totraku

Nga **MEVLUD BUCI**

Çdo fis rrezaton dritë, fisnikëron brezat dhe kombin. Tek çdo fis e kullë nën kurorën e Runjës, si kudo në atdhe, gjen krenarinë, bujarinë, qëndresën, fisnikërinë, bukurinë e karareve, të cilat janë vlerë e çmuar për brezat tanë. Fiset e Lukanit të Dibrës kanë bëma e fakte të atdhetarisë, te qëndresës në për mote e kohëra. Drita e fisit është drita e besës, drita e fjalës së dhënë, drita e kulturës njerëzore dhe e vlerave të trashëguara nga brezi në brez. Fjalët e mençurisë së popullit kanë gdhendur vlerat e fisit. Kush nderon fisin e vëllazërinë, ka nderuar brezat dhe historinë. Thonë për atë njeri që ka bujari e besë, e bën fisin të fortë si fortesë. Është i fisëm, e ka genin në fis, është fis me histori, ka dhënë prova në fis, e ka për fis fisnikërinë, e ka bërë fisin me zë, është fis me bedenë e me lis; këto e plot fjalë të tjera tregojnë për vlerat, rrënjët e madhështinë e fisit. Nën kurorën e Runjës shekullore (2047 m e lartë) në Katër- Grykë secili fis ka plot prova lufte, bujarie, djerse e krenarie. Me të drejtë kujtojmë se krijuesi i talentuar e kulturologu Hysen Dervishi ka shkruar ka herë vargjet epope:

Në Katër-Grykët e Runjës plakë,
Erë baroti çdo konak
Në luftë me turq e austriak
U mbyt vendi pllëmbë e gjak.

Tek fiset e Lukanit si tek cili do fis në Diber gjen bukuritë e jetës e të vllazerimit, provat e mirësisë e të krenarisë.

EMRA QË NUK HARROHEN

Fisi bën dritë me emrat e fisnikërisë. Janë të shumtë ata që në Lukanin malor kanë bërë emër në ballë e në mes fisit sepse kultura, besimi, bujaria e bashkimi i fiseve kanë çuar në rritjen e forcimin e vlerave të karareve të dheut. Nëpër vite nga brezi në brez kanë kaluar emrat e qëndrestarëve, të urtëve popullorë, të intelektualëve të talentuar, të të rënëve në ballë të punës a në krye të detyrës së ushtrisë. Që nga koha e Skënderbeut e më vonë muza popullore e fiseve ka gdhendur plot ngjarje, vende, figura të cilat janë e mbeten drita e fisit, drita e krenarisë së brezave.

Në librat për fiset e Lukanit, për të cilat do flasim më poshtë, rrezatojnë fiset, provat e vëllazërimit, provat e besimit e të unitetit popullorë.

BIJTË E TOTRAKUT.

Midis fiseve të Lukanit po flasim pak për bijtë e Totrakut. Ky fis, midis e për krah të tjerëve dallohet për urtësinë, bujarinë dhe unitetin vëllazërorë. Provat e bijve të Totrakut (Totrri i ardhur nga Mirdita në lashtësi, vëllai i parë Bush Totrri, Lami, Lleshi, Buci etj.)

Janë dëshmi e rrezatimit fisnor dhe të krenarisë njerëzore. Është shembull i kulturës, shëmbëllimit, të djersës e të përkushtimit, rrezatimi i djemve të nderuar si.. Agim Totraku, Skënder Totraku, Agron Totraku, Uran Totraku, Bilbil Totraku, Xhemal Totraku, Shaban Totraku, Behar Totraku, Sajmir Totraku e plot të tjerë janë modeli i kulturës, mirësjelljes, urtësisë e vëllazërimit në fis. Këta bijë të Totrakut kanë secili histori djerse e diturie, dritë fisi, dritë në udhët e rritjes e të përkushtimit. Njeri nga këta, Sajmir Hazis Totraku ka plot prova të përkushtimit në udhët e mërgimit. Midis te tjerash ai tregon: "Isha në moshën 16 vjeç kur ika për herë të parë në Selanik dhe aty u punësova bashkë me vëllanë tim të madh Shabanin. Për muaj të tërë qëndruam tek dy pleq grekë. Ata na mbajtën si djemtë e tyre. Edhe ne i respektonim dhe i nderonim siç na e ka traditë fisi. Më ka lënë mbresa dashuria prej nëne e Elenës. Ajo më thërriste mikre (vogëlush). Në orar të punës që të gjithëve ju çonte kafe, kurse mua më thërriste që të haja bukë për së dyti ende pa ardhur dreka. Ajo shqetësohej për shëndetin tim si për fëmijën e saj. Atje mësova se si rrezaton mirënjohja njerëzore, të cilën fisi im e ka trashëguar brez pas brezi. Tek puna e lodhja jonë kur do herë kemi treguar kararet e fisit, kulturën e vlerave, kulturën e mirënjohjes. Bujaria greke sikur më thërret çdo ditë për t'i lartësuar vlerat e fisit tim".

Fjalët e Sajmir Totrakut janë fjalë zemre, fjalë të një emigranti të vuajtur e të përkushtuar të një djaloshi që kudo mbart krenarinë e fisit.

TRI LIBRA PËR TRE FISET E LUKANIT

Janë gdhendur në kujtesën e brezave dhe bashkëkohësve tanë tri libra kushtuar fiseve Ndregjoni, Bruçi e Dervishi të Lukanit të Katër - Grykëve. Autorët e nderuar kanë dhënë një ndihmesë të çmuar për traditat, vlerat dhe fisnikërinë e këtyre fiseve. Këto libra monografik (letraro-historik) pasqyrojnë dritën e fiseve, unitetin popullor, ngjarje e figura të shuara, të cilat dëshmojnë luftërat, punën e vlerat fisnore e mbarë popullore të trevës e më gjerë. Shkrimtari dhe filozofi Xhafer Martini ka shkruar librin.."Ndregjonet e Lukanit" , ku përshkruan gjurmët e fisit të nderuar të Ndregjonëve. Luftërat, bujarinë, prijësat popullorë qysh tek Molla Liman Ndregjoni, prijësi i flamurit Llan Destan Ndregjonit, Të rënët anti-komunistë Xhavit e Xhetan Ndregjoni e plot të tjerë. Në Libër gjejmë edhe emrat e atdhetarëve të shquar si Asllan Ndregjoni, Ymer Ndregjoni, Rexhep Ndregjoni, Ahmet Ndregjoni, Ramadan Ndregjoni, Hazis e Sulë Ndregjoni, Ferit Ndregjoni e deri tek Mjeshtri i Madh e Qytetari i Nderit të Tiranës Besim Ymer Ndregjoni, e plot të tjerë.

Ky libër është shkruar me realizëm e mjeshtri artistike nga i talentuari shkrimtari Xhefer Martini.

Për fisin e dritën e tij në rrjedhën e historisë ka shkruar librin monografik të mirë realizuar biznesmeni human, biri i Lukanit, intelektuali i veprave të dritës dhe provave të respektit për fisin e vendlindjen Faik Ramadan Bruçi.



Lagjia e qendrës dhe e sipërme e Lukanit, Runja. © Foto: Agim Totraku

Ai e titullon librin.."Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës". Vlerat e veçanta të këtij libri janë gjurmët e brezave, fisnikëria e fisit Bruçi, atdhetarët e shquar, të dalluarit në luftëra, në vepra ndërtimi. Ai flet edhe për shenjtërimin e Dede Bruçit, për intelektualët e shquar si Hysni e Tofik Bruçi, Ferit, Halit e Sami Bruçi, për njerëzit e thjeshtë të fisit, të cilët mbartin vlera të çmuara kulturore e mençurie. Ky është "pallati" më i madh, më i çmuar, më i përjetshëm që i shquari e humani Faik Bruçi ua dhuron fisit, vendlindjes dhe brezave. Kjo është dritë që u rrezaton kohërave, pasqyrë e fisnikërisë, thjeshtësisë dhe gjurmëve të fisit Bruçi.

Drita e fisit është drita më krenare për cilin do. Kush ka respektin në fis, ngjan si mal e ngjan si lis.

Fisi të ndez krenarinë, të jep krahët e shqiponjës, të dritëson, të urtëson e të bën të pa mposhtur në udhët e jetës. Është vërtet monument për fisin e për brezat libri monografik (letraro-historik) "KRENARIA" e krijuesit e kulturologut të shquar Hysen Dervishi. Ky libër (me 550 faqe) përbën një triologji të ndritur për fisin, vendlindjen e më gjerë. Në faqet e këtij libri shpërfaqet me realizëm e korrektësi jeta e puna e autorit Dervishi, brezat e fisit, prijësat popullor, historia e qëndrestarve, kullave, traditat atdhetare, ngjarjet në luftëra, në vitet e monizmit e më pas të kohës së demokracisë. Autori Dervishi na jep artistikisht e historikisht vlerat e çmuara të fisit Dervishi, vlerat e vendlindjes, të trevës e të figurave të shquara në për kohëra, lartëson e pasqyron intelektualet e njerëzit e shquar të punës e të kulturës. Libri "KRENARIA"

është dhe mbetet krenari legjitime për të gjithë ne dhe për brezat që do të vijnë.

***

Tek fisi e familja merr dritë jeta njerëzore.

Drita e fisit është e mbetet drita e krenarisë së brezave.

Nderim e dritë paçin ata që kanë shkruar libra për fiset!

Si vetë kurora e Runjës, si vetë shkrepat janë e mbeten ata që lartësojnë, bashkojnë e vëllazërojnë fiset.

Koha dhe brezat kanë nevojë më shumë se kurrë për unitetin, kararet e kulturën fisnore.

Drita e fisit është drita e krenarisë së brezave.

Pajtohu në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj



Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e faqes) ofrohen falas!

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë.

Kontribuo edhe ti për lirinë e saj me vetëm një pajtim!

Gazeta "Rruga e Arbërit" këtë vit mbushi dhjetë vjet nga dalja e numrit të saj të parë dhe çdo muaj përcjell informacione, komente, opinione, reportazhe, recensa dhe rubrika të tjera për artin, kulturën, historinë dhe gjithçka që ka të bëjë me qarkun e Dibrës.

Gazeta është një botim i pavarur dhe këtë e ka dëshmuar gjatë këtyre dhjetë viteve me integritet dhe profesionalizëm.

Redaksia mbetet gjithmonë e hapur për sugjerimet tuaja, jo vetëm në trajtimin e tematikave, por edhe për të shkruar mbi veprimtari, individë apo organizata që veprojnë, kontribuojnë apo kanë lidhje me qarkun e Dibrës.

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë dhe liria e saj është e garatuar jo vetëm nga redaksia, por edhe nga lexuesit e saj, të cilët ndodhen larg vetëm një pajtim.

Gazeta shpërndahet në Tiranë, Durrës, Burrel, Klos, Bulqizë, Shupenzë, Maqellarë, Peshkopi dhe Dibër e Madhe në versionin print dhe në të gjithë botën përmes emailit në versionin PDF.

Një pajtim vjetor në Shqipëri dhe Dibër e Madhe, si deri më tani, kushton 600 lekë. Në Europë 10 Euro, në SHBA dhe vendet e tjera 15 USD.

Pajtimet jashtë Shqipërisë janë vetëm në versionet PDF dhe mund të kryhen përmes PayPal.

Për më shumë informacion:
Email: rrugaearberit@gmail.com
Tel: 00455 68 65 08 441.
WhatsApp: +355 68 65 08 441
Viber: +355 69 20 68 603
www.rrugaearberit.com

Na ndiq në Facebook ose linkun: goo.gl/1bq2r6
Bej "Like" dhe "Share"
Qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit nr. 123

vendlindja

Një zbulim i krahinës së Muhurrit përmes studimeve arkeologjike, shkrimeve historike, gojëdhënave, traditës, toponimisë. Fiset dhe prejardhja e tyre.

(Vijon nga faqja 15)

e Durresit me 7 prill 1939 kundër ushtrisë fashistët italiane. Aqif Qoka bie dëshmor në Shkam të Krujës në vitin 1948, Xhetan Laci bie në luftime në Labinot të Elbasanit, pastaj dëshmoret Ramadan Deva e Adem Dobi. Nuk po zgjatemi më tej se ato janë të shumtë në periudha të ndryshme historike. Shumë prej tyre duhen zbuluar nëpërmjet rapsodive popullore, dokumenteve e studimeve historike të autorëve të ndryshëm e kronikave të shtypit etj.

GJENOLOGJIA E FISEVE

Nuk duam të bëjmë përshkrime të hollësishme sepse edhe materialet e mbledhura i kemi të pakta, edhe për ato është shkruar shumë pak. Prandaj mund të kemi edhe mospërputhje dhe pavërtetësi.

Familja **Kurti** në Shnetat, toponimi ara e Kurte, rrënojat, zbret në faqen e Mollës, në Degjane, së fundi në Kurt të boxhoit në trojen e Këbejt ku i vuri edhe emrin. Tani banojnë disa familje. Konsiderohet fisi më i lashtë.

Marku vjen nga Oroshi i Miditës, e ndihmon Kurti duke e bëre vëlla me troje. Në kohën e Turqisë bën shkollë , kthehet në Hoxhë, zbret ne Hurdhë Muhurr, një vëlla shkëputet e zbret në Eshëlla nën Duksa, është një krua më pas shpërngulet ku janë sot shtëpia e Dine Hoxhës. Kanë mbetur pak familje.

Shqefi vëlla me Markun, përkrahjen me prona e strehim e gjen në Shnetat tek Kurti. Ky shtohet shumë nga ku rrjedhin këto fise: **Lala, Mikli, Rama e Deva i vogël**, Osmni në Brest ku jetojn dy familje. Kemi toponime në këto vende fillese për të gjithë.

Mikli e **Lala** zbresin në Degjane. Nga aty bien në Fushë-Muhurr, në Kodër të Lale (tek Nus Lala) e në vazhdim të saj, pozicionohet edhe Mikli, poshtë rrafshës së Thanxës, pra të dy fiset që ishin trojet e Mëzeze.

Rama nga Hurdh-Muhurri në faqen e Mollës, në lindje të Duksës së Madhe. Më pas bie në Fushë-Muhurr, përqark Kodrës së Rame.

Prençi vjen nga Reçi, por origjina më e hershme nga Malësitë e Shkodrës. Vjen në Hurdh- Muhurr, ku kanë akoma shtëpi, por një familje shkëputet në shekullin e XIX, në Faqen e Mollës, rruga e Degjane më pas zbret në Kurt të Boxhoit.

Fisi Çiku, prejardhjen nga Reçi, mbështet tek Hoxha. Kalon një familje në Shqath, ku mbështet tek Mani, një pjesë pastaj nga Hurdhë-Muhurri zbresin ne Fushë-Muhurr, ndërsa nga Shqathi në Kishavec.

Balla me origjinë nga Mati e ka ba vlla Preçi,ka ardhur shumë vonë. Vendbanimi, Vnesht në Gjerth, është ngjitur në Hurdh-Muhurr, zbret në faqen e Mollës në Duksën e Vogël. Zbret pastaj në Kurt të Bogjoit (Staf Balla) tek shtëpia e Demes së Balle dhe së fundi mbështet tek Rama me troje përreth Kodrës së Rame. I shkëputur nga Ballet e Muhurrit ndodhen në Terbisht e Bellovë të Gollobordës, ndërsa në Tuçep ndodhet fisi Adilaj i larguar nga Muhurri. Nuk kemi gjetur nga ku e ka origjinën.

Fisi **Sula**, **Meta** i vjetër. Nuk e dimë origjinën. Vjen e punon si bujk tek Mikli në Degjane. Pastaj zbret në Kodër të Rame. Ka akoma një familje.

Në Shqath fisi më i vjetër **Ballazhi**. Tregojnë se ka mbetur një Serb me emrin Llazh. Por nuk dihet Ball si iu bashkangjit? Tjetër pikëpamje është se ka ardhur nga Stelushi. Në Mehall të Epër ku u ngul se pari pastaj zbriti ku është sot. Ka akoma familje në Shqath.

Në kohë të vjetra vijnë dy vëllezër **Xheta** e **Doçi**, origjina Prizeren. Së pari banojnë në Tartaj të Zallë-Dardhës. Largohen nga andej e ngulen Xheta në Livadhet e Kuqe, Doçi në Shkuraka, ky i fundit zbret në Rreth-Kale. Nga Xheta rrjedh **Mani**, ngulet pastaj në Mehall të Epër tek kroi i Dragojve, pastaj zbret me troje në Qaf Shtriga, më vonë disa familje shkëputen e zbresin ne Rreth-Kale dhe Brezhdan.

Leka grua Mirditore e martue në Shkodër, vjen me barrë gjen fisin Mani në Mehall të Epër, tek kodra e Leke, edhe ky zbret tek Ara e Kreçe, ku ka disa livadhe. Dhe më pas zbret në trojet e sotme ku ka mjaft toka e pyje të emërtuar Leka.

Mani ban vëlla **Veshin** që vjen nga Mirdita në trojet e sotme, ka ende familje.

Visha rrjedh nga Ballazhi, shpërngulet ku ka trojet sot mbi Kepin e Radit dhe nën arën e Mustaf Dedes, i cili shkoi në Dibër të Madhe, tani banojnë në Shkup. Ka mbetur vetëm një shtëpi.

Daci i ardhur nga Dibra e Madhe ose nga Shkodra. Ka akoma shtëpi në Hurdh-Muhurr.

Fisi **Këbej**, e solli turku si *bej* për të sunduar, nga Mati. Duken rrënojat në Kodrën e Kullës, mbi shtëpinë e Sadik Hoxhës. Zbriti në Kurt të Boxhoit, pastaj shkoi në Algjone i përzanun nga Hoxha.

Çurket jane një tjetër grupim ku bëjnë pjesë, **Berisha, Sina e Laci**. Shtëpia e tyre në Çuke të Epra. Fushë-Muhurri quhesh fusha e Çurke, ku edhe sot e kësaj dite përdoret. Laci zbret posht në Lindërsa. Një vëlla shkëputet në Rreth-Kale. Po kështu, edhe dy familje Sina vendosen këtu. Një vëlla largohet në Rreth-Kale. Berisha zbret në trojet e tij, tek ka shtëpinë sot Emin Qamil Rina, largohet nga aty e shkon nën Rrafshen e Thanxës në veri, pranë fisit Voka. Tani të shpërngulur të gjithë.

Algjoni me shtepia në Çuket e Epra, pranon Mëziun i ardhur nga Sina e Epër, për vëlla dhe sot e kësaj dite me trefiset e daluna prej tij si**, Farruku, Dabiçi e Kaleshi** janë nuna, pra *kumurtajllek*. Një vëlla i Kaleshit kalon me banim në Rreth Kale, ku tani s'ka asnjë familje.

Pasi shtohen, zhvendosen në Fushë-Muhurr, në lagjen ose ndryshe tek Gropa e Algjone. Vokërr Noka nga fisi Dabiçe, njeri i zgjuar që projekoi e hapi vijën e Zallit, vepër ujore që funksionon edhe sot. Varri i tijë brenda tek teçja e Dabiçe.

Mëziu nga Klysyra e Mëziut në Han të Hotit në kufi me Malin e Zi, ngulet në Sinë të Epër tek Trojet e Mëzeze, Largohet njëri vëlla për Reç tjetri zhvendoset tek Algjoni. Shkëputet më pas e vendoset tek Vnesht me të njëjtin emër, shpërngulen përsëri në Kodër të



Mazrekat, Ara e Kurte.

Duke njohur vetveten, duke sakrifikuar për njëri-tjetrin, duke zbukuruar oborret e shkollave, duke mbjellur vreshta atje ku ishin, blloqe pemësh frutore, duke bërë një udhërrëfyes turistik për krahinën duhen energjitë e gjithësecilit. Të bashkuar të ndryshojmë shtratin e zhvillimit e përparimit të krahinës së Muhurrit, që është përgjysmuar.

MUHURRI

Vështrim ekonomik, historik dhe etnokulturor

Një krahinë e mbarsur me probleme ekonomike të vështira për zgjidhje, hemoragjia e rinisë muhurrake drejt Europës dhe Amerikës tanimë e kane boshatisur këtë krahinë. Traditat po myken e zhduken, ngjarjet historike dhe heronjtë janë zvenitur nga kujtesa e banorëve. Që të mos zhdukemi me rrënjë e degë, kërkohet një riorganizim i energjive mendore, fizike, një riorganizim i gjithë forcave intelektuale dhe investime të atyre që kanë aktivitete të mesme e të fuqishme, emigrantëve, shteti etj.



Xhuteza (Qyteza) Mali i Shmrajs

Mezeze. Ku ka ende familje. Shtesa e madhe detyrohen të bien në trojet e tyre në Fushe-Muhurr. Ka akoma familje.

Krrashi vjen nga lagjia me te njëjtin emër nga Arrasit mbi urën e Setës. E bën histar Mëziu. Shtëpia e parë tek kodra e Krrashit, mbi kodrën e Mëzeze, pastaj ngulet në Kep të Krrashe. Tani nuk ka asnjë familje.

Xhani vjen nga Lisi i Matit (rreh 300 vjet më parë), mbështete tek Algjoni në Çuket e Epra, zbret në Fushë-Muhurr.

Tanushi vjen nga Reçi.

Rina ardhur nga Shkodra, zbret në faqet e përroit që i venë emrin. Ka akoma familje.

Janë tre variante për fisin **Laci** i ardhur nga Reçi apo degëzim i Terzie ose një fis me Berishen porqë janë të vendit.

Fisi **Qoka** i pari Ndrec Qoku nga Kosova ngulur në Çuke të Epra, zbret në Muhurr. Ka akoma familje.

Voka vjen nga Mati, e bën me troje fisi Qoka. Ka akoma familje.

Në Shorokan, **Dida** rrjedh nga Terziu i ardhur nga Arrni i Kukësit, disa familje shpërngulen Kishavec.

Kanoli rrjedh po nga i mësipërmi, shpërngulur Kishavec.

Xharret e Shorokanit kanë katër varre pranë teqes së Dide. Nuk dimë me tej.

Pira ka dy mendime për prejardhjen, një nga Shkodra, tjetra nga Piroviç Pal banor në Sinë në tefterin Turk 1467. Ngulen në Grishqan ngjiten në Shorokan, pastaj zbresin në Reçna, më pas në shpatin lindor të Kodrës së Shehrit, së fundi shpërngulen, ku janë sot dhe një familje shkoi në Kishavec. Një fisi formuar po nga këto në Mallunx të Matit.

Lika me prejardhje nga Terziu varianti tjetërt degëzim i Pire. Banim në Sheher të Vajmdheje. Ka akoma familje.

Fisi **Doda** vjen nga Reçi, ngulet në Reçna pastaj në Vajmdhej. Ka akoma familje.

Gjoci vjen nga Grykë-Noka e mbështet Doda për tu ngulur në Vajmdhej se e kishte. Nuk ka familje.

Balliu me origjinë nga një fshat i Malsisë së Krujës, pranë Qafë-Shtamës. Banor në Sheher e Vajmdhej. Ka akoma banor.

Kustana e **Xharena** fisë të zhdukura kanë lëne toponimet. As një të dhënë për fisin **Meta**. **Trupja** vjen nga Dibra e Madhe. **Ismria** nuk kemi të dhëna. Fiset e **Lleshe** në Fushë-Muhurr e Rreth-Kale vijnë nga Bulaçi. **Doçi** e **Mani** vijnë nga Shqathi. **Dishin** e ka sjell Rina fëmijë nga krahina e Gollobordës. **Bushi, Lleshi, Losha, Zhuzhi** me banim në Bulaç nuk kemi të dhëna për prejardhjen. **Kulla** në Rreth Kale nuk kemi të dhëna

KULTET E BESIMIT

Në Bashkimin e lumit Murra me Drinin kemi një kodër që quhet Kodra e Shënedillit. Pra toponim që shpreh një besim, i cili vjen që nga koha pellazge, tek albanët e Kaukazit e i gjetur në disa toponime ne gadishullin ilirian në lashtësi ose Ballkanin e sotëm.

Kemi këto kisha, Shën Salvadori, Bulaç, Shën Gjergji, Hurdh - Muhurr, Shën Maria, në Mal të Shmrise (*Shmrajs* dialekt S.M). (F. Cordiignano, Geografia ecclesiastica dell'Albania N.4 1934) këto na jepen nga ky studiues italian, por na mungojn disa kisha si, Shën Dhimitri në Shmetra posht Teçes së Çikut, Shën Vasili në Shorokan, Shën Maria poshtë Vneshve në Gjerth, mbi trojet e Berishe. Kur është ndërtuar Kulla e Dine Hoxhës, gjatë hapjes së themeleve është gjetur një gur ku ishte skalitur një kryq, dhe një kokë njeriu e skalitur në gur. Nuk dimë ku kanë përfunduar, por thuhet sa aty na paska qenë një Kishë. Në Rreth Kale, nën shtëpinë e Rufat Sinës janë trojet e një kishe, e toponimi Lugu i Kishës.

Kemi Teqen e Çikut ndërtuar në pyllin e Shqefe, Teqja e Shorokanit ku është varros një hoxhë i ardhur nga Krahina e Shorokanit, Turqi, Teqja e Dabiçe ku është varrosur Vokërr Dabiçi (Noka). Xhamia më e vjetër është ajo në Lindërsa të Lace ku konsulli Rus Jasterbov shkruan se ishte pa minare, mbi atë u ndërtua e reja me 2013. Xhami pas viteve 1990 u ndërtuan ne Rreth-Kale dhe Hurdh-Muhurr.

ETNOKULTURË

Veshja e moçme ka qenë tirçe me gjetana të zes, kajuke, opinga prej lëkure lope lidhur me gjalma, këmishë e bardhë e brekë të gjata hasi, me ksul të bardhe, para pushtimit turk me majë si e Kosovarëve, pastaj e rrafsht. Gratë me xhupa të bardha me gjetana të kuq ose të zes, mitan të shkërlitun (*qëndisur* S.M.), përshtek të zeze, shami të bardhe, çorape të gjera me lule të bëra nga ato vete me garthaja (*shtiza* S.M.), brek të gjëra, opinga me gjalma. Mjeshtrja e prerjes dhe e qepjes se këtyre veshjeve në Muhurr ka qenë Hasbie Mëziu (Kovaçi). Ajo punonte me razbujt e saja, qylyma, sixhade, mutaf etj., me motive të ndryshme qëndismash. Kishte duar të arta.

Mullinjt janë të shumtë, mokrra janë gjetur në Mazrekat e Epra, në Lajthi të Trash, poshte qytezës së Hurdhe Muhurrit, në lindje, Mulliri i Palamatit tek Gjurra e Dodë Laçit në prrua të Shqathit i ngritur nga Dedë Ballazhi është mulliri i parë me ujë, fundi i shekullit të XIX, Mulliri i Mane, Shqath; Mulliri i Shqefe në lumin Murra, Mulliri i Bëshenit, i ringritur më 2013 nga Petrit Meziu, i Zyber Hoxhës po në Lumin Murra, Mulliri nën brigjet e Laleve, bashkangjitur hidrocentralit elektrik, i ngritur me 1957, mulliri i Terzie, në përroin e Rine, mulli në Sheher të Vajmdheje, nuk dimë pronë e kujt fisi ka qenë të shkatërruara para e pas viteve 1990.

Rapsodët poullor si Sadik Dida, Nezir e Nazmi Rama, Hasan Çiku, vëllezërit Gani e Hamit Rama dekorohen në festivalin e III të Gjirokastrës 1978. Kërcimtarët Ymer Deva, Qamil Daci, Demir Rama etj. Folklori i krahinës së Muhurrit është mjaf i pasur me këngë dasme, vajtimi, trimërie, beteja kundër turqëve, serbëve apo fashizmit italian e gjerman, disa prej të cilave janë pasqyruara edhe në përmbledhjen folklorike të Ilmi Kolgjegjës.

MUNDËSI ZGJIDHJE

Një krahinë e mbarsur me probleme ekonomike të vështira për zgjidhje, hemoragjia e rinisë muhurrake drejt Europës dhe Amerikës tanimë e kane boshatisur këtë krahinë. Traditat po myken e zhduken, ngjarjet historike dhe heronjtë janë zvenitur nga kujtesa e banorëve. Që të mos zhdukemi me rrënjë e degë, kërkohet një riorganizim i energjive mendore, fizike, një riorganizim i gjithë forcave intelektuale dhe investime të atyre që kanë aktivitete të mesme e të fuqishme, emigrantëve, shteti etj. Prandaj kërkohet:

1- Krijimi i një shoqate me pjesëmarrje të të gjithëve, intelektual, bujq, punëtor, tregtar, afariste nga e gjithë Shqipëria me origjinë nga Muhurri, mërgimtar, e cila mund të emërtohet shoqata "Dielli", "Drini", "Mazreka", "Shqiponja" etj., e cila me programet e veprimtarinë e saj, të ndikoje fuqishëm mbi zhvillimin ekonomik, kulturor të krahinës.

2- Gjithashtu ajo të bashkërendojë veprimet në projekte të ndryshme, të vogla ose të mesme, e realizimin e tyre, kërkimeve arkeologjike, nëpërmjet investimeve të mërgimtarëve, kontributit të anëtarëve të shoqatës ose, të atyre që kanë veprimtari ekonomike e tregtare. Bie fjala Çezma që u ndërtua kohët e fundit nga sjellja e ujit të pijshëm nga një shoqatë Islamike, të ribëhet me gurë të gdhendur marre nga *Gjuri i kuq i Robit* në lindje të Bulaçit duke hequr tubin e kauçukut si skelet i saj.

3- Organizimi i bisedave me nxënësit e shkollave mbi historinë e krahinës, mbledhja e folklorit e historisë së luftrave dhe prejardhjes së fiseve, ruajtja të paprekura te monumenteve historike, si varre, tuma, mure, shtëpi banimi me arkitekturë të vjetër, Karakollja e Dine Hoxhës etj., që tanimë janë lënë në mëshirë të fatit.

4- Organizimi i protestave, hartimi i kërkesave drejtuar bashkisë mbi riparimin e rrugëve automobilistike, ruajtjen e kullotave pyjeve etj., e ndarjen e pronave mbi ato sipas ligjeve.

5- Të përkrahen, nxiten e mbështeten intelektualët e specialistët e krahinës të shkruajnë mbi problemet ekonomike, mënyrat e zgjidhjes, propozime mbi traditat, etografinë, historinë e patriotët muhurrakë të pushkës e të penës.

6- Jemi një nder krahinat e pakta të Dibrës së Poshtme që nuk kemi shkruar historinë e krahinës, e cila është mjaft e pasur me heronj, beteja e heroizma në gjithë Shqipërinë dhe me rrënjë të lashta deri në mugëtirën e kohërave. Por, ajo mund të shkruhet sa më e saktë kur, arkivat personale në kujtesën e tyre e materiale të historianit Besnik Kebej, Sami Dodës, Kamber Farrukut, Hali Ramës, Naim Berishës, Fadil Hoxhës, Shefqet Dishës, Hysni Bruçit, Iliaz Kacës të shfletohen e të zbardhen, të shkruhen nga gjithë këto për çështje të ndryshme historike, ekonomike, etnografike të krahinës, të cilat janë të padukshme, të pa lexueshme, sepse janë akoma të veshura me mantelin e zi të kohës.

MBYLLJE

Shtretërit e lumit Drin e Murra, janë gjelbëruar, zbukuruar, por dallgët nuk shuhen janë të pranishme sipas stinëve, e ne muhurrakët duhet t'i shfrytëzojmë për ekonominë, edhe shenjet, varrenin, kacupat, ujët e vijave apo kanaleve po ashtu edhe inxhinierët, mësuesit, rapsodët, intelektualët e fushave të ndryshme për të mirën e popullsisë së mbetur. Duke rizgjuar traditat, duke ngritur moralin e banorëve të krahinës, duke i ndihmuar me investime nga shteti, bashkia, emigrantet, afaristet etj. Duke njohur vetveten, duke sakrifikuar për njëri-tjetrin, duke zbukuruar oborret e shkollave, duke mbjellur vreshta atje ku ishin, blloqe pemësh frutore, duke bërë një udhërrëfyes turistik për krahinën e deri tek ndërtimi i një teleferiku nga Shnetati për në vargun e Runjës për të ndjerë kënaqësinë e peizazheve të pllaut. Për të mposhtur këto dallge duhen energjitë e gjithësecilit dhe të bashkuar të ndryshojmë shtratin e zhvillimit e përparimit në kahjen e popullit të krahinës së Muhurrit, që është përgjysmuar. Prandaj, ne intelektualët duhet të jemi gjithnjë aktivë, në këmbë e të përkushtuar për vendlindjen tonë, që ka shumë nevojë për rizgjim ekonomik, kulturor e shpirtëror.

* * *

Gjithë materiali i mësipërm mbi krahinën e Muhurrit u farkëtuan në prushin e dijeve dhe në kudhrën e kohës të të moshuarve Ymer Pira (i cili ka gati një libër prej 300 faqesh), Rakip Balliu, Daut Pira, Nazif e Xhelil Mëziu, Hasan e Kapllan Qoka, Xhemal Berisha, Bajram e Ismail Mani, Osman Losha, Hamit e Rufat Balla, Xhetan e Hakik Preçi, Hasan Laci etj.Nën shembullin e tyre duhet të ndërtojmë piramidën ekonomike, kulturore dhe të traditave, ndërsa në Kodrën Shën Diellit një përmendore kushtuar kësaj perëndie jetëdhënëse pellazge, që ka ardhur deri këtu në gjirin tonë, në dheun e trimërive shekullore, ku dritë duhet t'iu jap vetëm pena.

Firence 06.06.2016

SHKRUAJ edhe ti një vështrim historik e kulturor **PËR FSHATIN TËND!**

Është një histori e vogël por MBETET gjatë NË KUJTESËN e vendlindjes tënde!

Pasi ta shkruash dërgoje me email në adresën **<rrugaearberit@gmail.com>**

Mos ngurroni të kërkoni ndihmë për ta shkruar. Një anëtar i stafit tonë mund tju ndihmojë FALAS !

Fotoreportazh / Udhëtim në kohë

Gjeologët dibranë që i dhanë atdheut thesare...

23 Gushti është Dita e Gjeologut, një ditë që festohej an' e kand vendit, maleve ku kërkoheshin mineralet, kromi që vetëm nga vendburimi i Bulqizës-Batrës-Selishtës-Cërujës formonte një rrjedhë lëvizjeje për eksport me rreth një milionë tonë në vit, bakri që pasi zbriste nga malet e Mirditës, Pukës...i jepte vendit metalin për uzinën e telave në Shkodër dhe floririn e rafinuar në Rubik, gjeologët...

Në këtë ditë, gjeologët, miq të jetës sime, nuk mund ti harroja për ti përjetësuar në një foto reportazh...

Abdurahim Ashiku



















reportazh

Dibra e Arbrit



Përtej Qafës së Bullit, nga thellësia e luginës vijnë rënkimet e fragmenteve të pambaruara të Rrugës së Arbrit.

Nga **EDISON YPI**

Një rrugë e munguar, për shembull Rruga e Arbrit, është një dëshpërim i madh, por s'ke ç'i bën, se për mungesën e saj faji s'është i yti.

Një rrugë e nevojshme që ekziston por mbi të nuk ke kaluar, për shembull rruga Kukës-Peshkopi, është dëshpërim edhe më i madh, sepse për përtacinë tënde fajin e ke vetë.

Për qefin tim, me naftën time, me kohën time, edhepse nga ky dhe të tjera shkrime nuk marr asnjë kacidhe, atje jam nis. Atje ku po nuk vajta fajin e kam vet, dhe ferri më pret.

Brenda tunelit shpejtësia e lejuar është 70 kilometra në orë. Un ja kërcas me 120 në orë prej qefit të papërmbajtur që nga Tirana në Kukës, jo falë kurvit, as falë Allahut, por falë Doktorit, mundem me shku në më pak se 2 orë.

Para 10 vitesh Kuksi ishte Ferri, Prizreni Parajsa. Tani Kuksi dhe Prizreni janë barazuar, janë bërë si Purgatori.

Në Kukës hëngra një pilaf me kos. Pilafi tmerr, kosi llahtarë. Megjithatë i hëngra për hatër të pronarit që më bëri komplimenta për shkrimet e mia që sipas tij janë më të bukura se livadhet e Xhehenetit dhe më të tmerrshme se zifti i Xhehenemit.

Allahu i ka ndrequr gjërat në atë mënyrë që kënaqësia e bukurisë së një peisazhi të mos vijë befas me të tremb sa me ta ndal zemrën, por pakngapak. Në dalje të Kuksit drejt Dibrës, Allahu këtë rregull nuk e ka zbatuar. Aty katundet, fushat, kodrat, bregoret, përrenjtë që zbresin nga Gjallica, çfaqen aq papritmas sa po nuk pate kontroll të fortë të shqisave mund të bjeri damllaja.

Ik e ik nëpër atë mahnitje, ke ndjesinë se je duke i ra mespërmes Parajsës. Një kuksian anës rrugës së asfauar, thotë se nuk ka qënë kurrë në Dibër. Pas këtij kuksiani katastrofik, një tjetër kuksian thotë se nuk ka lënë vend të Shqipërisë pa e shkelur, në majë të Gjallicës ngjitet të paktën tre herë në vit.

Në Kolosjan shtatë a terë kollos-janë pijnë kafe. Nguten sejcili me tregu nga një mesele me heroizma historike shqiptareske. Njëri nga kollosjanët tregon për mijra serbë të therur si bagti, si berra, si shqerra, mu aty pranë ku është dhe një lapidar përkujtimor. Kollosjani shton se në atë betejë erdhën edhe gra që dhanë ndihmesën e tyre në therjen e serbve me sopata dhe thika, si dhe një Bej dibran me dy mijë trupa dhe katër topa që ja shprazi serbve dhe i bëri çika-çika sa përroi u bë gjak i kuq.

Pas nja njëzet kilometrash peisazhin me më tepër fshatra se natyrë e zëvendëson pamja edhe më e bukur me më tepër natyrë se fshatra.

Kthesat e panumurta, ato që kudo tjetër të lodhin dhe të mërzisin, këtu janë ndihmëse të mira për t'i kqyrur pamjet e hatashme sa më hollësisht nga të gjitha këndet.

Diku pyet veten; Morpo ku dhe pse është e bukur kjo rrugë ?! Këtu tek kjo qafë, tek ky përrua i shpejtë, tek kjo korie e gjelbër ? Apo atje tek ai shkëmb larg në horizont ku thuhet se është Lura ? Shpejt vjen në vete dhe kupton se bukuria e këtij vendi nuk ka lidhje me çka sheh syri, dëgjon veshi, prek dora, nuhat hunda. Nuk je duke pa, nuk je duke nigju, nuk je duke nuhat, madje as nuk po udhëton dhe as po ëndërron. Ajo që po bën është me pirun, thikë, dhëmbë, gjuhë, po ha llokmën.

Duke ik e duke fol me kalimtarët, bindesh se dibrani ja ka marrë dorën dynjallikut. Dibrani di ç'bën. Dibrani nuk ka treguar ndonjë zell të madh për të ardhur në Tiranë që është arena shkërdhatokratike më e madhe e botës. Dibrani nuk ikën kuturu, dokudo, dosido. Dibrani ikën ku ka rregull, ku ka seriozitet, ku është mbretëri, madje perandori, në Angli, ku me sterlinat që fiton duke punu në një Car Wash mundet me ngrejt vilë këtu në Dibër, këtu në Kalanë e Dodës.

Një vigan kuksian 60 e kusur që e ka shtëpinë atje poshtë thellë në luginë zhytur e mbytur në gjelbërim ka ndalur Benzin në një qafë dhe po pret djalin dhe nusen e djalit me ik diku. A e shet shtëpinë ? i them lumjanit për ta ngacmuar. Tmerrohet. Botën me ma fal, thotë,nuk luj prej këtu.

Një mesogrua me kosore në sup që, nuk guxoj ta quaj fshatare apo katundare, jo vetëm pranon të fotografohet por dhe falenderon. Pyes disa adoleshentë nëse mund t'i fotografoj. Thank you, no foto, thotë njëri prej tyre, kemi të tjera plane. Çfarë planesh keni ? Po presim të ikim në Angli, përgjigjen tre a katër njëherësh.

Një vajzë e vogël spjegon me zell; Xhaminë e kanë ndërtuar ustallarët. Ai shkëmbi i madh nuk është i zi por i bardhë sepse ashtu e ka bërë Allahu.

Barinj dhe baresha 10-15 vjeçarë me nga katër a pesë dhi a dhën thonë se tanipërtani janë të vegjël por pas do ikin. Jo Greqi, Itali, e më the e të thashë. Vetëm në Angli.

Në një kafene tek një kthesë mbytur në jeshilllëk janë rrafshu disa tipa që deklarojnë me vendosmëri dhe janë gati të firmosin e vulosin se aty fillon Kalaja e Dodës. Ku është "Kalaja" dhe kush ka qënë "Doda", askush nuk e di. Kalaja e Dodës dhe Anglia janë dy popuj miq, thotë njëri, i cili, ndërkohë që flet, nxjerr nga xhepi nje shuk me sterlina. Këtu ka një bio kos me të ik menia e kres. Naltmadhnin e Tij kosin bio e përgatit dikush që mburret se ka qënë mbi 20 vjet oficer sigurimi në kufi, Ersekë, Gjirokastër. Ka qënë strategji e kurvit që spiunat e jugut i çonte në veri dhe spiunat e veriut i hidhte në jug. Ore, i them sigurimistit të konvertuar në kosaxhi, a ke vrarë shqiptarë që kanë dashur të arratisen ? Po, por jo shumë, nja tre a katër gjithsej, thotë dhe qesh.

Ik e ik i mbështjellë me ëndërr. Diku vij në vete, nxjerr kokën nga jorgani i ëndrrës. Kjo rrugë që po shijoj nuk mund të jetë llokëm mishi. Nuk mund të jetë as cigare e përdredhur me filtër në Kukës dhe prush në Peshkopi, As llullë e gjatë me bisht të hallakatur si gjarpër kilometrik. Është Nargjile që zjarrin e ka në Peshkopi dhe thithet në Kukës.

Duke ik e duke fol me kalimtarët, bindesh se dibrani ja ka marrë dorën dynjallikut. Dibrani di ç'bën. Dibrani nuk ka treguar ndonjë zell të madh për të ardhur në Tiranë që është arena shkërdhatokratike më e madhe e botës. Dibrani nuk ikën kuturu, dokudo, dosido. Dibrani ikën ku ka rregull, ku ka seriozitet, ku është mbretëri, madje perandori, në Angli, ku me sterlinat që fiton duke punu në një Car Wash mundet me ngrejt vilë këtu në Dibër, këtu në Kalanë e Dodës.

Në kohën e kurvit për lumjanët dhe dibranët thuhej me përçmim se nuk duan më tepër se "buk e grosh e kep" pra shkëmb. Tani lumjani nuk do më tepër se Angli, Londër, biftek, car wash.

Në vende të tjera të bukura vret menjen kur është më mirë me kalu andejpari, në behar, në dimër, në muzg, në agim, nën shi, nën breshër ? Këtu jo. Këtu është bukur kurdoherë, ditën, natën, në çdo orë, në çdo stinë.

Ja dhe zjarri i Nargjiles prejnga shpërthejnë dëshirat, nis dehja, thuret ëndërra.

Peshkopia dinamike, produktive, e zhurmshme, e rrëmujshme, krejt njësoj si truri i dibranit që në kërkim të perfeksionit nuk i jep rëndësi hollësirave.

Hyj në një qëndër zgjedhore demokrate. Bosh. Pyes dikend në trotuar. Ku jeni ? Jemi në terren, thotë karakolli demokrat. Klyshat e kurvit për me i dhën fitoren kandidatit të tyre kan vu në lëvizje oficerat e sigurimit, ata që në atë kohë bashkëpunonin me oficerat e UDB-së për me kthy të arratisurit ose me i vra mbi telat me gjëmba, tani bashkëpunojnë në biznes.

Hyj te një qëndër propagande zgjedhore socialiste. Plot me simpatizantë. Sapo hap gojën për me i pyt pse nuk dalin në terren, pse nuk zbresin në arenë ku bëhet lufta, ku ndeshen alternativat, para më del një i moshuar me kasketë që më thotë me zë të trashë; Ik se s'ta kemi ngenë.

Si urdhon zoti oficer i sigurimit të kurvit, ja po iki.

Krahas të tjerave, Nëmërçkës, Divjakës, Vjosës, Pukës, Krrabës, edhe nargjilja Kukës-Peshkopi meriton të jetë njëra nga gratë e mia. Megjithatë, sado e dëshiruar, hutonjëse, përvëlonjëse, nuk mund të kthehem nga nargjilja të cilës sapo ja pashë fundshpinën, sapo e lëpiva, e kafshova, e thitha, me të cilën sapo u ndava.

Për shkak të një rrethrrotullimi pak sa nuk përfundova në Bllatë.

Në Shupenzë groshët e zjera ishin për ibret.

Përtej Qafës së Bullit, nga thellësia e luginës vijnë rënkimet e fragmenteve të pambaruara të Rrugës së Arbrit.

Duke zbritur nëpër leqet e laqeve të loqeve të koqeve të Klosit, pasi më siguroi se ishin të freskët të sapokëputur në kopësht, një djalë i vogël më shiti fiq frigoriferi.

Në një Car Wash ku punojnë at e bir, biri nën 20 po përgatitet me ik në një Car Wash në Londër, ku pasi do punojë disa vite do kthehet të ndërtojë vilë me katër kate, basen të kaltër, luanë allçini te porta.

Ku mora ujë, shitësi më siguroi se pas mbarimit të Rrugës së Arbërit, Klosi do jetë një lagje e Tiranës, Burreli si Durrsi, qejflinjtë dhe qejfleshat e banjove hidrike do mund të bëjnë jo vetëm "shkuma party" por edhe "balta party" në liqenin e Ulzës ku e vetmja gjë që duhet të bëjnë kujdes është të ruhen mos u futen nëpër shalë e nëpër brekë gjarpërinjtë, ngjalat, gaforret e liqenit.

Mes Burrelit dhe Rrëshenit puntori i karburantit që i thashë se jam kolonjar me banim në Tiranë, më pyeti; I cilit fis je në Tiranë ?

Ku një perri' beqare e përjetëshme punon në një restorant, mora groshë që i hëngra në makinë.

Tek një katund ku sa herë kaloj shoh një Bocca di Rosa, bleva një kalli misri të pjekur.

Mbi dhjetë orë në timon pa u ulur në asnjë kafene dhe në asnjë restorant.

Ka dhe plot bukurira të tjera Shqipëria. Devolli, Myzeqeja, Zadrima, Tropoja, Mirdita, janë njëra më e bukur se tjetra. Por s'ka si Dibra, që kurrë nuk ka qënë dhe kurrë nuk do jetë e kurvit, por vetëm e Arbrit.

(MAPO)

Një libër që përcjell mesazhe mbresëlënëse

Nga **RENATO TOTRAKU**

Rastësisht më ra në dorë libri me titull "Dallgët e jetës time" me autor Prengë Përshqefa. Dorëshkrime të lëna nga autori, por që u botuan 15 vjet pas ndarjes së tij nga jeta.

Në fakt nuk është hera e parë që shkruhet për Prëngën, pasi emri i tij përmendet edhe në vepra te ndryshme historike,nje nder to"Arsimi dhe kultura në Mat" e studiesit,historianit Ferit Këputa.

Libri fillimisht përshkruan prejardhjen e fisit Përshqefa, vendndodhjen e fshatit Urakë, marrdhëniet e mësues Prengës me banorët e zones ku u rrit dhe jetoi, dhe punën e bërë prëj tij si mësues i biokimisë në shumë vite e drejtor në shkolla të ndryshme të rrethit të Matit.

Në mënyrë të përmbledhur mund të them, që ky libër do të mbetet një thesar dhe një pasuri, jo vetëm për trashëgimtarët e autorit, por edhe për komunitetin e krahinën e sidomos një model këshillues për arsimtarët e brezit të ri, që të jenë të devotshëm dhe t'a dashurojnë profesionin e mësuesit dhe të jenë të suksesëshëm në punën e tyre.

Ja si thoshte ai : "Gjatë gjithë jetës time një pjesë të të ardhurave që kam siguruar nga puna ime i kam harxhuar për të blerë libra të ndryshëm. Po nuk lexove dhe po të mos jesh i kulturuar në të gjitha drejtimet, nuk mund të bëhesh kurrë një mësues i mirë".

Dikush don të dijë, kush është Prëngë Përshqefa?

U lind në Shtrungaj të Bajrakut të Fanit në Mirditë me 17 shkurt të vitit 1939, në një familje me tradita të hershme atdhetare,



patriotike, luftarake, mikpritëse dhe bujare. I ati i tij, Zefi, kur Prenga ishte ende i vogël, u shpërngul në fshatin Urakë të rrethit të Matit për një jetë më të mirë.

Babai i tij, Zefi dhe e ëma e tij, Prena treguan kujdes të veçantë për rritjen dhe edukimin e Prengës, si më i madhi i fëmijëve të tyre, Bardhës, Ndreut dhe Gjergjit për t'ju bërë krah në punë dhe në jetë. Pasi mbaroi shkollën fillore në Urakë e atë shtatëvjeçare në Shkodër nisi mësimet në shkollën e mesme pedagogjike në Peshkopi, të cilën e përfundoi në vitin 1959 me rezultate shumë të mira, ku fitoi edhe profesionin e mësuesit.

Fillimisht emërohet mësues në shkollën shtatëvjeçare Bruç, më pas edhe drejtor shkolle. Pas dy viteve pune me arsim të mesëm, mbaroi Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës në degën Biokimi. Pas mbarimit të Universitetit emërohet mesues e me pas,drejtor shkolle në fshatin Rremull, dhe gjatë viteve 1968 – 69 kryen edhe shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Pas mbarimit të ushtrisë punoi në shkolla të ndryshme të rrethit, si në shkollën e mesme të Teknikumit të Minierave në Krastë të Martaneshit, më pas për një periudhë 6 – mujore punoi në ndërmarrjen e Peshkimit, Ulëz.

Nga viti 1974 e deri në vitin 1994, sa doli në pension, ai punoi në shkollën e fshatit të tij, Urakë. Edhe pas daljes në pension ai nuk hoqi dorë nga profesioni i mësuesit, sa që Drejtoria Arsimore e rrethit Mat e ktheu atë përsëri të punojë në arsim gati për dy vite nga viti 1997 deri në vitin 1999, kur ai sëmuret rëndë.

Gjatë kohës në punë për një cilësi e rendiment të lartë, për figurë të pastër moralo-politike është dekoruar me Medaljen "Naim Frashëri" dhe distiktivin "Mësues i dalluar".

Ai nuk qe vetëm një kuadër i mirë, por edhe një prind shembullor . Së bashku me bashkëshorten e tij, Mrikën lindën, rritën dhe edukuan fëmijët e tyre: Viktorin, Linditën, Astritin, Florën dhe Teutën, aktualisht të gjithë familjarë dhe gëzojnë respekt aty ku jetojnë dhe punojnë.

Por jeta e tij do këputej në mes, kur familja dhe shoqëria do kishte nevojë për të, sepse me 12 janar të 2001-it në moshën 62 vjeçare ndahet nga jeta për shkak të një sëmundjeje të rëndë.

Vlerat e këtij personazhi duhen parë me objektivitet, pasi ato vlejnë shumë si për të sotmen ashtu edhe për të ardhmen e shoqërisë sonë.

BOTIME TE REJA



Jeta nuk do gjumë - Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-71-6
Çmimi: 500 lekë

Balliu është përfaqësuesi i atij brez të rinjsh të Shqipërisë që braktisi bankat e shkollës për të siguruar një jetë më të mirë. Atë që ky vend nuk u ofroi në rininë e tyre, ata e gjetën në një vend tjetër. Por malli dhe dashuria për vendlindjen e rritën ndjeshmërinë dhe dashurinë ndaj Atdheut. Dhe Astriti e ktheu këtë ndjeshmëri në nivelin më të lartë artistik: poezinë.

Ftesë për bashkëpunim

Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojmë individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion
mund të shkruani në email
mbbotime@gmail.com,
rrugaearberit@gmail.com
ose mund të telefononi në numrin
069 20 68 603.
Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund
ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së
Shtëpisë Botuese M&B,
në rrjetin e librarive "Adrion",
si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>



cyan magenta yelloë black



"Takimet e Rekës së Epërme" rikthejnë gjallërinë në vendbanimet e boshatisura

Në organizim të Shoqatës Kulturore "Reka e Epërme", në fillim të gushtit u mbajt manifestimi tradicional "Takimet e Rekës së Epërme – 2016".

Manifestimi qendror u mbajt në fshatin Rimnicë, ku i pranishëm ishte edhe kryetari i Komunës së Gostivarit, z. Nevzat Bejta.

Në fjalimin e tij, kryetari Nevzat Bejta vuri në dukje që realizimi i këtij manifestimi ka një rëndësi të veçantë nga fakti që manifestimi mbledh në një vend të banorët me prejardhje nga vendbanimet e Rekës së Epërme.

"Është bërë një traditë e bukur dhe për të tretin vit realizohet ky manifestim ku tubohen banorët e Rekës që janë shpërngulur në vende të ndryshme. Këtë vit u bë një ceremoni e bukur me prezantimin e Dasmës së Rekës së Epërme. Kontribut kanë dhënë shumë veprimtarë nga trojet shqiptare, shumë banorë të kësaj ana dhe me formimin e shoqatës së rekalinjëve është bërë më i lehtë organizimi i manifestimeve të tilla. Me dasmën e Rekës dëshirohet të prezantohet fakti se Ne jemi banorët e parë të kësaj ane dhe se i kemi ruajtur ndër breza traditat e vjetra të paraardhësve tanë, Ilirëve. Një komb që ruan doket, traditat dhe zakonet e veta, ai komb nuk ka mundësi që të zhduket, sepse kultivimi i këtyre veprave ndër breza bën që gjeneratat e reja të mos harrojnë këto vlera dhe pasuri shpirtërore", shtoi kryetari Nevzat Bejta.

Kryetari i Shoqatës Kulturore "Reka e Epërme", Xhelil Rufati falënderoi drejtuesit e Komunës së Gostivarit dhe me theks të veçantë kryetarin Nevzat Bejta i cili ka prejardhje nga Reka, për mbështetjen e ofruar në organizimin e këtij manifestimi.

"Realizimi i këtij manifestimi ka marrë një rrugë të mbarë, ashtu siç mund të shikohet nga prania e madhe e publikut dhe përmbajtja e programit. Manifestimi kaloi shkëlqyeshëm dhe ishte viti i tretë që u organizua. Në këtë manifestim grumbullohet të gjithë rekanët dhe gjithë dashamirët të cilët kanë fisni, shoqëri apo afërsi me rekalinjë", deklaroi kryetari i Shoqatës Kulturore "Reka e Epërme", Xhelil Rufati i cili u shpreh që beson që ky manifestim do të ketë jetë të gjatë. Rufati falënderoi mbështetësit e këtij manifestimi, ndër të cilët veçoi edhe Komunën e Gostivarit.

I pranishëm në edicionin e tretë të manifestimit tradicional "Takimet e Rekës së Epërme – 2016", ishte edhe autori i librit "Josif Bageri", Ruzhdi Mata nga Shqipëria, i cili e shkroi librin e parë dedikuar Josif Bagerit që para 40 vitesh.

"Është bërë një libër dedikuar Josif Bagerit dhe Rekës së Epërme, por pa e parë me sy. Është meritë e organizatorëve që e bëjnë këtë manifestim. Unë mund të shkruaj se janë kështu apo ashtu doket, por është burimore të shohësh me sy se si duket ato", shtoi Mata.

Në manifestim u prezantua një program i begatë artistik dhe që synonte të nxjerr në pah traditat, doket, zakonet dhe të kaluarën e bukur të Rekës së Epërme. /Radio Vala



Me rastin e manifestimit tradicional "Takimet e Rekës së Epërme – 2016", kryesia e shoqatës ka nderuar me Mirënjohje edhe redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit" me motivacionin "Për kontributin e dhënë në organizimin e manifestimit tradicional "Takimet e Rekës së Epërme 2016", firmosur nga kryetari i shoqatës Xhelil Rufati.

Me këtë rast, redaksia falenderon drejtuesit e shoqatës, dhe ashtu si dhe herët e kaluara, shpreh angazhimin e saj për botimin e materialeve të tjera që kanë të bëjnë me Rekën dhe rekasit kudo që ata punojnë dhe jetojnë.



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit
ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

SHTËPIA E LIBRIT FLETA XXI BOOK HOUSE PESHKOPI

LIBRARIA FLETA XXI, PRANË MUZEUT, PESHKOPI

Libraria e vetme që ka ekskluzivitetin e e shpërndarjes së librit shkollor në Dibwë

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën
<rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

KËTU MUND TË ISHTE REKLAMA JUAJ PËR VETËM 1000 LEKË

Porositeni: 069 20 68 603

Bëj pajtimin tënd me
PayPal
përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Dëshmi të refugjatëve dibranë në Tiranë, shpërngulur nga trojet e tyre me dhunë nga ushtria serbe

Rruga e Arbërit nr. 123
histori

Mes refugjatëve dibranë në Tiranë

Nga **JUSTIN GODART***

DOKUMENTET diplomatike na e tregojnë Jugosllavinë duke marrë gjithmonë pozicion përpara Konferencës së Paqes për autonominë e Shqipërisë, kundër mandatit të Italisë, dhe duke hedhur poshtë dhuratën e rrezikshme, që donte t'i bënte Konferenca e Paqes, nga territoret shqiptare.

Që nga 1913, ku ju dha një pjesë e krahinave shqiptare të Kosovës dhe të Dibrës, Jugosllavia ka fituar mjaft përvojë nga vështirësitë që paraqet çdo përpjekje për të vendosur kontroll mbi popullin shqiptar. Kjo në një farë mase e ka përmbajtur dëshirën për t'u zmadhuar në dëm të fqinjës së saj.

Prapëseprapë me Malin e Zi, ajo po merr ende toka shqiptare irredente, si ato të Hotit e të Grudës.

Ky qëndrim, që zbulon një shpirt politik të matur, dhe që është më i favorshëm për Shqipërinë, nuk përjashton që probleme shumë të rëndësishme të lindin ndërmjet Jugosllavisë dhe asaj. Ka rëndësi, në interes të drejtësisë, dhe për paqen në Ballkan, që ato të zgjidhen në mënyrë të qartë.

Së pari, Serbia ka një politikë brutaliteti ndaj popullsisë së Kosovës, që tingëllon me dhimbje në zemrat shqiptare. Ne do të japim, mbi këtë temë, disa dokumente në kapitullin "tokat e ndara shqiptare".

Së dyti, Serbia pushtoi, në gusht 1920, krahinat e Shqipërisë së veriut. Ajo i mbajti ato nën sundimin e saj dhe u përpoq të zgjeronte një pushtim të shoqëruar nga vdekje mizore dhe shkatërrime metodike derisa hyri Lidhja e Kombeve.

Kjo është ajo që do të bëjë objektin e faqeve në vazhdim.

Në muajin gusht të 1920, një bandë e krijuar nga rreth 250 vetë, e komanduar nga Alush Lohe, musliman nga paria e Shkodrës, me të cilin ishte një katolik, partizan i Esad Pashës, Luk Luka, përparoi nga Shkodra deri në Koplik.

Qeveria shqiptare do të dërgonte kundër saj një kompani. Pas një luftimi që i lejoi trupat e rregullta të vërejnë në bandën e kryengritësve praninë e ushtarë serbë me uniformë dhe kapjes së mitralozëve serbë, rebelët tërhiqen në anën tjetër të kufirit deri në Tuz.

Serbët, duke zënë pretekst nga ky incident, do të depërtojnë atëherë në territorin shqiptar dhe do të vijnë deri në Vrakë, në portat e Shkodrës. Populli i Shkodrës, i kërcënuar, merr armët dhe do t'i përzejë serbët deri në një vijë të hequr matanë territorit shqiptar.

Në malet shqiptare, jehonat e një gjuajtje pushke shkojnë larg, kthehen dhe zmadhohen. Po ashtu, lajmi i një beteje aty përhapet shpejt dhe zgjon shpirtin e luftës. Nga ana e Dibrës, serbët lëvizin shumë, organizojnë bandat, duke intensifikuar propagandën, duke kërcënuar fshatarët që pohojnë me ngulm të qënit shqiptar. Një revoltë do të shpërthejë, serbët djegin disa fshatra. Popullsia do të bëjë 600 të burgosur serbë, një komandant, 2 kapitenë, 5 oficerë, do të kapë 12 topa dhe nja 50 mitralozë, por nuk do t'a kapërcejë kufirin. Megjithatë, përpara këtij zhvillimi, ai ishte zbrazur nga serbët ashtu si Dibra e Gostivari. Serbët, duke marrë përforcime, do të sulmojnë atëherë me trupa të shumta dhe bandat e tyre do të arrijnë deri në 8 kilometra nga Tirana. Kjo ka ndodhur në shtator 1920; kjo periudhë la gjurmë të pashlyera prej djegjes së fshatrave, dhe masakrave. Serbët ishin shtyrë deri në linjën e kufirit të përvijuar nga gjenerali Franchet D'Esperey kur austriakët u tërhoqën. Përveç disa pjesëve të thella, herë serbe, herë shqiptare, kjo është vija që u bë një front i vërtetë, sepse ishte gjëndja e luftës, serbët uzurpojnë një territor ku të gjithë fshatrat ishin shqiptare dhe muhamedane.

Kemi dashur t'a njohim gjendjen drejtpërsëdrejti, aq sa qe e mundur, ashtu siç ishte ajo në prill 1921.

U shtymë deri në frontin shqiptaro-serb të Kastratit.[1] Përpara kishës, na mori prifti katolik me uniformë ushtarake. Një batalion shqiptar është atje i përforcuar nga populli i armatosur. Posta e avancuar serbe është 400



metra në shpat të kodrinës. Duke u kthyer, pamë fshatrat e shkatërruara dhe na treguan, në vend, peripecitë e betejës së zhvilluar që e bënë popullin e Shkodrës të ngrihet spontanisht kundër pushtuesit.

Një prej drejtuesve të fshatit na përshkruan të gjitha vuajtjet që iu bënë banorëve në krahinën e Kastratit. Gratë u përdhunuan, pesë prej tyre vdiqën nga flakët që shkatërruan ndërtesat e tyre. 1200 shtëpi u dogjën, gjithë malli u vodh. 1500 deshë, 600 viça, 1200 lopë u morën nga serbët. Na tregon nga pjesa e hapur e një qafe mali fushat pjellore shqiptare të cilat serbët ua lanë të papunuara, dhe ndjen çfarë revolte zien përbrenda tek këta fshatarë të fortë dhe çfarë dhimbje është për ta të kesh kështu, vazhdimisht përpara syve të mirat familjare, të të bëhet përkohësisht toka e huaj, dhe të mos mund të shkosh t'i japësh asaj punën tënde frytëdhënëse. E këta njerëz, shumica refugjatë, ose pasardhës të refugjatëve të Hotit e të Grudës që ju dhanë Malit të Zi nga Kongresi i Berlinit, pësojnë, për të dytën herë, pushtimin brutal të vatrave dhe të tokave të tyre. A nuk do të jenë ata krejtësisht të përbuzur nëqoftëse egërsia ndaj tyre nuk mbetet me kaq dhe nëqoftëse, me shpresë, pushkët e tyre heshtin?

2000 prej tyre, na treguan, se erdhën në ushtri, u paraqitën tek gjeneral de Fortou në Shkodër, për të kërkuar drejtësi nga Franca dhe për t'u vendosur në dispozicion të tij për lirinë e Shqipërisë. Dhe dëshira e tyre, ashtu si e gjithë shqiptarëve të veriut u formulua spontanisht nga një malësor me kushtet e mëposhtme.

Kur gjuajtësit tanë alpinë francezë, në një udhëtim të gjatë të pandërprerë të mrekullueshëm, erdhën nga Shkupi në Shkodër, përmes malesh, rrugës, një burrë u sëmur, dhe e lanë në shtëpinë më të afërt. Ai u mjekua dhe kur mund t'a duronte udhëtimin, malësori që e kishte strehuar do t'a hypte në kalin e tij dhe do t'a sillte në Shkodër. I paraqitur tek gjenerali de Fortou, shqiptari mori falenderime të ngrohta, dhe duke e përcjellë, gjenerali i jep një çek 1000 frangësh. Malësori do të refuzonte me thjeshtësi, me dinjitet. Mikpritja shqiptare nuk paguhet. I dhamë atëherë një dekoratë, që nuk i bëri përshtypje. Duke dashur, me këtë këmbëngulje, që t'i dëshmojmë atij mirënjohjen dhe që nuk e dimë se si, ai mendoi të dalë nga gjithë ky siklet duke kërkuar: "që gjenerali të na çlirojë nga serbët".

Refugjatët e krahinave të veriut të pushtuar nga serbët u strehuan në gjithë Shqipërinë.

Ata ishin në numër 40.000.[2]

Në Tiranë, qeveria, me ndihmat e Kryqit të Kuq amerikan, vendosi disa menca për të ushqyer këta fatkeqë. Ne vizituam njërën prej tyre të vendosur në sheshin e lutjeve "Namazgja", të rrethuar me një mur të dyfishtë, një guri dhe një selvish, këto të larta, të trasha, të pandërprera, që fshehin gjithë horizontin, lejojnë të shihet vetëm qielli, dhe duke e bërë pak të zezë katedrën e bardhë me gëlqere përpara së cilës arrijmë nga një shkallë e thiktë. Nën çadra shpërndahet ushqimi, dhe është një gëlim të mjerësh të uritur, pothuajse të zhveshur, të vegjëlish me sëmundje lëkure, të brejtur nga mizerja, grash të vjetra, të tmerruara nga varfëria. Përfitojmë nga grumbullimi i përditshëm për t'i mbledhur fëmijët nën një dru dhe për t'u bërë mësim. Një kalama na reciton besnikërisht një strofë patriotike nga një poemë shqiptare; ligjërimi i tij është i pastër, me një kadencë të çuditshme me zë të lartë dhe një këmbëngulje mbi ritmin që të bën përshtypje të madhe.[3] Kjo është, natyrisht, nga energjia, nga shprehja e vullnetit. Turma e vuajtur afrohet dhe kur fëmija flet për lirinë, besimin tek atdheu, ajo duartroket. Gjithë Shqipëria zbulon atje shpresën përherë të zgjuar me gjithë mizorinë e momentit.

Ne duam të dëgjojmë nga vetë refugjatët, tregimin e vuajtjeve të tyre. Me 2 maj 1921, në Tiranë, pyetëm një pjesë të mirë, duke patur pranë një përkthyes të sigurtë. Prej tyre mundëm të dëgjonim akoma më shumë sepse, duke ditur që ankesat e tyre do të gjenin një jehonë, ata shpejtonin me qindra për t'i formuluar ato. Këta ishin dibranë.

Një burrë nga Kovashica, Baftjar Kuka, na tregon: Ditën e pestë të Bajramit të vogël, në gusht 1920 (17 ose 18), ushtarët serbë do të vijnë dhe do të mbledhin në sheshin e fshatit kryetarin dhe banorët. Pa shpjegim, serbët hapin zjarr. Kryetari, Sali Lami, u vra, si edhe gjashtë persona të tjerë ndër të cilët hoxha Elmaz Jashari, që u shpua me bajonetë me djalin e tij të vogël pranë pusit. Fshati, i krijuar nga 40 shtëpi, nuk u kishte bërë asnjë rezistencë; përkundrazi, u kishin ofruar ushtarëve serbë bukë, kripë dhe kos. Banorët, përpara goditjes nga zjarri i armëve do të mërrnin arratinë. Baftjar Kuka, që kishte një shtëpi dhe 40 kokë bagëti, i humbi të gjitha.

Ai shton se pesë minuta nga Kovashica, një fshat tjetër me 60 shtëpi, Dovolan, u shkatërrua plotësisht. 22 vetë u vranë, sidomos një fëmijë dy vjeç që ishte në djepin e tij.

Ja Ali Cara, nga fshati Kandër që numëronte 70 shtëpi. Serbët mbërritën aty afër mbrëmjes,

> Rukie Mustafa është një grua shumë e vjetër. Ajo ka si veshje kryesore një xhaketë burrash pa mëngë dhe të grisur në mënyrë të paimagjinueshme. Pjesa tjetër janë lecka të mbivendosura dhe të grumbulluara nga shiu. Ajo kishte qenë e pasur. Tufa e saj kishte 150 krerë, nga të cilat 15 viça dhe 7 lopë. Ajo nuk ka më asgjë, por qëndrimi i saj është plot dinjitet, fisnikëria vetë. Djali i saj 30 vjeçar u masakrua. Sulmi i serbëve ishte kaq i papritur saqë ata që nuk ikën, u masakruan. Fatlumë ata që mundën të merrnin një fëmijë mbi shpinë. Një emocion më mbërthen si darë në këtë moment. Vajza dhe djali i saj (3 vjeç) u dogjën të gjallë në shtëpi.

një orë para perëndimit të diellit. Ata qëlluan mbi banorët, shumica e të cilëve vdiqën; ndërmjet të vdekurve kishte gra dhe fëmijë. Ai u plagos. Serbët i dogjën shtëpitë.

Pastaj, u vjen rradha njerëzve të fshatit Sllatinë. Sllatina numëronte 120 shtëpi dhe 500 banorë. Prej tyre mezi kanë mundur t'i shpëtojnë vdekjes 100.

Nexhip Rexhepi, është një fshatar i ashpër me ngjyrën e tokës. Serbët mbërritën ditën e pestë të Bajramit të vogël. Ata vranë nënën, gruan dhe vajzën e tij pesë vjeçare. Shtëpia u dogj. Ai i pa serbët të qëllojnë trupat e shtrirë përtokë dhe, kur ata lëviznin, i shponin tejpërtej me bajonetë.

Gruaja, Rabie Vehapi, ka mundur të shpëtojë me fëmijët e saj (5 dhe 8 vjeç). Burri dhe vëllai u masakruan. Asaj i thanë që shtëpia i qe shkatërruar. Kishte vetëm lecka me baltë që mezi e mbulonin. E megjithatë, kishte pesë dhi, dhjetë deshë, një lopë, disa plaçka dhe një mobilje.

Rukie Mustafa është një grua shumë e vjetër. Ajo ka si veshje kryesore një xhaketë burrash pa mëngë dhe të grisur në mënyrë të paimagjinueshme. Pjesa tjetër janë lecka të mbivendosura dhe të grumbulluara nga shiu. Ajo kishte qenë e pasur. Tufa e saj kishte 150 krerë, nga të cilat 15 viça dhe 7 lopë. Ajo nuk ka më asgjë, por qëndrimi i saj është plot dinjitet, fisnikëria vetë. Djali i saj 30 vjeçar u masakrua. Sulmi i serbëve ishte kaq i papritur saqë ata që nuk ikën, u masakruan. Fatlumë ata që mundën të merrnin një fëmijë mbi shpinë. Një emocion më mbërthen si darë në këtë moment. Vajza dhe djali i saj (3 vjeç) u dogjën të gjallë në shtëpi.

Xhevria, gruaja e Ibrahimit, mbulohet me një pëlhurë çadre kaq të përdorur sa është sfungjerosur. Burri i saj u vra, fëmija në djep u dogj brenda shtëpisë. Ajo tregon sulmin, po po po po...imiton zhurmën e automatikëve serbë. Mundi të merrte një fëmijë, por për këtë i është dashur t'i lutet me lotë në sy komandantit serb. Ajo u përdhunua dhe ky kujtim duke iu shtuar të tjerëve bën të derdhen lotët e saj.

Maliq Osman Lleshi, nga fshati Muhur, ka një fizionomi inteligjente dhe të gjallë. Ai është plagosur dhe çalon. Fshati u rrethua, u plaçkit dhe u dogj. Tre vetë u vranë.

Nga fshati i Venishtës, që numëronte 70 shtëpi dhe 280 banorë, paraqitet Naçe Abdullahu, e cila, megjithë mizerjen e papërshkruar të veshjeve që e mbulonin, thonjtë i ka të ngjyer me kujdes dhe Hysen Sulejmani që, përkundrazi ka një gjëndje shumë të pranueshme.

Naçe Abdullahu përshkruan shpejt makthin që e bëri gjysëm të çmendur. Pesë vëllezërit e saj u pushkatuan dhe djali i saj i vogël 5 vjeçar u dogj me shtëpinë.

Hysen Sulejmani është i vetmi burrë i fshatit që ka mundur të shpëtojë. 70 vetë nga 280 kanë mbijetuar. Serbët i grumbulluan banorët,

i lidhen me litarë dhe i vranë me mitroloz viktimat e tyre.

Fshati Birduç është përfaqësuar nga një grua e varfër e mbuluar me një sargi të punuar trashë dhe lecka të qepura me spango. Ajo është çmendur duke parë masakrat e serbëve me dy vajzat dhe djalin e saj.

Kalosh Bajrami, nga Pollozhani, e ka krahun të copëtuar. Serbët, ditën e pestë të bajramit, rrethuan fshatin, morën dhjetë vetë, ndër ta edhe vëllain e tij Sulejmanin dhe i ekzekutuan me mitroloz. Shtatë nga viktimat vdiqën, tre të tjerët u plagosën rëndë. Ai ka marrë katër plumba në shpatull dhe në krah. Ne i zgjidhëm lidhjet për të parë plagët. Burrit nuk do të mund t'i shërbenin më krahët e tij. Plaçkitja serbe i rrëmbeu më shumë se 4000 napolona farë, bagëti, shtëpinë që u dogj me të tjerat, si i gjithë fshati.

Në Elbasan mblodhëm, me 27 prill, ankesat e refugjatëve nga Golloborda. Brenda prefekturës ata janë ndërmjet 2700 dhe 3000.

Ja ajo që na paraqitën delegatët e tyre:

Në gusht 1920, serbët i përzunë ata mbi linjën Franchet-d'Esperey dhe shkatërruan gjithçka të vendosur në territorin ndërmjet kufirit të 1913 dhe linjës Franchet-d'Esperey. Pastaj ata përparuan për afro 3 orë në brendësi të kësaj linje dhe vranë gjatë këtij operacioni 1000 burra, gra dhe fëmijë. Burrat mbrojtën nga djegja katër fshatrat e parë, Steblevën, Borovën, Zabzunin dhe Sebishtin, pastaj, përpara numrit të madh, ata ikën duke i lënë familjet e tyre me shpresën se do të mund të mbeten gjallë mbi tokë. Serbët, për t'i detyruar burrat të kthehen, u çuan familjet në Serbi,[4] ose më mirë i burgosën ato.

Kundër këtyre sjelljeve barbare të shkaktuara ndaj grave dhe fëmijëve, refugjatët protestojnë; ata kanë vetëm një dëshirë, të kthehen për të punuar tokat e veta.

Ankesat e tyre janë përmbledhur në një notë që na dorëzuan dhe ja thelbi i saj:

"Ne, qytetarët e Gollobordës, territor i kufirit shqiptar të 1913, duke përfituar nga vizita juaj në qytetin e Elbasanit, po ju shprehim fatin tonë të trishtuar, të shkaktuar nga Serbia zyrtare.[5]

"Pushtimi nga ushtria serbe i vendit tonë na ka lënë për një kohë të gjatë pa shtëpi dhe pa burime financiare dhe ne jemi këtu refugjatë me familjet tona, duke jetuar si punëtorë të thjeshtë dhe duke pritur nga dita në ditë tërheqjen e ushtrisë serbe prej tokës tonë.

"Ne nuk duam asgjë tjetër vetëm që Serbia të na lërë të lirë në fshatrat tona tashmë të djegura nga ushtarët e saj, duke i zbrazur ato sa më shpejt që të jetë e mundur.

"Fshatrat tona janë djegur nga serbët tre herë deri tani, në shtator 1913, në maj 1915 dhe së fundi në gusht 1920.

"Zëri i fuqishëm i Francës do të na bëjë zotër të tokave tona të pushtuara padrejtësisht nga armiqtë tanë.

"Duke patur një shpresë të palëkundur se Ju do të interesoheni për fatin tonë, ne firmosim përunjësisht, Elbasan, 25.04.1921

"Në emër të të gjitha familjeve refugjate të Gollobordës banuese në Elbasan dhe krahinat e tij, komiteti; Adem Limani, Ismail Kurtishi, Shaban Jusufi, Ramazan Sejdini, Ahmet Islami.

Këto fakte të dhimbshme u njoftuan nga qeveria shqiptare përpara Kombeve të Bashkuara e cila ua kaloi anëtarëve të saj me një dokument në datën 26 prill 1921 (dokument 41/12479/11379).

"Shqipëria e frymëzuar nga ndjenja të matura dhe paqësore të qeverisë dhe gjithë popullit të saj, dëshiron me gjithë zemër të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me fqinjët. Sidoqoftë, vështirësitë në të cilat Shqipëria ndodhet objektivisht nga ana e shteteve kufitare, janë shumë të mëdha dhe kërcënojnë errësimin e mëtejshëm të situatës.

"Serbët mbahen akoma mbi linjën e ashtuquajtur të armëpushimit që e pushtuan rreth fundit të vitit 1918 dhe e vendosur shumë këtej kufirit shqiptar të caktuar në 1913.

"Pushtimi i krahinave shqiptare nga serbët u shoqërua me akte urrejtjeje nga ana e këtyre të fundit; gjatë muajve gusht dhe shtator 1920, më shumë se 140 fshatra u rrënuan tërësisht ose pjesërisht prej serbëve në territorin shqiptar, 738 persona (gra, fëmijë dhe burra) u therrën ose u dogjën të gjallë; 6 428 shtëpi,



Kalosh Bajrami, nga Pollozhani, e ka krahun të copëtuar. Serbët, ditën e pestë të bajramit, rrethuan fshatin, morën dhjetë vetë, ndër ta edhe vëllain e tij Sulejmanin dhe i ekzekutuan me mitroloz. Shtatë nga viktimat vdiqën, tre të tjerët u plagosën rëndë. Ai ka marrë katër plumba në shpatull dhe në krah. Ne i zgjidhëm lidhjet për të parë plagët. Burrit nuk do të mund t'i shërbenin më krahët e tij. Plaçkitja serbe i rrëmbeu më shumë se 4000 napolona farë, bagëti, shtëpinë që u dogj me të tjerat, si i gjithë fshati.

101 magazina e dyqane, 113 mullinj, 50 teqe (të mbuluara), 18 xhami u shkatërruan; 11 057 750 kilogram drithë u vodhën ose u prishën; 57 072 bagëti të imta, 6 228 bagëti të mëdha, 1 535 kuaj u rrëmbyen.

"Përpara këtyre akteve armiqësore të serbëve dhe tentativave të tyre për të krijuar vështirësi në qeverinë shqiptare duke dërguar banda të armatosura në Shqipëri, qeveria shqiptare është e detyruar të mbajë trupa në kufi. Mbajtja e këtyre trupave dhe e 40 000 refugjatëve përbën, për Shqipërinë, një sakrificë shumë të madhe dhe ngarkon në një mënyrë shumë të rëndë buxhetin e saj që mezi i kalon 20 milion frangat.

"Si pasojë e kësaj situate kritike të krijuar në qeverinë shqiptare, ajo rrezikohet nga vërshimi i ekstremistëve. Do të jetë përveç kësaj shumë e vështirë të mbahet rregulli në kufi dhe të frenohet acarimi i një populli të lënduar.

"Për shkak të këtyre rrethanave, ngjarje shumë të rëndësishme mund të lindin papritmas: qetësia dhe paqja mund të jenë të kërcënuara shumë seriozisht. Kuptohet vetvetiu që një ngatërresë ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë do të shtrihet në mënyrë të pashmangshme në kufijtë e tjerë dhe zjarri i ndezur mund të shkaktojë lindjen e një përmbysjeje të përgjithshme shumë të rëndësishme. Qeveria shqiptare është deklaruar, që tani, që nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të ndodhin. Delegati i shtetit jugosllav në Konferencën e Paqes, Z. Trumbitch, shpalli përpara konferencës se qeveria e tij është për pavarësinë e Shqipërisë të 1913.

"Mirëpo, me gjithë përçapjet e shumta të bëra nga qeveria shqiptare pranë qeverisë së Beogradit, ajo refuzon të bëjë zbrazjen e krahinave që vetë i njihte si të vendosura në territorin shqiptar. Vullneti i mirë i qeverisë shqiptare nuk ka gjetur asnjë jehonë tek autoritetet e Beogradit.

Megjithatë, ekzistenca e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis Shqipërisë dhe Serbisë është një faktor i rëndësishëm për paqen në Ballkan.

"Këshillat për përmbajtje dhënë Beogradit do të mund t'u dilnin përpara të këqiave të mëdha.

Nëqoftë se Serbia zbraz krahinat e pushtuara arbitrarisht dhe tërhiqet nga kufiri që Fuqitë e Mëdha i caktuan Shqipërisë në 1913, në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur në Londër, nuk do të mbesë më asnjë burim fërkimi ndërmjet dy fqinjëve. Në të njëjtën kohë duhet t'i kështillohet Serbisë një trajtim më i drejtë dhe jo çnjerëzor ndaj shqiptarëve të Kosovës; për këtë drejtësi Jugosllavia nënshkroi tashmë duke pranuar kushtet e traktatit të Saint-Germain lidhur me të drejtat e minoriteteve. Duhet që ajo t'a respektojë nënshkrimin e saj.

Duke gjykuar këto fakte, është më se e qartë, që qëndrimi i Jugosllavisë nuk do të falej në asnjë mënyrë. Nëse, në ngjarjet e gushtit 1920, shqiptarët kanë bërë gabime, nëse në njëfarë mase ata qenë agresorët, nëse ata patën plotësisht faj, kjo nuk është aspak një arsye për të kundërvepruar me shkatërrimin dhe shfarosjen nga masakrat të grave dhe fëmijëve.

Me sa duket qeveria shqiptare i ka bërë vazhdimisht, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi të gjitha përpjekjet për të patur një marrëveshje të fqinjësisë së mirë.

Përktheu: **MIRDASH SHEHU**

(Titulli është i redaksisë. Shkëputur nga libri "Shqipëria në 1921", i Justin Godart, (Kap. VII, Shqipwria dhe Jugosllavia), përkthyer në shqip nga Mirdash M.Shehu, botuar në Tiranë, 2015. Librin mund ta gjeni në librarinë e botimeve M&B në Tiranë.

REFERENCA:

1) Me 20 shtator1921, serbët tentuan mbi këtë front një ofensivë të re, në përputhje me atë që ata bënin mbi Drin nga ana e Dibrës. "Me 20 e në vazhdim, thotë një telegram nga Tirana i 21 shtatorit, serbët kanë nisur një sulm nga ana e Kastratit, në veri të Shkodrës, por u prapsën duke lënë tre të vdekur. Humbjet e shqiptarëve janë shumë të larta si ndërmjet luftëtarëve ashtu dhe ndërmjet popullsisë rurale.

2) Mbi gjëndjen e këtyre refugjatëve, Z. Marcuard, i deleguari i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, publikoi, në shtator 1921 (Journal de Geneve, 22 shtator), raportin e parë i cili iu dorëzua Kombeve të Bashkuara. Ja pasazhet kryesore. "Janë refugjatet e qendrës dhe veriut të Shqipërisë që kujdesi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar do të duhej të përqëndronte vëmëndjen.

"Që tani, këta janë njerëzit që i gjen kudo. Krahina malore që shtrihet në veri dhe në perëndim të qytetit të Dibrës, në këtë kohë është plotësisht e pushtuar nga serbët, por ndodhet brenda kufijve të 1913. Qyteti i Dibrës, vetë, është jashtë këtyre kufijve. Kjo krahinë numëron 150.000 frymë, pjesa dërrmuese e të cilëve e ka lënë vendin përpara pushtimit serb. Sipas informacioneve të mbledhura në Tiranë, pjesa më e madhe e shqiptarëve të mbetur në krahinat e pushtuara, u zhvendos në brendësi të Serbisë. Shumë mbetën në male duke u tërhequr ose shtyrë përpara sipas sprapsjes ose avancimit të serbëve. 40.000 zbritën deri në fushë për të gjetur azil në qytetet e Tiranës, Kavajës, Krujës, Shijakut dhe Elbasanit e mbetën fare pak, 10.000, sepse rreth 10.000 vdiqën nga sëmundjet dhe humbën; të tjerë që kishin disa bagëti, gjetën krahinat malore dhe të tjerë u kthyen pas dekretit të amnistisë së Serbisë. Ka pak detaje nga situata e ditëve të fundit. Të tjerë akoma emigrojnë qoftë në Amerikë, qoftë në Turqi.

"Të mbetur, pra, rreth 10.000 refugjatë nga krahina e Dibrës, këta njerëz janë finë, të pastër, energjikë dhe plotësisht dinjitozë ndaj interesimit tuaj.

"Pikërisht në Tiranë situata e tyre më dukej më e vështirë. Ata jetojnë në çadra ose shtëpi të vjetra, ku grumbullohen 60-70 vetë në një gjëndje për të ardhur keq. Kafshët që kanë ndajnë banesën e tyre. Nuk kanë as ndonjë mobilje, as garderobë dhe janë tepër të pastër nga natyra e tyre, nuk ka tek ata grumbullime leckash e ndyrësirash që do të karakterizonin tek ne një skamje si kjo që të ther në zemër. Syri nuk të sheh veçse forma hapësire, të sëmurë të shtrirë mbi tokën e rrahur e ndërmjet të cilëve zvarriten fëmijët e vegjël.

"Në fakt për t'i ushqyer, qeveria u siguronte atyre një kilogram bukë në ditë dhe Kryqi i Kuq amerikan i Tiranës shpërndau supë deri me 1 shtator. Fondet e caktuara për këtë supë shteruan. Besoj, se do të ishte shumë e rëndësishme që të vazhdohej dhënia e supës nga e cila vareshin kaq jetë njerëzore. Sipas informacioneve të marra, ky qe një shpenzim prej 4000 franga zviceriane në muaj, dhe unë u binda që duke i vënë fondet e nevojshme në Kryqin e Kuq amerikan, ai do të fillonte shpërndarjen e saj. Shteti nuk u jepte punë refugjatëve sepse ai nuk zotëronte fondet e nevojshme për të bërë kryerjen e punëve shtesë. Në të hyrë të dimrit, ata po vuanin gjithashtu mungesën e veshjeve dhe batanijeve.

"Shërbimi më i madh që do të mund t'u jepej këtyre njerëzve nga krahina e Dibrës, do të qe të bëhej i mundur kthimi i tyre. Kjo mund të bëhet vetëm me kushtin që të shohësh serbët të tërhiqen përtej kufijve të 1913. Në këto krahina të zbrazura njëherë, riatdhesimi nuk do të paraqiste asnjë vështirësi dhe do të ishte i menjëhershëm. Kudo, unë kam dëgjuar të shprehin vetëm një dëshirë: "Ne duam të kthehemi në shtëpi". Ata presin nga një çast në tjetrin për t'u nisur. Kjo shpresë krejt e kotë nga njëra anë i mban ata, por edhe i pengon për të kërkuar një vend fiks. Ky kthim duhet bërë sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse afrimi i dimrit dhe klima e ashpër e maleve të tyre, do ta bënte riorganizimin e jetës shumë të vështirë.

3) Për gjuhën dhe gojëtarinë e shqiptarëve Ami Boué shkruan kështu: "Sigurisht shqipja nuk mund të quhet një gjuhë shumë pak e formuar, e varfër dhe e thjeshtë në format e saj të foljeve si, për shembull, gjuha e romëve. Duke dëgjuar shqiptarët të flasin dhe të diskutojnë njohim në të kundërt një gjuhë me shprehje të fuqishme dhe gazmore dhe gjejmë tek ky popull po atë talent oratorie si tek sllavët".

4) Mbi këto rrëmbime të familjeve shqiptare, mblodhëm në Elbasan dëshmi si kjo: "Duke përfituar nga vizita e një miku të vërtetë të shqiptarëve, si Ju, unë marr përsipër të drejtën të paraqes para Jush dhe Ju të parashtroni atë që pason:

"Vëllai im, Nexhi Haxhi Mahmuti, tregtar në Ipek, përpara një viti e gjysëm, rreth shtatorit 1919, ishte masakruar nga ushtarët serbë, të cilët duke dhunuar shtëpinë tonë dhe duke hyrë brenda me forcë, morën me vete gjithë pasurinë e shtëpisë ashtu si 800 napolona ar dhe orën prej floriri të vëllait tim të vrarë nga duart e tyre. Dhe duke mos qenë të kënaqur nga e gjithë kjo, një ditë më pas, rrahën nënën time, i thyen krahun e djathtë dhe internuan familjen tonë në një qytet tjetër që ndoshta mund të jetë Beogradi.

"Në emër të drejtësisë, unë kam nderin t'ju lutem për të kërkuar të ngrini zërin për të mbrojtur të drejtat tona dhe interesat e larta të drejtësisë ku kërkohet me qëllim që padrejtësitë që i janë shkaktuar familjes tonë të vihen në vend dhe ajo të lihet e lirë".

Vëllai i të masakruarit Nexhip,
Ymer Haxhi Mahmuti
Elbasan, 28.04.1921

5) Kjo mënyrë të thëni është për t'u vënë në dukje. Populli shqiptar nuk padit popullin serb. Fajtore është Serbia zyrtare. Ky dallim në gjykimin e shëndoshë dhe frymën politike u bën nder shqiptarëve. Dhe, brenda marrëdhënieve të tyre, të gjithë popujve u duhet shumë për ta vendosur atë.

Rruga e Arbërit nr. 123

botime

Merita e Enver Kaloshit qëndron në mbledhjen e këtyre materialeve dhe në sistemimin e tyre për t'i dhënë librit një strukturë sa më të lirshme dhe njëkohësisht sa më të qëndrueshme, pa hallakatje kompozicionale.

Hasan Çipuri, "ky është vetëm fillimi..."

Nga **XHAFER MARTINI**

Më Prof. dr. Hasan Çipurin nuk jam njohur nga afër. E kam ditur se ka gradë të lartë shkencore, por ata që kanë grada të tilla janë shumë dhe një pjesë prej tyre nuk nderohen e respektohen nga opinioni, mbasi gradat e dekorimet nuk përputhen me kontributin real dhe aq më pak me veprat që nuk i kanë. Nuk kam menduar se Prof. dr.Hasan Çipuri është prej këtyre të fundit, por vetë specifika e ngushtë e profesionit të tij, kontributet në një fushë të veçantë, të panjohur nga publiku i gjërë, nuk më kishin dhënë mundësinë të merrem me botimet e veprat e tij. Nga ana tjetër, sistemi totalitar, me zboret e shumta, me bunkerizimin e vendit, me parullën "mbrojtja e atdheut detyrë mbi detyrat", me sforcimet ekonomike, shpirtërore dhe psikologjike të popullatës, që shtrëngonte rripin për mbrojtjen, krijoi një gjendje alergjike, në kundërshtim me çka dëshirohej. Kjo "alergji" u reflektua edhe mbi ata njerëz të ndershëm dhe të përkushtuar që kontribuan në fushën e mbrojtjes, mbi të gjithë ata ushtarakë të devotshëm të cilët ishin vërtet të vendosur për mbrojtjen e atdheut. Kur në vitin 1997 ushtria shqiptare u shkërmoq sikur nuk kishte ekzistuar fare dhe lëshoi armët në duart e popullit, atëherë autoriteti i forcave tona të armatosura ra fare. Kjo e dëmtoi edhe më shumë imazhin e ushtarakëve.

Por kaluan shumë vjet dhe një shkrim i shkurtër, në formë lajmi, botuar në një gazetë lokale, më tërhoqi vëmendjen për figurën e Profesor Çipurit. Atëherë unë kërkova dhe mësova mjaft për të. Krijova bindjen se kisha të bëj me një shkencëtar të vërtetë që për arsyet që përmendëm, ka mbetur në hije.

Kur miku im Enver Kaloshi më tregoi se po shkruante një monografi për Profesorin, natyrisht që ia përkraha me entuziazëm dëshirën. Libri është konceptuar në atë mënyrë që për të kontribuojnë shumë njerëz, midis tyre edhe unë, që mora përsipër për të shkruar këtë parathënie. Që të bëhem më i qartë për lexuesin, dua të them se libri do të jetë në formë artikujsh të shkruar për Profesorin nga njerëz të ndryshëm, në kohë të ndryshme. Do të ketë një larmi firmash, temash, problemesh, mënyrash të qasjes dhe të trajtimit të tyre, duke përfshirë këtu edhe kontributin e vetë Profesorit me ndonjë shënim apo kujtim nga jeta e tij. Kjo strukturë e librit demokratizon përmbatjen e tij jo vetëm për firmat e shumta, por edhe për larminë që ato sjellin vetvetiu. Në faqet e tij do të gjeni edhe mendimet e shkencëtarëve dhe specialistëve të fushës ushtarake, të gjuhëtarëve dhe studiuesve seriozë, të gazetarëve, siç do të gjeni edhe vlerësime të dashamirësve entuziastë, që, edhe pse më ndonjë rast tregohen subjektivë, sjellin origjinalitet dhe freski. Është një libër me një angazhim të sinqertë për vlerësim dhe mirënjohje ndaj Hasan Çipurit, libër i shkruar lirshëm, pa atë ngërçin akademik me të cilën paraqiten nganjëherë këta protagonistë. Jepet me vërtetësi shkencëtari, por pa dëbuar prej tij njeriun. Do të kisha dëshirë që të kishte shkrime që ta shumëdimensiononin figurën e Profesorit duke na e dhënë atë në disa profile, si baba, si bashkëshort, si njeri i dashur me miq dhe me shokë, i prirur gjithmonë për kah e mira, mbasi ky protagonist ka shumë veti të çmuara njerëzore që e lartësojnë figurën e tij. Ky është një rast unikal kur natyra e krijuesit përputhet në mënyrë perfekte me veprën e tij, gjë që nuk ndodh në shumicën dërrmuese të rasteve.

***

Kjo monografi, pra, është e veçantë, ndryshe nga shumë syresh. Në krijimtarinë botërore ka shumë lloj monografish; me një pjesë prej tyre do të familjarizohet edhe lexuesi ynë. Realiteti është shumë kompleks, kompleks është, natyrisht, edhe paraqitja e tij. Për këtë arsye një nga estetët më të përmendur, Borgesi, ka theksuar

Në faqet e tij do të gjeni edhe mendimet e shkencëtarëve dhe specialistëve të fushës ushtarake, të gjuhëtarëve dhe studiuesve seriozë, të gazetarëve, siç do të gjeni edhe vlerësime të dashamirësve entuziastë, që, edhe pse më ndonjë rast tregohen subjektivë, sjellin origjinalitet dhe freski. Është një libër me një angazhim të sinqertë për vlerësim dhe mirënjohje ndaj Hasan Çipurit, libër i shkruar lirshëm, pa atë ngërçin akademik me të cilën paraqiten nganjëherë këta protagonistë. Jepet me vërtetësi shkencëtari, por pa dëbuar prej tij njeriun.

Një nga karakteristikat e gjeniut është puna e jashtëzakonshnme. Gjeni dembel nuk ka. Hasan Çipuri këtë karakteristikë e ka më kryesoren në personalitetin e tij. Atë e bëri ashtu siç është sot mendja e tij, por edhe vullneti dhe puna e jashtëzakonshme.

se "vëzhguesi i gjithëdijshëm mund të hartonte një numër të pambarimtë biografish të një njeriu që do të nxirrnin në pah fakte të pavarura dhe nga të cilat duhej të lexonim shumë para se të kuptojmë se protagonisti është i njëjti." Për kërshëri të lexuesit do të shtonim se ka një përshkrim të Mikelanxhos që anashkalon çdo përmendje veprash të artistit të madh, siç ka edhe biografi për Bolivarin dhe për Napoleonin, dy strategë të mëdhenj ushtarakë, ku nuk flitet fare për beteja. Vepra të tilla janë po kaq të mira sa edhe biografitë që janë të mbushura me imtësi nga jeta dhe veprimtaria e protagonistëve jetësorë.

Merita e Enver Kaloshit qëndron në mbledhjen e këtyre materialeve dhe në sistemimin e tyre për t'i dhënë librit një strukturë sa më të lirshme dhe njëkohësisht sa më të qëndrueshme, pa hallakatje kompozicionale. Në përbërjen e këtij libri do të gjeni edhe artikuj panoramikë për krijimtarinë shkencore të Prof. dr. Hasan Çipurit, si ai me titull: "Veprimtaria shkencore e Prof. Çipurit", artikuj me pretendime për të hyrë më thellë në krijimtarinë e tij shkencore duke dhënë disa tipare dhe cilësi të kësaj krijimtare, si shkrimi: "Shkencëtari me uniformë"; kemi edhe shkrime për tema dhe probleme të ndryshme të shkruara më me lirshmëri, ose në formë kujtimesh, si: "Kujtime nga shkolla "Skënderbej", "Një histori e dhimbshme", "Përse kështilli shkencor votoi tri herë", "Prof. dr. Çipuri, ti i harruari", "Profesor me vepra e jo veç me tituj e grada", e të tjerë. Vlerësimin e Prof. dr. Çipurit për punën e tij cilësore e kanë bërë figura të shquara të shkencës sonë filologjike, si : Androkli Kostallari, Shaban Demiraj, Emil Lafe etj. Këta shkencëtarë, zakonisht të përmbajtur, flasin me entuziazëm për arritjet e Prof. dr. Hasan Çipurit jo vetëm në fushën e shkencës ushtarake, por edhe në studimet filologjike. Kështu, si shembull, Profesor Kostallari thotë: "Disertacioni i shokut Hasan Çipuri është i pari punim monografik, i thelluar dhe i shumanshëm që i kushtohet terminologjisë ushtarake të shqipes, rrugës historike të zhvillimit të saj dhe, në mënyrë të veçantë, ndërtimit të terminologjisë ushtarake pas Çlirimit si një sistem tërësor e organik si në suazën e leksikut e të fjalëformimit të shqipes, ashtu edhe në suazën e ndërtimit e të forcimit të ushtrisë popullore me kërkesa të larta gjithnjë në rritje." Profesor Shaban Demiraj shkruan: "Autori i mbështetur në një metodologji të shëndoshë, nuk e ka parë terminologjinë ushtarake si diçka të mbyllur në vetvete, por në lidhjet e saj të gjalla dhe të shumanshme me fjalorin e gjuhës shqipe në përgjithësi dhe me sistemet e tjera terminologjike në veçanti." Përmenda vetëm këta dy shkencëtarë, sepse ishin të dy shumë të kursyer në vlerësime, natyrë e vërtetë prej shkencëtari, që nuk e përdornin shkencën për t'i bërë qejfin njerit apo tjetrit.

***

Hasan Çipuri ka lindur në fshatin Tomin në afërsi të qytetit të Peshkopisë më 10.12.1935. Rrjedh nga një familje me tradita atdhetare. Çipuret ishin familje e madhe feudale me prona të shumta. Çifliku i familjes Çipuri përfshinte fshatin e sotëm të Tominit, Peshkopinë e sotme, Pollozhanin dhe Dohoshishtin. Kjo është një sipërfaqe e madhe prej qindra hektarësh dhe është e kuptueshme pasuria që kishte në atë kohë kjo familje. Të parët e Çipure natyrisht që ishin katolikë. Ata janë shumë të hershëm në vendbanimin që përmendëm. Çipuret ndërtuan shumë kisha.Mbasi u konvertuan myslimanë, ndërtuan edhe xhami. I pari i Çipure që përmendet për emër dhe pasuri ishte Çel Çipuri, që më në fund, i ndjekur për çështjen atdhetare, gjeti mbrojtje tek Ali Pashë Tepelena. Në kohën e tij, por edhe më parë, kjo familje feudale vilte taksa edhe në Dibër të Madhe, madje edhe më ndonjë fshat që ishte në territorin e Bullgarisë.

Në rrugën Peshkopi- Kastriot, më të dalë të qytetit, në kilometrin e parë, ka qenë një ndërtesë me emrin "Hoteli i Çengës" që ka ekzistuar deri vonë. Kjo ndërtesë mbas çlirimit u shndërrua në shkollë dhe aty e ka filluar klasën e parë Hasan Çipuri. Hasani jep të dhëna jo të hollësishme për ato vite që sigurisht janë mjegulluar në kujtesë. Ai përmend vetëm njërin prej shokëve të shkollës, Shevqet Lushën, me të cilin bënte çdo ditë rrugën në mes të dimrit dhe të dëborës së shumtë që binte. Vështirësi serioze, kujton ai, shkaktonte përroi i Tominit që aso kohe kishte shumë ujë. Mësues Hajriu, të cilit i përmend vetëm emrin, ishte nga Elbasani. Duhet të ketë qenë normalist i shkollës së famshme të Elbasanit, siç ishin shumë mësues të viteve të para mbas çlirimit. Klasën e dytë dhe të tretë, thotë Hasani, i kreva brenda një viti shkollor në shkollën që ishte ngritur në shtëpinë e Fehmi Shehut, me mësues Martin Jakovën nga Shkodra. Klasën e katër e bëri pranë shkollës pedagogjike të qytetit të Peshkopisë, me mësues Jonuz Shehun nga Vlesha. Ky mësues karakterizohej nga dashuria për nxënësit dhe aftësia dhe suksesi në punë. Shkollën fillore Hasan Çipuri e përfundoi shkëlqyeshëm, siç do të përfundonte të gjitha shkollat që do të ndiqte gjatë jetës. Klasën e pestë Hasani e bëri po në shkollën pedagogjike me mësues Adem Shehun, edhe ky nga Vlesha, i arsimuar në shkollën e normale të Elbasanit, të cilën e kanë mbaruar mjaft dibranë të asaj kohe. Edhe mësues Adem Shehu jepet si mësues i përgatitur që ndiqte jo vetëm përparimin e nxënësve në mësime, por edhe në sjellje. Në librezën e nxënësit, përmend Hasani, mësues Ademi në krye të çdo dy javëve, vinte shënime të hollësishme për sjelljen e nxënësve, për formimin e tyre shpirtëror dhe qytetar. Mua gjithnjë, sjell ndërmend Hasan Çipuri, më shënonte veç të tjerave, edhe këtë fjali: "Nxënës me virtyt natyral", çka do të thotë se ai ishte nxënës me të dhëna të veçanta, me cilësi dhe aftësi të lindura që shkolla nuk mund të t'i japë nëse nuk i ke. Duke e veçuar prej të tjerëve, mësues Ademi në fakt ka treguar për teprinë që kishte Hasan Çipuri, për atë përdallim cilësor me nxënësit e tjerë. Këtë nuk e tregonin vetëm notat gjithnjë të shkëlqyera që merrte në të gjitha lëndët, por edhe zelli i veçantë, ai përkushtimi i jashtëzakonshmëm ndaj dijes dhe kulturës, ajo dashuri e madhe për librin që në atë kohë ishte burimi kryesor i njohurive. Të gjitha këto veti dhe cilësi e afrojnë Prof. dr. Hasan Çipurin me gjeniun. Në se abstragojmë edhe për raste të tjera, gjithnjë në shërbim të mendimit që sapo hodhëm, kujtojmë se plaku filozof nga Dibra e Poshtme, Tafë Kola, kur shkoi për krye të shëndoshë në Sllovë për vdekjen e Elez Isufit, i thotë djalit të madh të Elezit: "Ti shëndosh për teprinat, or Cen!" Këto fjalë janë komentuar në mënyra të ndryshme gati një shekull në Dibër, herë duke iu afruar të vërtetës, herë duke iu larguar asaj, por fakt është se Tafë Kola e quajti Elez Isufin gjeni, gjeniun e luftërave popullore ndaj pushtuesve të huaj. Mua më udhëhoqi fati dhe një sërë rrethanash që të merrem me figurën e Elez Isufit. Zbërthimi i shprehjes së Tafë Kolës që më kishte ngacmuar tërë ato vite, nuk kishte se si mos të mos më preokuponte në librat ("Elez Isufi"(1993), "Gjenerali me shajak" (2012), ku heroi kryesor ishte Elez Isufi. Nga gërmimet për figurën e Elez Isufit gjeta se filozofi i shquar Artur Shopenhauer, që është marrë shumë kohë për të karakterizuar ç'është gjeniu, thotë se "gjeniu është një lloj teprie, tepri e forcës së njohjes, domethënë, mbi masën e kërkuar për t'i shërbyer vullnetit, dëshirës." Për këtë arsye, nëse shprehjen e mësuesit Adem Shehu e interpretojmë në këtë prizëm, mund të themi se ai nxënësin e tij e ka karakterizuar si gjeni edhe pse ishte në klasën e pestë.

Një nga karakteristikat e gjeniut është puna e jashtëzakonshnme. Gjeni dembel nuk ka. Hasan Çipuri këtë karakteristikë e ka më kryesoren në personalitetin e tij. Atë e bëri ashtu siç është sot mendja e tij, por edhe vullneti dhe puna e jashtëzakonshme. "Pushteti i vullnetit, ka thënë Buda, kalon dhe bëhet fuqi e trupit." Kurse Gëteja thotë: "Vullenti dhe dashuria janë krahët për vepra të mëdha."

Hasan Çipurin në momente të caktuara e ka ndihmuar edhe Fati. Çfarë do të kishte ndodhur sikur ai do të kishte mbetur një nëpunës apo mësues në vendlindje,për të mos thënë fshatar i thjeshtë? Po të kishte ndodhur kështu, aftësia e tij do të shkonte kot, sepse atë nuk ia kërkonte puna që do të bënte. Balzaku ishte gjeni dhe dështoi në të gjitha përpjekjet e tij për t'u marrë me biznes. Gjenialiteti e shtynte drejt atyre sipërmarrjeve që jepnin rezultat, por, ai ngaqë shikonte më larg se të tjerët, ato biznese deshi t'i vërë në lëvizje një shekull para se t'u vinte koha. Prandaj dështoi. Kur vë në një punë më shumë energji dhe talent se sa kërkon ajo punë, do të dështosh ose do të çmendesh. Prandaj qe një fat i madh dhe një ngjarje e shënuar ajo që Hasan Çipuri qysh në moshë fare të re, u shkëput nga vendlindja dhe provinca dhe shkoi në kryeqytet ku iu hapën mundësitë për të arritur atje ku arriti. Nuk ka thënë kot një i ditur se "Unë jam unë, plus rrethanat e mia". Kur ishte në klasën e gjashtë, madje pa e mbaruar atë, Hasan Çipuri do ta lërë përfundimisht Peshkopinë dhe do të shkojë në Tiranë, çka shënon një kapitull më vete në jetën e tij, ku iu hapën shumë perspektiva. Kjo qe kthesa kryesore për mirë në jetën e tij. Shansi është dëshira e Zotit kur do të të ndihmojë. Ne në Dibër kemi pasur edhe intelektualë të tjerë të shquar që përfunduan keq, ose dhanë shumë më pak në krahasim me mundësitë. Kjo ndodhi se atyre nuk iu dha vendi i punës për ta shfaqur kapacitetin e tyre mendor. Kështu, si shembull, edhe Zenel Sula kishte mbaruar në Rusi me medalje ari, edhe Bjaram Mata ishte një piktor me shumë talent, edhe Basri Neziri ishte një mjek me aftësi të mëdha. Me librat e Rrahim Gjikës mësonin studentët e mjekësisë në Tiranë, kurse Rrahimi e kishin ngujuar në maternitetin e Peshkopisë. Gazetarët mburrnin në atë kohë faktin që Rrahim Gjika kishte operuar dhe kishte shpëtuar jetë nënash në salla operacioni të improvizuara, në shtëpi fshatarësh apo në klasa shkollash, kur duhej ta ngrinin zërin që

mjeku i shquar të mos bënte punën e një mjeku partizan, por të punonte në kryeqytet, atje ku e meritonte, atje ku ishin kushtet që ai të shfaqte tërë talentin. Ç'do të bënte mjeku i specializuar okulist, ish-profesori i Universitetit, Basri Neziri, në Reç ku e mbajtën shtatë vjet? Më mirë të thuash se ia hoqën të drejtën e profesionit. Dibra kishte edhe nxënës të tjerë të shkëlqyer, që regjimi nuk i la të shkonin për studime. Ilir Spata, si shembull, nuk njihte notë tjetër veç notës më të lartë, dhjetës, qysh nga klasa e parë fillore deri në mbarim të gjimnazit. Të mos marrësh dymbëdhjetë vjet notë tjetër veç dhjetës, a nuk është kjo shfaqje gjenialiteti? I tillë ishte edhe vëllai i tij, Rufati. Të dy mbetën pa shkollë. Haxhi Lleshi nuk i çonte oficerët për të pyetur për nxënësit e mirë e shumë të mirë në Fushë Alie dhe Kastriot. Më vjen mirë që Prof. Çipuri e vlerëson lart këtë rast të jetës së tij dhe e konsideron fat të madh, që shkoi për studime në shkollën "Skënderbej" . Prej këtij rasti tërthorazi tregohet se jo të gjithë e patën fatin e tij. Prandaj këtë ngjarje të rëndësishme në jetën e tij, do ta japim siç e ka treguar vetë Profesori.

***

"Më 1 tetor 1949, me urdhër të shokut Haxhi Lleshi (ish-drejtori i Drejtorisë së Personelit të Komandës së Përgjithshme të FA), erdhi në Dibër me një grup instruktorësh të shkollës ushtarake "Skënderbej" (ndër ta kapiten Ali Rexha dhe kapiten Qani Koçollari), të cilët regjistruan nxënësit më të mirë në mësime në shkollën 7-vjeçare "Demir Gashi" në Peshkopi dhe në disa shkolla 7-vjeçare në Maqellarë, Shupenzë etj., për t'i sjellë në shkollën "Skënderbej". Nxënësit u zgjodhën në klasa të ndryshme të shkollës 7-vjeçare (nga klasa V-VII). Pas 6 muajve, më 28 mars 1950, (ditën e krijimit të shkollës ushtarake "Skënderbej"), erdhën dhe na morën me autobus të posaçëm direkt nga klasat ku bënim mësim e drejt e në shkollën "Skënderbej", madje pa njoftuar as familjet se ku do të shkonim. Ne ishim shumë të emocionuar, sepse për herë të parë largoheshim larg familjes dhe nga vendlindja, (ku ishim shumë të lidhur me tokën), për të shkuar në kryeqytet.

Me të mbërritur në shkollën "Skënderbej", komanda e shkollës na priti në mënyrë të organizuar dhe me një atmosferë shumë të ngrohtë. Pasi hoqëm rrobat civile dhe bëmë banjë, na veshën menjëherë me uniformën e bukur të skënderbegasit, që atëherë fillimisht na quanin kadet ushtarakë. Të nesërmen na ndanë në klasat përkatëse dhe filluam mësimin në semestrin e dytë. Unë u caktova në klasën e gjashtë A (në këtë paralele vijova edhe në klasën e 7-të e në klasën e parë dhe të dytë lice), në kompaninë I me komandant Ali Rexhën dhe komisar politik Hysen Dervishin. Mësoja me një zell të jashtëzakonshëm dhe merrja vazhdimisht nota të shkëlqyera.Më qëlloi javën e parë që brenda një dite më pyetën gjashë orë rresht mësuesit dhe mora gjashtë pesa (shumë mirë), gjë që bëri shumë bujë në shkollë.

Trajtimi ekonomik ishte i nivelit më të lartë të asaj kohe në krahasim me konviktet e shkollave të tjera të Republikës. Nuk e imagjinonim dot më varfërinë që lamë pas në vendlindje. Studimi ishte i organizuar në klasa dy orë para darke dhe një orë pas darke. Kolektivi i klasës ishte shumë kompakt, si një familje e vërtetë, edhe pse vinim nga rrethet më të largëta të vendit, nga jugu dhe nga veriu. Në kohën e lirë dhe pasdreke shikonim filma të ndryshëm në kinemanë e shkollës, që ishte aq e madhe dhe komode, ose organizoheshin shfaqje teatrale, mbrëmje vallëzimi etj:, ku ishte e pranishme edhe komanda e shkollës, sidomos komisari ynë i dashur dhe simpatik, gojëmbël dhe bindës-kolonel Xhemal Shehu. Të dielave kishim liridalje në qytet. Në pushimet verore përveç kohës që shkonim në shtëpitë tona, bënim edhe njëzet ditë kalitje fizike dhe not në plazhin e Kovalishencës, ose bënim përgatitje për paradë në Fushën e Aviacionit me rastin e festës së 10 korrikut, ku kuadratet e skënderbegasve dalloheshin për bukurinë dhe gjallërinë



e tyre në gjithë paradën dhe shoqëroheshin me duartrokitje të zjarrta nga masat punonjëse të kryeqytetit.

Shkolla "Skënderbej" ishte e pajisur me bazë mësimore të plotë. Në klasën tonë kishim nxënës shumë të mirë, që mësonin sistematikisht dhe arrinin rezultate të larta në mësime. Ata në jetë u bënë oficerë shumë të zotë në specialitete nga më të ndryshmet, si inxhinier Sefedin Qorlazja, laureat i Çmimit të Republikës; Zoto Rjepa, Isak Qosja, komandantë dhe komisarë të rangjeve të larta(deri në korpus); Fadil Toçi, Rustem Peçi, Ahmet Gjoliku, komandantë nëndetëseje; Petrit Myftiu, komandant; gjuajtësi detar Beqir Gerbi, piloti civil Rifat Vranezi, poeti Halil Qendro, shkrimtari Lirim Deda, diplomatë Selim Malaj, Viktor Dhroso; gazetar Novruz Turhani, komandanti i Divizionit Nevruz Dervishaj, zbulues, gjuhëtarë, pedagog Skënder Çela, Hasan Çipuri etj.

Mësuesit tanë ishin të mrekullueshëm dhe shumë kompetentë, të cilët kishin mbaruar fakultete brenda dhe jashtë vendit. Të tillë kujtojmë me respekt Prof. Stavri Angjelin (drejtor i shkollës), mësuesen e matematikës znj. Melo Çanin, mësuesen e gjuhës shqipe znj. Gjylyzar Çiçon, mësuesin e kimisë z. Feridium Belin, mësuesin e anatomisë prof. Skramin, mësuesen e gjuhës ruse znj. Nermin Keta, mësuesen e historisë znj. Koplikun, mësuesin e fizkulturës z. Zyber Konçin etj.

Unë qëndrova në shkollën "Skënderbej" në klasën VI, VII, në klasën I, II lice, ku çdo vit i mora dëftesat me të gjitha notat shkëlqyeshëm dhe me fletëlavdërimi. Pastaj më çuan në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në degën e Gjuhëve të Huaja. Klasën e tretë gjimnaz e bëmë në Shkollën e Bashkuar paralel me programin për oficerë, ndërsa klasën IV të maturës e mbarova në gjimnazin e natës pranë Shtëpisë Qëndrore të Ushtrisë në vitin 1954-1955 me Medalje të Artë. Atë vit u diplomova për oficer."

***

Titujt dhe gradat e Prof. dr. Hasan Çipurit dëshmojnë për vlerësimin e lartë që i është bërë atij për kontributin e tij të shquar në shkencën ushtarake shqiptare. Siç do të dëshmohet nga shkrimet e tjera, komisioni i atestimit u mblodh për t'i dhënë Hasan Çipurit gradën e shkallës së parë të kualifikimit "Kandidat i shkencave filologjike". Kështilli shkencor nuk përbëhej vetëm nga anëtarët e Akademisë Ushtarake, por edhe nga anëtarët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nga figurat më të njohura të fushës së gjuhësisë. Disertacioni i paraqitur për gradën e shkallës së parë, siç e thanë profesorët Kostallari, Demiraj, Lafe dhe të tjerë, e kalonte disa herë gradën e parashikuar, prandaj komisioni votoi dy herë, një herë për gradën e shkallës së parë dhe herën e dytë për gradën e shkallës së dytë të kualifikimit "Doktor i Shkencave Filologjike". Të marrësh dy grada përnjëherë nuk është gjë e lehtë dhe ky, me sa di unë, është rasti i parë që veprohet në këtë mënyrë. Prof. dr. Hasan Çipuri dëshmoi para autoriteteve shkencore të nivelit më të lartë se nuk kishte mbrojtur disertacion për t'u mykur nëpër arkivat, por për t'u botuar dhe për t'i shërbyer shkencës sonë në mënyrë konkrete.Ky është tipi i shkencëtarit të vërtetë në ndryshim nga ata që titujt dhe gradat i marrin pa vepra, ose me vepra pa vlerë botimi, pale pastaj për të shënuar zgjidhje të problemeve që trajtojnë. Hasan Çipuri veç kësaj ishte një shkencëtar aktiv, që ia kishin nevojën shumë organizma dhe institucione. Mendja e tij e mprehtë, vështrimi i thellë dhe objektiv kërkohej prej të gjithëve. Prandaj ai u ngarkua aq shumë me detyra sa vetëm struktura e tij mentare mund ta përballonte. Ai ishte anëtar i Këshillit Shkencor të Akademisë së Mbrojtjes prej vitit 1983 deri në vitin 2000; anëtar i Redaksisë së Përgjithshme të FESH-2 në Akademinë e Shkencave që prej vitit 1997;

Titujt dhe gradat e Prof. dr. Hasan Çipurit dëshmojnë për vlerësimin e lartë që i është bërë atij për kontributin e tij të shquar në shkencën ushtarake shqiptare.

Në të gjitha këto organizma dhe forume ndërkombëtare ai nuk ka qëndruar i tulatur dhe pasajdisur, por falë edhe gjuhëve të shumta që din (rusisht, serbokroatisht, anglisht, italisht) ka ligjëruar dhe është dëgjuar me vëmendje.

sekretar shkencor për Fushën e Mbrojtjes, Rendit dhe Historisë Ushtarake në Qendrën e Enciklopedisë Shqiptare në Akademinë e Shkencave; anëtar i Shoqatës së Historianëve Ushtarakë, anëtar i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, "Personalitet Ndërkombëtar i vitit 2001", dhënë nga Qendra Ndërkombëtare Biografike e Kembrixhit, në Angli, më 2001; si dhe zotërues i titujve të nderit: "200 intelektualët e shquar të shekullit XXI", Kembrixh, 2002 dhe "Europianët e Shquar të shekullit XXI", Kembrixh, 2003. Ka marrë edhe tituj dhe grada të tjera që nuk po i përmendim për të mos shtuar në maksimum enumeracionin që nuk është i pëlqyeshëm në të lexuar. Kualifikimi i Prof. dr. Hasan Çipurit është i vijueshëm. Ai kurrë nuk u nda nga libri, studimi, duke thelluar njohuritë e tij dhe duke u njohur me zhvillimin shkencor bashkëkohor për të qenë vazhdimisht në përshtatje me vrullet dhe modernitetin që sjell globalizmi. Kështu ai përveç disa fakulteteve dhe shkolla të larta të vendit që i ka përfunduar duke marrë maksimumin e njohurive, ka zhvilluar kurse kualifikimi dhe trajnime nga shumë organizma ndërkombëtarë, si Seminar në Komandën e NATO-s në Bruksel, në prill të vitit 2000, ku është pajisur edhe me çertifikatën përkatëse; kurs për terminologjinë në Agjensinë e Standartizimit të Terminologjisë Ushtarake të NATO-s në Napoli, Itali, në dhjetor të vitit 2003; seminar ndërkombëtar për kraitistikën në Dubrovnik të Kroacisë, në gusht të vitit 2004, shoqëruar me diplomë.

Në të gjitha këto organizma dhe forume ndërkombëtare ai nuk ka qëndruar i tulatur dhe pasajdisur, por falë edhe gjuhëve të shumta që din (rusisht, serbokroatisht, anglisht, italisht) ka ligjëruar dhe është dëgjuar me vëmendje.

Prof. dr. Çipuri ka kryer detyra të tilla, si: shef i qendrës së radiozbulimit, zëvendësshef shtabi të brigadës, shef organizimi dhe kuadri të brigadës, zëvendëskomandant i repartit 2001 në Sazan, shef drejtimi për informacionin në Drejtorinë e Zbulimit në Ministrinë e Mbrojtjes, shef shtabi Detashmentit të R/Zbulimit, instruktor gjuhe dhe taktike speciale në Shkollën e Zbulimit,shef i departamentit të Terminologjisë dhe Enciklopedisë Ushtarake në Akademinë e Mbrojtjes, pedagog i jashtëm i gjuhëve të huaja, etj. etj. Megjithatë, nuk mund të thuhet se ai arriti në ato pozita të larta që përputheshin me aftësitë dhe përgatitjen që kishte. As gradën e gjeneralit nuk e arriti kur atë e kanë mjaft të tjerë më me pak merita dhe kontribute. Prof. dr. Hasan Çipuri të gjitha detyrat e ngarkuara i ka kryer me nder dhe dinjitet dhe me prestigj të madh profesional. Është e pamundur që një njeri me bagazhin e tij shkencor, me përkushtimin atdhetar, me përvojën, përgatitjen dhe me prirjen kah e mira, të veprojë ndryshe.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 123
veprimtari

Në vitin 2013 boton "Ajnshtajni" i përcëlluar". Në vitin 2014 "Revolucioni i gjelbërt". Në vitin 2015 "Testamenti i pylltarit". Dhe sivjet në kuadrin e gjashtëdhjetë vjetorit të ditëlindjes vjen me dy libra njëherësh "Pylltaria në udhëkryq" dhe "Dafina në hullitë e shekujve" duke e mbyllur kështu triologjinë e tij rreth pyjeve.

Dy gëzimet e Selman Mëziut

Nga **SHAQIR SKARRA**





Ekishte menduar krejt ndryshe Selman Mëziu ta festonte gjashtëdhjet vjetorin e lindjes së tij sivjet. Kishte ardhur nga Firenceja ku jeton prej shumë vitesh familjarisht dhe me një ftesë të thjeshtë në rrjetet sociale ftonte të gjithë shokë, miq, koleg, ish nxënës e studentë që kishin qenë bashkë vite më parë për të bërë promovimin e dy librave të tij më të fundit "Pylltaria në udhëkryq" dhe "Dafina në hullitë e shekujve" si dhe për të festuar gjashtëdhjet vjetorin e lindjes. Data 20 gusht, ora 11 i mblodhi tok së bashku tek salla e Akademisë së shkencave, sallë kjo pak e vogël për të pranishmit që ndodheshin aty. Ishte hera e parë që pikërisht në këtë sallë futeshin kaq shumë njerëz të moshave të ndryshme por dhe të profesioneve të ndryshme, studiues, inxhinierë pyjesh, gazetarë, pensionist por edhe mjaft të rinj e të reja. Kishin ardhur edhe njerëz të afërt të Selmanit nga Dibra për këto gëzime të tij e në këtë ditë të shënuar. Deri tani Selman Mëziu ka shkruar libra për pyjet pasi pyjet janë dashuria e tij. Me këtë profesion të bukur e ka lidhur jetën dhe ndjehet shumë i mërzitur, shumë depresiv kur shikon këtë masakër që kanë bërë e vazhdojnë të bëjnë shqiptarët mbi pyjet, këtë pasuri të madhe kombëtare që na ka falë natyra. Në fillim botoi librin e parë me titull "Lulet e mia, kënaqësia juaj" 2006, libër ky që korri një sukses të madh dhe u përpi nga lexuesi shqiptar. E morën kryesisht ata që janë të pasionuar pas luleve. Në vitin 2013 boton "Ajnshtajni" i përcëlluar". Në vitin 2014 "Revolucioni i gjelbërt".Në vitin 2015 "Testamenti i pylltarit". Dhe sivjet në kuadrin e gjashtëdhjetë vjetorit të ditëlindjes vjen me dy libra njëherësh "Pylltaria në udhëkryq" dhe "Dafina në hullitë e shekujve" duke e mbyllur kështu triologjinë e tij rreth pyjeve.

Selman Mëziu është njëri ndër autorët më prodhimtarë që ka shkruar në fushën e problemet që po kalojnë pyjet tona në vitet e tranzicionit të madh. Askush deri më sot nuk ka shkruar kaq shumë, nuk ka reaguar kaq ashpër, nuk ka apeluar në media e me botime. Në të gjitha botimet e Selmanit gjejmë nxitjen dhe përfshirjen në debat, si dhe pasqyrimi në tekst i opinioneve profesionaleve të mjaft specialistëve të pyjeve, por edhe të fushave të tjera, të cilët proekupohen për fatin e pyjeve dhe të vetë shoqërisë dhe dialogojnë sidomos nëpërmjet rrjeteve sociale. Me ta Selmani diskuton ,debaton dhe polemizon për gjendjen e pyjeve, mbledh të dhëna e fakte konkrete, i dokumenton me shifra e fotografi, denoncon me forcë shkatërrimin e pyjeve dhe të strukturave të shërbimit pyjor nga pushtetarët dhe specialistët e pa përgjegjshëm, shkeljet ligjore, korrupsionin, padrejtësitë, vlerëson kontributin dhe përpjekjet e mjaft kolegëve pylltarë e gëzohet për arritjet e tyre si dhe propozon masa konkrete për përmirësimin e mundëshëm, ndonëse shpesh me forcë dhe me terma të ashpra.

Krijimet e Selmanit kanë një ecuri kronologjike në trajtimin e problemeve që shqetësojnë seriozisht komunitetin dhe pylltarinë shqiptare në veçanti, duke u trajtuar me zhanre të ndryshme gazetarie ose dhe letërsie. Por jo vetëm kaq. Selmani, i revoltuar për pa diturinë në prerjen e pishave të bulevardit Kavajës, Tiranës, blirët e bukur të Peshkopisë, të murosjes së drurëve zbukurues në parkun tek Kodrat e Liqenit Artificial Tiranë, ku i dënon pa ngurim e me plot indinjatë të thellë por, iu shpjegon gabimet, për të mos thënë faje, iu rekomandon edhe zgjidhje teknike, artiktekturale e peisazhiste.

Selman Mëziu është një kronikan i zellshëm e i pa lodhur , kur ndjek me korrektësi të gjitha ngjarjet, qoftë takimet ndërkombëtare mbi mjedisin, mbi klimën, tokën, aksionet për të ripërtërirë Parkun Kombëtar të Lurës, apo shkatërrimin për disa muaj të Pyllit "Monument Natyror, në Gërmenj-Shelegur, në Kolonjë, duke theksuar politikën e gabuar të qeverive shqiptare të pas viteve nëntëdhjetë.

Gjithashtu Selmani godet fort dhe pa iu dridhur fare qerpiku me fjalën e tij të kulturuar, më therëse, më demaskuese, "Odisenë" e legjislacionit pyjor, mbi pronësinë, mbi parqet kombëtare e të qyteteve dhe përgjërohet për diskriminimin e pylltarëve, si një politikë që po mohon piramidën e gjelbër të shkencave pyjore. Ndërsa nuk len pa e diskredituar ligjin mbi kalimin e pyjeve në administrim të bashkive, duke theksuar se ky është akti i fundit i tragjedisë së natyrës shqiptare, i kryer me dashje nga politika e pushtetmbajtësve të sotëm.

Selmani duke përcjellë shtypin e përditshëm, ku disa materiale edhe janë botuar, ai njihet fare mirë me gjendjen ekologjike, merr të dhëna, fakte, opinione, fotografi, debaton ashpër në rrjetet sociale, dhe pastaj fillon e hedh me kujdes krijimet e tij mbresëlënëse, duke i ngizur këto me kujdes, duke i ngritur problemet, demaskuar ministra, kryeministra dhe duke dhënë po vetë rrugë zgjidhje konkrete për të dalë nga ky kolaps i pa parë, i ndodhur në Shqipëri, lidhur me mjedisin pyjor dhe atë zbukurues.

Trilogjia e Dr Selman Mëziut edhe pse e shkruar në një kohë relativisht të shkurtër, prej tre vitesh, përbën një vepër të madhe me vlera edhe historike, studimore, profesionale, edukative, shoqërore, njohëse të vetë realitetit pyjor e mjedisor shqiptar dje edhe sot.

Në fjalën e tij Prof.Dr Bashkim Lushaj tha: "Tek lexon librat e Selmanit, nga faqja në faqe të emocionojnë, do të ndjesh trokëllimat e dhimshme në gjeografinë e pyjeve shqiptare, tashmë mjerane që vërtet janë në kryqëzim. Eh, pylltari shqiptare, që shumë të lakojnë nëpër salla, zyra qeveritare, deri në Parlament, por t'i gjendesh atje ku sopata rrëzon përdhe mijëra jetë me mosha shekullore, sigurisht realizuar tashmë në grupe interesi(duke përfshirë dhe drejtues), bashkë me motosharristët pa bukë me motosharrat e tyre janë duke shkretuar hapësira të pa anë pyjesh, pa kurrfarë përgjegjësie morale, pa ndjerë aspak ligjet, pa njohur as ligjësitë më elementare biologjike.

Si në librat e mëparshëm, autori tek ky libër vjen më i shtruar, më komunikues, dhe përse mund të thotë secili nga ju që e lexoni e përcaktoni në këtë të fundit, sepse çdo gjë është në kryqëzim, pyjet kullotat,specialistët, teknikët, inxhinierët, tashmë edhe vetë stafet drejtuese"

Shumë interesant ishte diskutimi i inxhinier Ahmet Mehmeti i cili më së shumti u ndal vetëm rreth librit "Dafina në hullitë e shekujve" ku ndër të tjera tha: "Libri i drejtohet një numri të madh të interesuarish për vlerat e mëdha që ka dafina, për përfitimet ekonomike të kultivuesve të saj, brenda vendit dhe për eksport, për vlerat ekologjike, mjekësore, në gatime etj. Libri u drejtohet dhe do t'u shërbejë biologëve, inxhinierëve dhe teknikëve të pyjeve, ekologëve, fermerëve, lulishtarëve, biznesmenëve, mjekëve, çdo qytetari që di të vlerësojë vetitë e saj shumë të dobishme ;ushqimore, zbukuruese, shëndetësore, etj, në qytet e në fshat, në gjithë arealin e shtrirjes së saj klimatik e tokësor.



Për përgatitjen e këtij studimi autorit i është dashur të përdorë mbi pesëdhjetë njësi bibliografike nga literatura shqipe dhe në gjuhë të huaja si dhe një mori të dhënash nga internet, etj. Libri na vjen këndshëm dhe me shumë citime kuptimplota nga thesari i kulturës dhe letërsisë tonë e botërore.

I urojmë suksese autorit kudo në jetë dhe libri i tij të sjellë begati,shëndet dhe aromën e dafinës në duart dhe bibliotekat e të gjithëve".

Dhe vërtet ky libër, po thuaj i pari i këtij lloji në vendin tonë i ka kushtuar mjaft mund e kohë Selmani që vetëm pot ë shikosh bibliografinë që ka lexuar bindesh në seriozitetin që ka patur autori me na dhënë një libër sa më të plotë e dinjitoz. Libri është konceptuar në një vështrim enciklopedik, kulturor dhe profesional, me një synim të qartë: Për të komunikuar me një numër të madh lexuesish dhe përfituesish. Në të cilin është shkrirë në një të vetme përvoja jetësore e autorit në praktikën profesionale për kultivimin e kësaj kulture me vlera të gjithë anshme siç është dafina me arsenalin e arritjeve dhe të dijeve në praktikën dhe shkencën botërore, të cilën e ka aq për zemër autori i saj.

Në të gjithë kapitujt e librit, autori Dr Selman Mëziu, na udhëheq në mënyrë të këndshme në një udhëtim historik nga muzguj i shekujve pellazgjik e deri në qytetarinë moderne shqiptare.Në faqet e këtij libri lexuesi do takojë dafinën në lojrat olimpike të Greqisë së lashtë apo edhe në perandorinë e Romës së lashtë. E ndeshim kudo edhe në toponimistikë dhe në antroponomi, në festat pagane apo në kurorëzimet solemne triumfuese të kohëve moderne.

Në promovimin e dy librave të Selman Mëziut folën mjaft koleg e të tjerë të pranishëm si:Gjon Fierza, Bujar Kapexhiu, Skënder Cala.

Fjala e Bujarit krijoi vërtet ilaritet në sallë kur ndër të tjera ai tha:"Unë nuk jam i kësaj fushe por i jap fjalën Selmanit se do ti lexoj me mjaft dëshirë dhe kuriozitet të dy librat që mi bëri dhuratë. E kam thënë disa herë dhe po e them përsëri se fjala Dibër ka shumë ngjashmëri me fjalët libër, qibër, sipër. Kështu ne jemi sipër gjithmonë përt nga zgjuarsia e mençuria dhe mua më bëhet qejfi kur shikoj tani se shumë dibranë po shkruajnë jo vetëm për artin, kulturën historinë por edhe në fusha të ndryshme që po shkëlqen edhe vetë Selmani.E tani si për humor mos t'i themi më Selman Mëziu por Selman Zbardhi se vërtet me botimet e tij enciklopedike po na zbardh faqen ne dibranëve edhe këtu në kryeqytet"

Në fund Selmani në fjalën përshëndetëse, duke falenderuar të pranishmit tha: " Unë vetë me këto dy libra që botova e mbylla triologjinë time rreth pylltarisë shqiptare. Tashmë unë do të shkruaj përsëri por do të kaloj në një fushë tjetër. Ju falenderoi të gjithëve për prezencën tuaj në këtë evinement, duke u bërë pjesë e gëzimit tim. Në fund u dha librat dhuratë të pranishmëve me autograf por kishte shtruar dhe një koktej ku u ngritën gotat e uruan të pranishmit Selmanin edhe për gjashtëdhjet vjetorin , edhe për botimin e dy librave vërtet me mjaft vlera. Nuk ishte harruar asnjë detaj që bëhen në të tilla raste. Në fund erdhi dhe torta, një tortë e madhe, e zbukuruar për këtë përvjetor lindje.

Mun te ura me kama druni / Po lufton Selman Okshtuni /
Mun te qarri, aty te qoshku / Po ndihmon dhe SelmanTroshku.

Okshtuni në këngët e trimërisë

Hajde hajde Selman Lika, se sot qenka dita

Nga **Prof. As. NAZMI KOÇI**

(Vijon nga numri i kaluar)

Kënga e Selman Likës i kushtohet një trimi nga Prodani. Fisi Likaj në vitin 1987 kishte 48 shtëpi dhe banonte në Prodan dhe në Muglicë. Ngjarja së cilës i kushtohet kënga ka ndodhi aty nga mesi i shekullit të 18-të. Sipas thënieve të Hoxhë Gjokës, Selman Lika kishte pasur miqësi me Avdi Canin nga një fshat më në thellësi të Dibrës. Prishja e miqësisë kishte ndodhur nga një shkuesi. Avdi Cani kishte kërkuar të merrte një vajzë nga Sebishti për djalin, por atë e kishte kërkuar me parë dhe e mori Selmani për djalin e tij. Avdiu vendosi të hakmerret ndaj Selmanit ditën e fundit të dasmës që ky bëri për martesën e djalit të tij. Me shumë rreth e miqësi të gjerë Avdi Cani mblodhi te Ura e Qytetit 600 burra pa u treguar përse i kishte thirrur. Kur u tregoi planin se donte të plaçkiste bagëtitë e Selman Likës që ta turpëronte atë, një pjesë refuzoi. Ata e njihnin Selman Likën dhe nuk donin të luftonin kundër tij. Në krye të 300 burrave Avdiu u nis të sulmonte stanin e Selman Likës në mesnatën e dasmës së djalit të këtij të fundit. Stani ishte në kodrën e Muglicës dhe Selmani e kishte atë rreth një orë larg shtëpisë. Te stani filloi grabitja, por edhe pushka. Barinjtë të vetëm rezistuan., njeri nga djemtë e Selmanit, Musai mbet i vrarë. Dhe populli thuri këngë. Tekstin e kësaj kënge e sjell edhe shkrimtari ynë i mirënjohur Haki Stërmilli i cili ka jetuar 6 muaj te Likajt në Prodan gjatë dimrit të vitit 1943-1944.

Vargjet e këngës thonë:

Hajde, hajde Selman Lika,
Sot me sot na qenka dita,
Qenka dita për me vdek,
300 huta ranë te dhent,
Ranë te dhent e ranë te dhitë,
Erdh haberi se u vranë barite,
Prej barive kush ka mbet,
Mbet Musai që gjetë rahmet,
Ja merr hakun baba i vet,
Se për një ai vret njëzetë.

Selman Lika rrëmbeu armët dhe u nis me shpejtësi. Me të u nis dhe Selman Troshku, një mik i tij nga Prevalli që ju ndodh afër. Bagëtitë e grabitura po zbrisnin nga ara e Shermetit në Krahavec për të dalë te livadhet e Hysjet për të kaluar të tre urat, zabelet mbi Çekiren, nën drurin e bukur për t'u futur në pyllin me pisha të Tërnovës. Të moshuarit tregonin se ajo natë kishte qenë e kthjellët e me hanë të plotë. SelmanLika me djemtë e njerëzit e tij i arrin kur ata e kishin kaluar Krahavecin dhe po dilnin përballë për t'u ngjitur në drejtim të Oreshnës. Vendi ishte i zhveshur por Selmani zuri vend pas ca gurëve dhe u vuri pushkën. Ai bëri kërdinë. Filluan të zbrazen pushkë edhe nga lagjet e tjera Ballaj, Katund e Oreshnjë. Lagjet sipër të dominuara nga fisi Koçi, edhe pse asokohe kishin qenë në hasmëri, morën rrugën me shpejtësi mbi zabelet e Plepës për t'u prerë rrugën grabitësve para se të futeshin në pyjet e Ternovës. Grabitësit të tmerruar nga kjo rezistencë e pa menduar u shpartalluan keqas. Disa të plagosur e me plagët që kullonin gjak vazhdonin të ziheshin për një dash apo për një dele. U vranë mbi 20 vetë dhe shumë të tjerë u plagosën, ikën nga sytë këmbët në panik të plotë. Dhe kënga vazhdon :

Mun te ura me kama druni
Po lufton Selman Okshtuni
Mun te qarri, aty te qoshku
Po ndihmon dhe Selman Troshku
Avdi Cani gupa madhi,
fort po ikën atij shullani
Po piskat ky Selman Lika
Avdi Cani e ty te raft pika
Nuk je burrë, por je si gru
mblodhe të shitun e më re mu
Ikin grabitësit tuj renkue
Na kanë vra na kanë dërmue
Si në Okshtun se kemi psue.

Okshtunas na paraqiten ndër shekuj të urtë e punëtorë, të ndershëm e njerëz të fjalës së



Malet e Okshtunit. Foto arkiv ©Abdurahim Ashiku

mbajtur, por dhe trima e guximtarë.

Një këngë gjithashtu e vjetër që nga koha e perandorisë turke, bën fjalë për rastin e të riut Avdi Hoxha. Në të vërtetë ai ishte nga fisi Sollaku, por me që i ati kishte qenë hoxhë, thirrej me mbiemrin Hoxha. Avdiu kishte studiuar në shkolla turke dhe duke qenë nxënës i shkëlqyer e kishin dërguar në Universitetin e Stambollit ku kishte studiuar shkenca ushtarake. Aty nga fundi i shekullit 19-te ai i përfundoi me sukses studimet dhe vendosi të vinte në shtëpi të shihte familjen, bleu dhe një manxerrë turku dhe mjaft fishekë dhe u nis për në Okshtun. Aso kohe rruga ishte e gjatë e plot rreziqe dhe kishte banda hajdutësh që zinin rrugën e zhvishnin dhe grabisnin kalimtarë e karvanë nëpër qafa malesh apo shtigje të ngushta. Kështu i ndodhi edhe djalit të ri, Avdi Hoxha, prej Okshtuni. Kur arriti në Derven të Stebleves, aty ku sot është kufiri shtetëror me Maqedoninë, një bande prej 8 grabitësish i kishte zënë prite. Ata i bënë thirrje të dorëzohej. Djali nuk u dorëzua por zuri pozicion pas një guri. Vendi ishte i zhveshur dhe maskimi i vështirë. Askush nga 8 burrat në pritë nuk e mori seriozisht të riun që vendosën ta grabisnin. I bënë thirrje të lidhej, por përgjigja qe: vetëm një herë më ka lidh nana në djep. Ata qëlluan ta trembnin, ai qëlloi që të mbrohej. Vrau tre dhe plagosi dy, u plagos rëndë dhe vetë. Në agoni vrau dhe të katërtin, plagosi dhe një tjetër dhe banda u shpartallua. Populli me autor anonim e përjetësoi Avdi Hoxhën në një këngë trimërie.

Disa nga vargjet e kësaj kënge thonë:

Avdi Hoxha t'u dalë prej mejtepi
Ne ate Derven ç'e zu gazepi
Jalla nane më dalsh lule xheneti
Të m'i thoni nanës njerke
Të ma bajë hallall hyzmete
Se jam rrethue nga tetë vetë
Nga tetë vetë, jam rrethue
i kam vra e i kam dërrmue
Në kuaj të Rekës i kam ngarkue...
Të lumtë gryka moj martinë
Se sot e bane ispate Avdinë...
L. Isaku e L. Bodurri
Si dhi për qafe nuk lidhet burri
Se më thonë djalë Okshtuni
Djalë Okshtuni e biri i plakut
Nuk ja lashë marren oxhakut.

Ngjarjet që i vunë shpesh në provë banorët e Okshtunit dhe që u përjetuan në këngë janë të shumta. Kam përshtypjen se tekstet e këtyre këngëve jo gjithmonë ia kanë arrit të shprehin madhështinë e veprës për të cilën bëhet fjalë, por se paku ja kanë dalë t'i ruajnë këto ngjarje në memorien e njerëzve deri sot. I kanë mbrojtur nga harresa dhe bjerrja e përjetshme.

Një ngjarje e tillë është ajo e një fshatari të varfër nga Oreshnja, Musa Mema. Sipas të dhënave duhet të ketë ndodhur aty nga mesi i shek. 18-të. Populli i varfër me shumë vështirësi mezi arrinte të përballonte hallet e jetës. Mbi këto halle ishin detyrimet që duhet t'i paguanin pushtetit të kohës dhe taksambledhësit që merrnin përqindje nga taksat e mbledhura, ishin të pamëshirshëm. Një i tillë kishte qenë edhe Hamit Markja nga një fshat i Dibrës që sot bën pjesë në territorin e Maqedonisë. Ai e shtrëngoi shumë Musa Memën që t'i paguante taksat detyrimisht pa u larguar ai nga fshati. Musai ju përgjigj se jam dakord, por nuk kam asnjë mundësi veç të të jap shpirtin në këtë moment. Unë dhe atë ta marr i tha taksambledhësi, por me që nuk ke çfarë të më japish, atëherë, më jep gruan iu krekos me përçmim pushtetari.

I varfër, por kurajoz, njeriu i urtë i qe përgjigjur: atë po, po ta jap, por me prit pak sa ta thërras.

Musai u fut në shtëpi, nxori topanxhën e sermit me gurë stralli që e ruante me shumë kujdes, e kontrolloi dhe e rregulloi mirë dhe ja dha me vrap në derë. Ja vendosi armën në gjoks dhe i tha:

- Kjo është gruaja ime, merre, ma gëzofsh dhe i tërhoqi këmbëzën.

Taksidari mbeti në vend i vrarë. Fshatarët për të mos u ndotur vendi e varrosën te xhamia në katund... Askush nga të afërmit e tij nuk erdhi në Okshtun për ta kërkuar varrin. Deri në kohët tona ai vend quhet "te varri i Hamit Markes".

Për një ngjarje me të njëjtin motiv ka lindur e këndohet dhe në kohët tona, kënga e Halil Gashit. Okshtuni e kishte pasur me kohë një trim të tillë. Musa Mema e mbrojti nderin e familjes së tij. Pushteti i kohës dërgoi të nesërmen në Okshtun një togë me 30 zaptije dhe një toger që t'i komandonte me detyrën që ta arrestonin Musa Memen.

Kryeplaku dhe populli i Okshtunit u deklaruan:

- Ju keni hyrë në këtë fshat, por nuk do të dilni gjallë asnjë.

Pas disa traktativash, i lanë të iknin me kushtin që të vendoseshin në rresht për një, pushkët do t'i vendosni në sup me tytën poshtë dhe do të ecnin deri në qafën e Lejçanit (është afër një orë rrugë), pa e kthyer kokën as majtas e as djathtas.

Xhandarët pranuan dhe u larguan të turpëruar nga Okshtuni, ndryshe do t'i kishin bërë shoqëri Hamitit, aty të xhamija.

Histori trimërie të banorëve të Okshtunit, herë të përjetuara në këngë e herë jo, ka pa fund. Ndoshta ato kulmojnë me atë të patriotit të madh dibran, njeriut të shekullit, Okshtunasit Hasan Shermeti (Hoxhe Muglica).

Në 15 Qershor të vitit 1915, forcat shoviniste serbe e arrestuan atë, e çuan të vendi që quhet ara e Shermeti, e dhunuan fizikisht e psikologjikisht, e detyruan të hapte vetë varrin e tij. Dhe Hoxha e hapi vetë varrin. Po ndëshkohej për patriotizmin e tij dhe punën që kishte bërë për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe. I kërkuan të deklaronte se kjo tokë nuk është shqiptare. Fjala e hoxhës peshonte shumë në krahinë dhe me gjerë. Këtë Hoxha nuk e bëri. Ai bëri deklaratën lapidare:

Në këtë vend ku unë po hi
Ka qenë, asht e do jetë Shqipni.

U pushkatua dhe mbeti i pavdekshëm aty te ara e Shermetit, bashkë me shokun e tij, Avdi Sallakun, të varrosur në një varr. Dy ditë më vonë fshatarët e Okshtunit e morën prej aty dhe e varrosën me nderimet më të mëdha idhullin e tyre.

Për këtë ngjarje ka realizuar një monografi dinjitoze studiuesja e re Valbona Ramçi. Edhe për Hoxhë Muglicën Okshtuni thuri këngë.

Gjatë kryengritjes së popullit të Grykës së Vogël, populli i Okshtunit i udhëhequr nga Hoxhë Muglica, luftoi së bashku me luftëtarët e tjerë të Dibrës te Ura e Spiles e kodrat e Vrabiçit, i bëri pritë heroike armikut që la rreth 1500 të vrarë. Por pati dhe 80 dëshmorë, midis tyre 25 nga Okshtuni. Serbet dogjën vetëm në Okshtun 120 shtëpi (përfshirë edhe shtëpinë e autorit të këtyre radhëve), por luftëtarët mbrojtën popullsinë që po emigronte drejt Elbasanit e Tiranës.

Ka këngë e heroizma dhe për periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e pas saj.

Populli thuri këngë edhe për Sabri Cakën që u vra në lulen e rinisë duke luftuar heroikisht në Tendën e Qypit në janar të vitit 1944.

Këngë u thur edhe për Imer Koçin që strehoi shtabin e përgjithshëm dhe misionin anglez gjatë dimrit të vitit 1943-1944. Ndërsa Haki Stermilli na sjell dëshminë e tij kur strehohej në Prodan. Ai kishte takuar aty partizanët e Brigadës së Parë sulmuese dhe komandantin e tyre. Kur i thashë se një forcë gjermano-balliste kishte filluar marshimin drejt nesh, ai mu përgjigj. Jemi të lodhur dhe do të pushojmë në këtë fshat mikpritës, por në se ata do të guxojnë, ne do ta shndërrojmë këtë fshat në një Stalingrad të vogël.

* * *

Në formatin e një shkrimi të tillë nuk mund ta rrokësh në përmasat që ka, trimërinë dhepatriotizmin e një populli punëtor, të ndershëm e bujar, me cilësitë e shqiptarit e të dibranit të kulluar, si ai i Okshtunit. Do të duhen studime e shkrime të gjëra, monografi a libra të tërë a të tipit të monografisë së Valbonës, si ai me titull: Hoxhe Hasan Muglica- klerik dhe luftëtar i shquar për lirinë dhe gjuhën shqipe.

Prandaj zgjodha t'i mbyll këto radhë me një ngjarje që ma ka treguar vetë Okshtunasi legjendar Gani Hajri (Koçi). I ditur e i matur, komandant vendi në Dibër e në Mat në vitet e para te pushtetit popullor, njeriu që për efekt të detyrës që kryente mbante armë, por që kurrë nuk i përdori ato me popullin e vet, pasi arma më e fuqishme e tij ishte fjala e Dibranit, ma ka treguar këtë me gojën e tij.

Unë sapo kisha mbushur 22 vjeç dhe me dhanë një emërim për të punuar si mjek në Grykë të Vogël. Ganiu, shok e fis i babait tim e priti shumë mirë. Do ta kalosh shumë mirë më tha. Janë popull punëtor dhe shumë të zgjuar e me tradita dhe tregoi një ngjarje të jetuar:

Në vitet e para të pushtetit, puna e solli që njëherë me një grup shokësh përfunduam një natë te një familje e përmendur te Lleshet e Zogje në Grykë të Vogël. I zoti i shtëpisë na priti e na nderoi, por me që ishim me uniforma e pati vështirë të na ulte e sistemonte në dhomën e miqve. U sistemuam si mundëm. Më pas gjatë muhabetit ai na pyeti nga ishim dhe sa këngë trimërie kishte fshati apo krahina nga vinim. Folën të gjithë, fola dhe unë. Pasi unë mbarova, ai me tha: Çohu ti dhe ulu këtu në qoshe. Dhe ju drejtua valles: Ju të tjerët, nga do qofshi, nga jugu apo veriu, kurrë të mos ja zini vendin këtij burri.

Më vonë unë qëndrova më shumë se 15 vjet në Grykë të Vogël dhe pata rastin ta prek nga afër mençurinë dhe mirësinë e atij popullit. I vërtetova të gjitha ato që më pat thënë Ganiu, për njerëzit dhe traditat e tyre. Ata e donin veçanërisht Okshtunin nga unë vija, prandaj unë u ndjeva aty si në shtëpinë time.

Korrik 2016

Promovimi i librit 'Blegërimat e dashurisë'...

Nga* RAMIZ GJINI - *Fragment nga romani "Pëllumbat e Rrugës"

Tushi mori vesh se në sallën e bibliotekës së Bibollit, bëhej promovimi i një libri. Libri titullohej *Blegërimat e dashurisë* dhe ishte shkruar nga poeti dhe prozatori i madh Aush Loshi. Ai vendosi të shkonte në këtë aktivitet. Ky libër duhet lexuar, mendoi ai, pasi do të më bëjë të blegëri si një poet i madh. Lushja, do të preket nga blegërimat e mia e do fillojë të më dojë.

Kur hyri Tushi brenda sallës ku mbahej aktiviteti, qe ende shpejt; nuk kishte mbërritur ora e caktuar. Ndodheshin aty vetëm katërpesë të ardhur, të cilët, kishin zënë vend të ulur në karrige. Organizatorët venin e vinin, për t'u dhënë dorën e fundit vendosjes së objekteve. Latif Kishaveci merrej me mikrofonin dhe foninë, duke bërë prova: një, dy, tre, katër...

Një mbesë e poetit Aush Loshit, studente e shkollës së mesme, po vendoste në tryeza shishet e pieve. Herë pas here, ajo ndalonte dhe hidhte vështrime për të parë nëse gjendej çdo gjë në vendin e duhur.

Diku andej nga radhët e para, Lemja, gruaja e shefit të policisë, Filip Zhulit, fliste me shitësen e bulmetit, Kaleme Shollën.

Kalemja qe gruaja e akademikut Hashim Sholla, që pritej të vinte për të mbajtur një kumtesë shkencore në lidhje me krijimtarinë e poetit dhe prozatorit Aush Loshi.

Tushi vajti dhe u ul diku pranë tyre.

Dy gratë po llafoseshin në lidhje me një krem, që quhej coconutoil. Kalemja thoshte se ky krem, i kishte prishur lëkurën e fytyrës dhe se nuk do ta përdorte kurrë më. Lemja, e kundërshtonte. Thoshte se kremi coconutoil, qe më i miri në botë dhe se e kishte lexuar në matrikull, që ishte njëqindpërqind organik.

Tushi i dëgjonte pa ndonjë interes, madje ngase i dhimbte koka, ndjeu bezdi dhe vendosi të ndërronte vend. Por ndodhi që gratë e ndërprenë diskutimin rreth kremit coconutoil. Lemja, nisi t'i rrëfente Kalemes një histori tjetër. Kjo histori, filloi t'i pëlqente Tushit, ndaj mbajti vesh.

- ....Shitësi më dha kartën, të cilën e gërvishta, por nuk fitova. - thoshte Lemja. - Bleva një tjetër kartë, e gërvishta edhe atë, por prap nuk fitova! Mora edhe një kartë të tretë. E gërvishta dhe fitova pesëmijë lekë... Pesëmijë, thashë, moj, nuk thashë tetë! Me këto lekë bleva pesë karta. I gërvishta dhe fitova njëmijë. Ia dhashë shitësit të më jepte një tjetër kartë dhe ai ma dha. Desha ta gërvisht, por nuk më bënte zemra ta gërvishtja. Si, pse? Kisha frikë, moj ti, se do të humbisia... Përse, tjetër?! Ç'të bëja? Thashë me vete: mjaft kam gërvishtur... Jo, moj, jo... Unë nuk i blej ato karta sepse dua të fitoj. Ti e di: kam aq shumë para sa nuk më duhen më. Sak nuk më duhen. Unë i blej ato, thjeshtë, sepse më pëlqen të gërvish. E, mirë, tani... Gërvish, gërvisht, njësoj është. Por, kuptohet, që edhe të humb para nuk më pëlqen. Kështu, ia ktheva kartën shitësit dhe i mora lekët.

Me ato lekë, bleva tre llokume me arra. Llokume moj thashë, llokume... Njërën llokume e hëngra vetë, tjetra më ra padashje në tokë. Këto që vijnë nga Turqia, ti e di, janë llokume të mira. I ke provuar ndonjëherë? Janë aq të ëmbël sa të shkrihen në gojë. Jo, moj, jo, nuk janë vetëm sheqer. Kanë edhe shumë gjëra të tjera brenda. Blen edhe ti? Shumë mirë bën, që blen edhe ti nga ato, pasi këto të vendit nuk bëjnë fare. Unë blej gjithmonë... Pra, kur më ra llokumja në tokë, mu dhimbs. Thashë njëherë, të ulem e ta marr, por ti e din, moj Kaleme, që në tokë udhëtojnë mikrobe. Kam lexuar diku, që mikrobet transportojnë sëmundje kondrabandë nga njëri vend tek tjetri. Edhe njerëzit në pushtet, prandaj bëjnë kondrabandë, sepse janë infektuar nga mikrobe të tilla. Kontrabanda, është sëmundje, që shkaktohet dhe përhapet nga mikrobet. Kështu, e lash, nuk e mora fare atë llokume. Pastaj, pashë që ia ngjiti dorën një lypës, që kaloi atypari.

Llokumen e tretë, ia fala një fëmie qaraman, i cili, fare pranë meje, shkërryhej në tokë, përplaste këmbët e qante. Uaaa...! çfar fëmije mistrec që ishte, moj ti! I ankohej të ëmës: donte që në vend të një ariu prej pellushi, e ëma t'i blinte e t'i jepte minaren e xhamisë së Bibollit! Kur i dhashë llokumen, ai u qetësua, nuk e deshi më minaren e xhamisë. Prap po qesh ti? Jo, moj, jo, nuk e them për t'u tallur. Jam grua serioze unë, nuk jam shakaxhie... Dëgjo, tani, dëgjo...

E ëma e fëmiut, më falenderoi... Eh! mirë, edhe ti tani... Ngele duke më korigjuar! Fëmijës, fëmiut, njësoj është. Pra, ajo më falenderoi. Madje shkëmbyen edhe numrat e telefonit. Më duket se quhej Hajrie. Hajria ngeli pa mend kur unë i thashë, që isha gruaja e shefit të policisë Filip Zhulit. Si...? u habit ajo. Je gruaja e sherifit të policisë? Jo e sherifit, moj, i thashë, por e shefit. Ne nuk kemi sherif në Biboll. Në fakt e kemi një sherif, kemi atë shoferin e autobuzit, Sherif Dermekun. Prit, moj, mjaft qeshe... E thashë ashtu kot, sa për muhabet, sepse e di që kemi shumë njerëz me emrin Sherif. Mirë, tani, mirë... Edhe pak dhe mbarova... Pra, kur i thashë se isha gruaja e shefit të policisë, nuk donte ta besonte. Prej habisë, bëri dy hapa prapa, u pengua dhe u rrëzua në tokë. Të betohem moj Kaleme, nuk të gënjej.

E ndihmova të ngrihej dhe ajo e shkreta më falenderoi. Si u ndamë, vajta në shtëpi. U ula pranë dritares që të prisja të vinte im shoq, Filipi.

Teksa rrija në dritare, hodha sytë poshtë në rrugë dhe, uaaa...! moj Kaleme! Uaaa...! moj motra ime, çfarë llahtari! U llahtarisa kur mendova, që disa gra të Bibollit, marrin guximin dhe hidhen nga kati i pestë, apo i gjashtë, edhe pse e dinë, që vdekjen e kanë të sigurtë. Unë për vete nuk do ta bëja kurrë këtë. Kurrën e kurrës! Do ta bëje ti, Kaleme? Hë, pra... Nuk bëhet, jo. Fundja, moj motra ime, përse do ta bëjmë? Nuk kemi asnjë arsye për ta bërë një gjë të tillë. Apo e kam gabim? Hë, thuaje! A nuk është tmerr, vetëm ta mendosh?! Si? Ç'thua moj? Po u hodhe, hapi krahët sa të duash, vdekjen e ke të sigurtë. I thonë gjashtë kate, oj ti! Nuk po hidhesh në valle, por po hidhesh nga maja e pallatit. Pastaj jeta eshtë e bukur... Një gjumë do t'i fshinte të gjitha mendimet e liga. Prandaj fika dritën dhe u shtriva për të fjetur. ...Hë moj dëgjo se ngele duke kthyer kokën nga dera! Do të të vijë edhe burri. Duro. Të tha që do të vijë? Atëherë, përse mërzitesh? E di, e di, që ka për të mbajtur kumtesë... Dëgjo, tani, dëgjo: andej nga e vona, erdhi im shoq, Filipi. Menjëherë e kuptova që kishte pirë, sepse e dëgjova qysh kur ndodhej prapa derës. Iu deshën dhjetë minuta të fuste çelsin në vrimë për të hapur derën. Pastaj kur hyri, kuptova që nuk isha gabuar, sepse të qelbte era e alkolit. Epo, hajt ma, thashë me vete, do ta bëjmë njëherë; sepse burri sido që të jetë, i dehur apo jo, ai burrë është, në krevat nuk është i keq. Pse qesh, moj si budallaçkë? A nuk është kështu? Uuuu..., kjo! Të raftë pika, të raftë! Shikon? Edhe ty ta ka qejfi... Mjaft, tani, mjaft qeshe! Mjaft, pra...! Do më lësh ta tregoj gjer në fund apo jo? ...Pra, siç thashë hyri Filipi brenda. Si hyri brenda, u zhvesh, u fut poshtë jorganit dhe u rehatua. Pastaj tamam kur unë prisja të zgjaste dorën të më prekte, ai hapi gojën e tha se bota po shkonte drejt ngrohjes globale dhe se kjo do të ishte një katastrofë e madhe për gjithë njerëzimin. Tani merre me mend vetë, moj motër, çfarë ndjeva ato çaste. E di si u bëra?! Më erdhi aq inatë sa... Çfarë prisja unë të thoshte dhe çfarë tha ai, damullmadhi! Mu ngritën nervat. Im shoq, moj ti, gjithmonë mendon më të keqen. E mendon dhe e thotë bash në vendin dhe kohën e gabuar. Dhe unë, nuk di çfarë të bëj me të. Nuk është fare optimist. Unë nuk u shqetësova pse ai nuk.... Kupton ç'dua të them? Fare, fare nuk u shqetësova. Por, a ishte vendi dhe koha për ta thënë atë llaf, moj aman? Rri, pra, mos qesh! Shif, kjo... Do më lësh të mbaroj, apo si? Ku e kisha fjalën? Hë, po... I fola, nuk lash fjalë pa i thënë, derisa më në fund, më erdhi shumë keq për veten dhe nisa të qaja. Kurse ai, në vend që të prekej e të më merrte me të mirë, lëshoj një pordhë aq të madhe, sa u ngrit jorgani përpjetë. Atëherë, nuk u përmbajta dot dhe e quajta derr. ...Prap po qesh ti, moj? Për kokë të fëmijëve, derr i thashë. Nuk po tallem. Do më lësh të mbaroj, apo si e ke hallin. Prit, pra, ta vazhdoj... I thashë: ik shko e pordh në ndonjë konferencë shtypi; ose pordhi sekretares tënde, asaj fyrifyçkës... Ti s'je tjetër veçse një derr me feçkë të llangosur. Kështu i thashë. Si? Të shkriva? ...Më raftë pika, po të gënjeva! ... Si?! E çfarë pastaj pse e kam burrë? Mirë, po pres sa të mbledhësh veten ti, pastaj vazhdoj prap unë... Ai nuk u besoi veshëve. E di si u bë? Ç'të të them...!Pa thënë asnjë fjalë, u ngrit, u vesh, hapi sirtarin e komosë dhe mori pistoletën. Më ngriu gjaku se thashë do më vriste. Por ai mori edhe dy krëhër të tjerë me fishekë dhe doli nga shtëpia. I hypi makinës, dhe për ta bërë veten të pakrahasueshëm, vajti belaziu e vrau gjithë tufën me derra të Ndoc Noksanit. Kur u kthye tha: tani, moj grua, gjej ndonjë krahasim tjetër sepse nuk ka më derra. I vrava të gjithë.

Tani, moj Kaleme, qesh sa të duash, sepse e ke hak.... Nuk ka më derra, tha Filipi! Si nuk paska më derra?! Derra nuk pati vetëm Ndoc Noksani, derra ka gjithë bota. Si i thua ti kësaj, moj Kaleme? Si i thua ti kësaj, moj motër? Një i dehur, kur nuk është agresiv, bëhet i lezeçëm... Por dëmit, moj, atij si i bëhej? I thashë Filipit, të shkonte menjëherë dhe t'i paguante dëmin Ndocit. Sepse unë....

Ato çaste, Lemja e ndërpreu rrëfimin, sepse ua afrua aty vetë poeti Aush Loshi.

Aushi, i vuri Tushit dorën në sup dhe me shumë dashamirësi i tha:

- Ti more djalë, po më dukesh shumë i mërzitur. A nuk më thua ç'hall të ka gjetur?

- Jam mirë, - tha Tushi. - Vetëm se po më dhemb pak koka.

- Nga cila anë, du me thanë, të dhemb më shumë, more bir?- pyeti Aushi.

- Nga ana e majtë, - tha Tushi. Dhe preku kokën me dorë.

- Si të vjen dhimbja, me hope, apo e vazhdushme.

- Më vjen me hope. Në kokë kam rrahje si ato të zemrës. Sa herë rreh, dhemb.

- Po anën tjetër të kokës, si e ndjen?

- Atë nuk e ndjej fare. - tha Tushi.- Sikur nuk e kam timen, sikur kanë marrë gjysmën e kokës së një personi tjetër dhe ia kanë ngjitur gjysmës time.

- E ka nga dashuria, - tha poeti Aush me sigurinë e një kompetenti.- Gjysma e kokës tënde, dhemb për shkak të gjysmë tjetër, që nuk është e jotja. Njerëzit dashurohen sepse janë gjysma. Prandaj kërkojnë të bashkohen për t'u plotësuar. Bashkimi i dy gjysmave bën një të plotë. Por do bëjmë diçka...

Mori nga tryeza librin e tij me blegërima dashurie, shkruajti një autograf, ia la në dorë Tushit e tha:

- Të rekomandoj ta hapësh librin në faqen numër dyqind e pesëdhjetë. Aty do të gjeshë një poezi, që unë e kam shkruar për dhimbjen e kokës, që shkakton nganjëherë dashuria. Sapo ta lexosh, do të të pushojë. Pastaj mund të lexosh të tjerat, një nga një...

- Ju falenderoj shumë..., - tha Tushi.

- Nuk ka përse, - ia ktheu Aushi. - Unë jam poet i popullit, shkruaj për popullin dhe preki me penë aty ku i dhëmb popullit.

- Nëse mund t'ju pyes, - tha Tushi, - a gjendet këtu në këtë libër edhe ndonjë poezi për shtërngimet e barkut, sepse nganjëherë... Pastaj mua më dhëmbin edhe kyçet kur prishet koha.

- Të them të drejtën, - nisi të thoshte Aushi, - në librin tim, nuk ka ndonjë poezi, shkruar enkas për këto lloj dhimbjesh, por e them me bindje të thellë, që secila prej tyre, mund t'ju ndihmojë disi... Du me thanë, do ndjeni një far lehtësimi, menjëherë sapo t'i lexoni.

Ato çaste, mbërriti aty Liza Piluri, një zonjë e shëmtuar kjo, por që vishej bukur me paratë e të shoqit që bënte biznes ndërtimi.

Aushi, i kërkoi ndjesë Tushit dhe u kthye të përshëndetej me Lizën, e cila, ndërsa ecte drejt tij, hapi krahët e thirri:

- Po ku je more gjigand, more Sulejmani i Madhërishëm i letërsisë bashkëkohore?! Uaaaa! Sa shumë kohë u bë pa u parë! Uaaa...! Sa shumë kohë!

- A vërtet, ti je Liza? - pyeti Aushi dhe hapi krahët ta përqafonte. - Vërtet ti je?! Tani që po të shikoj nuk po u besoj syve. Si ka mundësi që nuk paskeni ndryshuar fare?! Qenke tamam ajo Liza e bukur, ajo që keni qenë para tridhjetë vjetësh, pa asnjë ndryshim. Uauuu..! çfarë befasie!

Dhe u shtrënguan në një përqafim që zgjati plot dhjetë minuta. Gjatë këtij përqafimi, ata patën rastin të bënin edhe një dorë muhabet duke i pështëritur njëri-tjetrit vesh më vesh. Sa herë i pështëriste Aushi, qeshte Liza, kur i pështëriste Liza, qeshnin të dy.

Kjo Liza e bukur, kishte një hundë si sqep papagalli, majën e së cilës, e kishte lyer padashje me të kuq buzësh. Qe e dobët si thaçkë, por i kish mbushur gropëzat e faqeve me krem të trashë. Për t'i dhënë fytyrës formë të rregullt ovale, në vend të furçës, ajo kishte përdorur një shpatull nga ato që ustallarët i përdorin për të patinuar muret. Mbante në kokë një kapele me pupla, të cilat, padyshim vinin nga pularia me shumë emër e Hilë Kakarriqit. Kishte mbathur një palë këpucë me taka të larta prej qelqi delikat, ndaj ecte ngadalë e gjithë kujdes, që të mos i thyheshin. Nga supi i djathtë, i varej me rryp një çantë e bukur, moderne, sa një kuti shkrepseje, brenda së cilës, mbante kunja për të kruar dhëmbët e prishur.

Tushi i hodhi një sy librit që i la në dorë Aushi dhe kuptoi, që ky libër, do t'i qëndronte shumë gjatë kohës, sepse kishte kapakë të trashë, fletë të trasha, shkronja të mëdha të shkruara me bojë të trashë, si dhe ishte qepur me pè, gjithashtu të trashë.

Kur i shfletoje fletët, ata lëshonin një si gërvimë aq melankolike sa duhej të kishe zemër të fortë t'i përballoje emocionet që të pushtonin. Edhe po të mos i lexoje fare blegërimat që kishte brenda ky libër, mjaftonte kjo gërvimë, që lëshonin fletët për të kuptuar vlerat e Aushit si poet.

Ai u përpoq të gjente faqen me numër dyqind e pesëdhjetë, ku ndodhej ajo poezia, që i rekomandoi Aushi, por u çudit kur zbuloi, që libri na kishte vetëm njëqind e dhjetë faqe.

Kështu, ai mendoi, që ndoshta nuk e kish pas dëgjuar mirë çfarë i tha poeti Aush.

* * *

Organizatorët e aktivitetit, kishin vendosur, që pjesmarrësit të hanin e pinin njëherë, që të



Ramiz Gjini
Pëllumbat e rrugës - roman
Botimet M&B.
ISBN: 978-9928-172-56-3
Çmimi: 700 lekë

botime

ishin të ngopur kur të fillonte mbajtja e kumtesave, që vërtet ishin të lodhëshme, por shumë të rëndësishme. Një veprim i planifikuar me shumë mend ky, sepse ndodhte, që auditori, ngase e mbante mendjen tek tryezat e shtruara, nuk dëgjonte çfarë thuhej në podjum. Veç kësaj kishte ndodhur shpesh, që të ftuarve në sallë, u kishte rënë të fikët, ngase nuk u kishin rezistuar dot gjer në fund kumtesave të gjata.

Kjo pati ndodhur njëherë me Lemen, gruan e shefit të policisë Filip Zhulit, të cilës, i hahej më tepër se të tjerëve; por rasti më tragjik i ndodhi atë ditë vetë poetit dhe prozatorit Aush Loshi.

Ngase kishte dy ditë pa ngrënë nga meraku i aktivitetit, Aushit i ra të fikët. Ndodhi pikërisht në çastet kur po i afrohej një pjate të mbushur me kukurec të pjekur. Në fillim ndjeu si dobësi. Ai nuk e kuptoi nëse kjo dobësi i vinte nga zemra, nga stomaku, apo qe nga ato, që u thonë dobësi karkteri. Kur kuptoi që nuk mund të rrinte në këmbë, u mbajt për një karrigeje derisa u ul në gjunjë. Kur Liza Piluri u afrua ta kapë për krahu që ta mbante, Aushi u plandos në dysheme.

Liza i dha shpejt e shpejt, njëra pas tjetrës pesë shpulla për ta përmendur, por ai nuk u përmend. Atëherë, me shumë nxitim, ajo i derdhi në fytyrë një pagure të madhe kokakola, që shkumonte, pastaj dy red bull nga ato që pinë vipat në emisionet televizive si dhe katër kanaçe pepsi; tek e mbramja, ajo ia lau fytyrën me ujë të gazuar, por sërish pa rezultat.

- Bëni diçka, - tha pastaj Liza si me të lutur teksa hidhte rrotull një vështrim të shqetësuar. -Nuk po ndërmendet...! Dhe ta dini, që ky nuk bën shaka; do të vdesë seriozishtë...

U afrua Tushi, ngase i vajti ndërmend që t'i nxirrte gjuhën, por vuri rè, që Aushi gjuhën e kishte jashtë. Atëherë e tundi dhe e shkundi fort për supesh, ndërsa me zë të lartë i thoshte:

- Zotni Aush! O zotni Aush! Ju lutem, hapini sytë dhe shikoni, që të kuptoni çfarë hataje po na bëni? Ju po lini koqen e namit! Na mblodhe për dasëm, apo na mblodhe për mort?!

Ndërsa i fliste, ai i futi edhe dy shpulla me të majtën, por Aushi sërish nuk luajti vendit.

Atëherë, ia behu aty akademiku Hashim Sholla, i cili, nga shkonte shtynte një karrocë të madhe si ato të supermarketeve, të mbushur kapicë me punime shkencore. Për ta sjellë në vete, akademiku Hashim, e gjuajti Aushin mu në tepe të kresë me një dosje të trashë, të mbushur me plot katërqind fletët e një punimi shkencor.

Lemja, u llahtaris me çfarë i panë sytë; ngase nuk po e mbanin këmbët, u mbështet pas Kalemes, që të mos binte.

Kalemja e rroku me krahë për mezi Lemen dhe hapi këmbët, që ta mbante fort, ndërsa përpiqej ta qetësonte duke e këshilluar të mos trembej sepse i shoqi, Hashimi, dinte çfarë bënte.

Kur pa që Aushi nuk po përmendej, akademiku Hashim, mori nga karroca e tij një fjalor të trashë enciklopedik dhe e goditi fort, kësaj here, pas koke.

Pas goditjes, Aushi futi njëherë gjuhën brenda, por nuk dihet pse e nxorri prap; pastaj hapi sytë për aq kohë, sa iu desh të ngulte vështrimin mbi pjatën me kukurec, që ndodhej në tryezën e shtruar, sepse pas kësaj, ai i mbylli sërish.

Menduan se vdiq, sepse forca e goditjes që dha akademiku Hashim, nuk ishte llogaritur mirë; ishte tejkaluar ajo masë, që duhej vetëm për ta përmendur dhe jo për ta vrarë Aushin.

Duhet thënë, që në Biboll, masa e goditjes, ka qenë dhe vazhdon të mbetet një problem i madh. Njerëzit nuk e kanë të kultivuar si duhet sensin e masës. Ata nisen me qëllimin e mirë për të të bërë një shërbim, dhe krejt pa dashje, të vrasin fare. Kjo lloj vrasje, klasifikohet si vrasje e keqe, ndodhur si pasojë e një qëllimi të mirë.

Autorët që kryejnë vrasje të keqe, ndodhur si pasojë e një qëllimi të mirë, janë të detyruar t'u nënshtrohen disa proçedurave formale në gjykatë për t'u shpallur, pastaj, të pafajshëm.

Vdekja e poetit dhe prozatorit Aush Loshi, do të ishte një humbje e madhe në Biboll. Ai, përveçse ishte president i katër shoqatave, që i kishte ngritur vetë, (dy qenë kulturore, kurse dy të tjerat patriotike), ishte edhe krijues i veçantë dhe i jashtëzakonshëm në botën e letrave.

Shumica e veprave të tij, qenë ilustruar me fotografi të personazheve, të cilët, ishin kapur nga aparati fotografik gjatë veprimit të ngjarjeve. Aushi, kishte mundur të fotografonte, sidomos, momentet më suksesive të zhvillimit të konfliktit si dhe pikat kulminante. Në librat e tij, kishte katundarë që bënin shurrën në lulishte, duke u fsheur prapa busteve të heronjve të partive politike; gra që dërgonin lule tek varret e dashnoreve të burrave të tyre; kishte drejtorë modestë digasteresh, që e ndanin rrogën me sekretaret e tyre të varfëra; mjekë që merrnin pjesë dhe qanin me lot në varrimet e pacientëve që vdisnin; kishte deputetë, që dhiheshin në brekë ngase nuk e braktisnin dot parlamentin as për të shkuar në banjo; kishte politikanë që Hanin një herë në dy ditë dhe nuk mbyllnin sy për të fjetur me netë të tëra, ngase merreshin me hallet e popullit; kishte filantropë të pasur, që e shkrinin pasurinë e tyre duke u dhuruar shkollave patatina, lëpirëse, kokoshka, lapsa, letra me ngjyra dhe topa llastiku; kishte lule që flisnin, pemë që luanin basketboll, mace kamarjere, qen shakaxhinj, krimba që bënin mjaltë, arinj namuzlinj, flutura që dashuroheshin me lakuriq nate; pula që hanin dhelprën, breshka që ndërronin zhguallin me njëra-tjetrën, kishte... e ç'nuk kishte në historitë e veprave të Aushit.

Interesante ishte mënyra e veçantë që përdorte Aushi për t'i shkruar historitë.

Para se të niste të shkruante, ai pyeste lart e poshtë njerëz kompetentë në fusha të ndryshme duke bërë kështu një lloi investigimi në aspektin letrar. Nëse personazhi i tij ishte kriminel, Aushi shkonte e pyeste një prokuror se si duhej ta përshkruante, çfarë vesesh të këqia duhej t'i mvishte; merrte njohuri mbi teoritë kriminologjike, që të kuptonte si funksjonon një mendje kriminale; pastaj ulej dhe shkruante. Libri i nisur si një roman, përfundonte si doracak udhëzues për punonjësit e drejtësisë. Nëse shkruante një frazë, që tregonte se personazhi i tij ishte i sëmurë nga zemra, ai shkonte dhe pyeste ndonjë kardiolog për simptomat dhe prognozat e sëmundjes së zemrës. Donte të dinte si bëheshin egzaminimet dhe testet e trajtimit për të parandaluar ndërlikimet. Dhe i shkruante të gjitha sa i thonin, duke bërë tek-tuk ndonjë ndryshim sipas rradakes së tij. Kësisoj, libri mbushej nga fillimi në fund me kalvarin e halleve dhe vuajtjeve të të sëmurit.

Nëse vendoste t'i vdiste personazhet, ai lexonte kronikën e zezë nëpër gazeta, ose i bashkëngjitej ndonjë kortezhi të përmortshëm, që ecte pas arkivolit ngadalë drejtë varrezës.

I pyeste njerëzit, përse, dhe si kishte vdekur i ndjeri, a kishte vuajtur shumë, sa vjeçë kishte qenë; kishte qenë i gjatë apo i shkurtër; si vishej, ku e kishte pas pirë kafenë dhe a i kishte pas paguar në rregull energjinë elektrike dhe taksat; a kishte lënë grua, fëmijë, e kështu me radhë.

Dhe mbante shënim gjithshka dëgjonte.

Skenat e dashurisë, ai i peshkonte nëpër stolat e parqeve, ose ngjitej në ndonjë pemë për të parë si brac përmes dritareve të dhomave ku flinin çiftet.

Një herë ai deshi të provokonte një flirt me një vajzë të re dhe të bukur, që të kishte mundësi të shkruante një poezi, por ajo e pështyu, pastaj e shtyu dhe e rrëzoi mu në trotuar.

Edhe pse rrëzimi qe gati fatal, sepse iu rropat koka për pllakave të trotuarit, kjo ndodhi, iu duk interesante Aushit. "Kjo që më ndodhi me këtë vajzë, mendoi ai, vërtet nuk mund të bëhet poezi, por ama, mund të bëhet prozë, mund të dalë një tregim shumë interesant".

Atë natë nuk fjeti fare, e gdhiu duke shkruar.

Kur e përfundoi tregimin, iu kthye sërish nga e para dhe i dha edhe një dorë të fundit. Pastaj e lexoi me një frymë nga fillimi në fund dhe mbeti shumë i kënaqur me punën që kishte kryer. Aq shumë u egzaltua, sa vajti të gjente vajzën, që ta falenderonte, për frymëzimin që ajo i kishte dhënë, por e kapën vëllezërit e saj dhe i dhanë një dru aq të shëndoshë sa e bënë për spital. Por edhe kjo rrahje, i shërbeu Aushit, sepse ai u ul dhe shkruajti, tashmë, një novelë për dy vëllezërit dhe spitalin.

Për të përshkruar një femër të zhveshur, Aushi, ashtu siç bëjnë piktorët e vetmuar, paguante gra, që u kishin ndërprerë ndihmën sociale dhe për këtë shkak, e shkonin jetën në mjerim të plotë. Sapo zhvisheshin, ai u ngulte vështrimin dhe niste të shkruante.

Njëherë, kur njëra nga këto femra po qëndronte e zhveshur para tij, Aushi vuri re, që nuk i kishte pas prerë thonjtë e këmbëve, dhe veç kësaj, i vinte edhe nje erë e keqe nga sqetullat. Aushi e detyroi të priste njëherë thonjtë, pastaj të hynte e të lahej në dush, pasi nuk donte që t'i përshkruante në letër këto gjëra të pakëndëshme.

Njëherë tjetër, ai eci dhe ndaloi mu në mes të një rruge ku kishte shumë makina, dhe për më tepër lëviznin me shpejtësi. Ai deshi ta përplaste ndonjë makinë, që pastaj të shkruante një roman shumë tragjik, por ndodhi që shoferi i një kamjoni, frenoi mu para hundës së tij dhe kështu, ky projekt dështoi.

- O hu gardhi! - i thirri shoferi pasi uli xhamin e derës së makinës. - Si të erdhi kështu?! Ik më mirë e var veten, që të mos marrësh në qafë të tjerët.

Kurse para nja shtatë vjetësh, ai preku telin e korentit dhe gati shkoi për lesh. E dërguan në spital për të vdekur, por arriti të mbijetonte. Pastaj kur pas kësaj ndodhie u ul të shkruante, për çudi, atij nuk i kujtohej asgjë. Shkruajti vetëm një frazë: "Rryma, ah, kjo rryma e elektrikut"! Dhe ngeci. Nuk mundi të hidhte në letër as edhe një germë për bè. Shtatë vjet kanë kaluar dhe Aushi ka ngecur po tek ajo frazë: "Rryma, ah, kjo rryma e elektrikut"!

Aush Loshi qe, si të thuash, një dedektiv i letërsisë, një gjurmues të vërtetave të padiskutueshme, një spiun i stërvitur për të bërë zbulime të mëdha situatash reale. Një fotograf i paepur i mishmashit njerëzorë dhe i kapriçove, që sillnin ngaherë rastësitë e stisura. Në hapsirat mes fotografive, gjendej teksti, i gjithi me shkronja kapitale.

Por le të kthehemi sërish te ndodhia e asaj dite.

Të gjithë sa u gjendën aty, e panë shpirtin e Aushit: një si flakë e vobektë pranë hundës së tij, që luhatej të shuhej e nuk shuhej. Të pranishit nuk dinin ç'të bënin me të. Në një çast, u duk sikur u shua, sepse flaka e tij, erdh' e u zvoglua aq shumë sa memzi dallohej, por u shfaq sërish me një luhatje disi më të gjallërishme. Sa herë flaka e shpirtit të tij gjallërohej e ngrihej, fytyrat e njerëzve ngëzëllenin, zemrat mbusheshin me shpresën, që Aushi do ia hidhte edhe kësaj here. Ja edhe pak dhe Aushi do të ngrihej ndenjur e do të kërkonte të pinte, ta zëmë, një red bull për të marrë veten. Mirëpo, flaka e shpirtit të Aushit, i la pa mend të pranishmit. Ajo as nuk shuhej, as nuk gjallërohej në masën e duhur.

Telefonuan ambulancën dhe pritën e pritën, por ajo nuk erdhi. Telefonuan sërish, por ata të shërbimit thanë, që ambulanca ishte nisur, por kishte pësuar një difekt gjatë rrugës në ecja. Kësisoj kaloi shumë kohë, derisa të pranishmit nisën të mërziten. I hidhnin vështrime njëri-tjetrit në kërkim të një zgjidhje. Ato vështrime shprehnin pakënaqësi, mërzi dhe lodhje. Nuk kishin as kohë, as durim ta prisnin aq gjatë Aushin të vdiste... Në fund të fundit, ai një shpirt i vetëm ishte, një shpirt si miliarda shpirtëra të tjerë në botë. Nëse kishte për t'u shuar, le të shuhej shpejt; të dilnin nga kjo situatë dhe ata të flinin mendjen. Pastaj ca vite të mira i kishte në kurriz Aushi...

I hapën vend Tuxhar Topallit, që tha se mund t'ia ndiste sërish shpirtin duke i fryrë, ashtu siç i frymë zjarrit që të ndizet.

Me tu afruar pranë Aushit, që ishte shtrirë në dysheme, Tuxhari u ul në gjunjë, dhe si u mbush njëherë fort me frymë, i fryu aq fort flakës së shpirtit të tij, sa bashkë me frymën, nxorri nga goja edhe një mori stërkalash pështyme. Në fillim u dëgjua vetëm një si cingëritje; si ajo cingëritja kur nga një kusi e mbushur me kungull që vlon, bien stërkala uji në zjarr; pastaj u pa një luhatje e vogël e flakës dhe... Flaka vazhdonte të digjej, kësaj here, pakëz më e gjallëruar; a thua se i kishin hedhur vaj të djegur, nga ai që u a heqin makinave për t'u futur një tjetër. Pritën edhe dhjetë minuta me shpresën se Aushi do ngrihej, por ai nuk u ngrit.

Tuxhari i fryu sërish, kësaj here më fort; një herë, dy, tre, katër, shpejt e shpejt e papushim... Kur pa që nuk mundi t'ia dilte dot, ai tha:

- Për mendimin tim, ky është nga ata shpirtëra, që as nuk fiken as nuk ndizen. Po deshët ngrohuni në të sepse unë nuk i fry më.

U largua duke ecur mbrapsht dhe qëndroi në të njëjtin vend ku ndodhej më parë.

Liza Piluri, bëri një provë: afroi gishtin e saj tregues dhe preku flakën e vogël, që dilte nga vrima e hundës së Aushit.

- Uau! - ia bëri ajo ndërsa e tërhoqi shpejt gishtin. - Të përvëloka! Poetë si ky me shpirt kaq të zjarrtë, zor se gjenden në faqe të dheut.

Deshi ta prekte edhe njëherë duke afruar gishtin e dorës tjetër, por nuk ia mbajti.

U kthye nga zonja Kaleme e tha:

- Provoje, provoje edhe ti njëherë...

Zonja Kaleme nuk deshi ta provonte. Teksa vështronte flakën e shpirtit që dilte nga vrima e hundës së Aushit, lidhi e trembur duart nga prapa, u përtyp njëherë, pastaj tha:

- Nuk është nevoja të preket me gisht, moj Liza... Duket ashiqare që të përvëlon. A nuk e shikon, që është e kaltër si flakë oksigjeni?!

Akademiku Hashim Sholla u afrua sërish. Ai nisi të shpjegonte që flaka e shpirtit, nuk ishte si flaka e një zjarri të zakonshëm. Sipas tij, ajo ishte një flakë më tepër hyjnore, që ngohte, por nuk digjte, përndryshe njeriu do të bëhej shkrumb nga brenda. Dhe që të përligjte mendimin që shprehu, afroi gishtin e tij mu tek vrima e hundës së Aushit dhe preku flakën.

Duhet thënë, që akademiku Hashim Sholla, kishte një gisht të madh, të trashë, gjithë kallo. Këto kallo, atij ia kishin krijuar miliona shfletime, që ai u kishte bërë mijëra librave fletë për fletë.

- Shikoni! - tha ai ndërsa vazhdonte të mbante gishtin në flakë. - Nuk djeg, vetëm ngroh. Mirëpo pas disa çastesh, gishtit të trashë të Hashim Shollës, filloi t'i dilte tymi i kallove që nisën të digjeshin. Ai e tërhoqi shpejt, rrahu gjuhën për qiellze e tha:

- Ncëk, ncëk, ncëk...! Sa e çuditëshme!

- Eh, si digjet shpirti i poetit! - tha Liza dhe nxorri një ofshamë të gjatë.

Marin Dermeku, deshi të afrohej e të ndizte te hunda e Aushit llullën e mbushur me duhan, por zonja Kaleme nuk e la.

- Ju lutem shumë! - tha ajo disi e nervozuar. -Të mos e banalizojmë si fenomen. Kieni parasyshë, që kjo flakë kaq e ndritëshme dhe kaq përvëluese, buron nga shpirti i një poeti të madh, nuk buron nga një dru i ndezur shporeti! Ju lutem shumë!

Marin Dermeku u tërhoq i turpëruar.

U afruan dhe i frynë edhe të tjerë, një nga një, por pa rezultat.

- Mos u lodhni kot, - tha Tugjar Topalli. - Konkluzioni im numër dy më del, që ky është një shpirt me zjarr të pashuar.

Ato çaste, Liza Piluri, iu "hakërrye" Tushit me shumë dashamirësi:

- Po ti, more djalë, ç'më rri ashtu si i trembur?! Oj, ky! Pa mblidhi njëherë forcat dhe fry edhe ti, se je në moshën më të bukur. Nuk thonë kot "i riu si veriu"! O të ndizet, o të shuhet fare, sepse edhe kështu...

- Por unë..., - ia bëri Tushi si i zënë në faj. - Nuk kam asgjë tepër të tjerëve...

- Ec aty, ec..., - i tha Liza. - Nuk paske asgjë tepër të tjerëve ti...! Pa ulu dhe provoje njëherë se ndoshta mund t'ia dalësh!

Tushi u afrua disi me përtesë dhe ra në gjunjë pranë kokës së Aushit. Pastaj si u mbush njëherë fort me frymë, i fryu me fishkëllimë fiuuu.....

Me t'i fishkëllyer Tushi, flaka në fillim u zbeh, pastaj maja e saj u përkul mu si një pikpyetje e tek e mbramja u shua!

Sa hap e mbyll sytë, hija e mortit ra mbi të gjithë.

** Titulli është i redaksisë*

Rruga e Arbërit nr. 123
homazh

Më fal Floran!

Nga **SHAQIR SKARRA**

Kanë kaluar plot pesë muaj që atë ditë prilli kur gjama ndodhi e dhimbja e madhe nuk është larguar ende nga shtëpia jote, lotët nuk janë tharë e dera rri hapur duke pritur e përcjellë njerëz nga të gjitha viset shqiptare. Mua mikut e shokut të babait tënd, sot më ra ndërmend të shkruaj pak rreshta por që brenda kanë shumë dhimbje, shumë brengë, shumë mall. Më fal Floran, më fal! Ndjehem fajtor. Lotët ende nuk i janë tharë në sytë e nënës tënde, Shiretes. As gruas, Besmirës, as vajzave, megjithëse e vogla, Fjolla akoma nuk kupton gjë se çfarë i ka ndodhur. Gënjehet lehtë për mungesën tënde Floran. Ai që e ndien më shumë humbjen tënde pa dyshim që është babai, Jahe Delia. i a ke prerë krahët. Dije, Floran, se ka ndryshuar shumë dhe këtë ndryshim e ndjejmë edhe ne miqtë e shokët e tij. Nuk është si më parë. Buzëqeshja e dikurshme i ka ngrirë në buzë, flokët i janë thinjur dhe heshtja ka bërë vragë të thellë edhe në fytyrën e tij të plakur, ndoshta, para kohe. Por, ky qenka fati. E pranon dhe vetë se duhet t'i bindemi të gjithë. Askush nuk do të shpëtojë nga drapri i vdekjes, kush herët e kush vonë, por vdekja jote erdhi fare pa pritur, erdhi në një kohë që babai kërkonte shumë prej teje. Nëna të kishte dritë në sy. Gruaja mburrej me të drejtë për bashkëshortin model. Vajzat sa herë që ti mungoje e në qiell shfaqej ndonjë avion në fluturim, do të dilnin jashtë e do të bërtisnin të gëzuara:"Babi, u nis babi në fluturim!. E shokët dhe kolegët e tu thonë:" Në kujtesën tonë, gjithmonë në fluturim".

Data shënonte 6 prill 2016, dita e mërkurë. Thonë se dita e martë ka një orë të saj që ndjell ters, por jo e mërkura, por ja që ndodhi krejt ndryshe. Kishte kaluar ora 1.30 minuta e unë isha mbërthyer pas ekranit të televizionit, i cili po jepte emisionin:"Njerëz në fokus". Nuk më bënte përshtypje as dera që hapej e mbyllej vetë nga era, as zhurma e nipit, i cili po lozte me kukullat e tij të shumta e që dhomën e kishte bërë rrëmujë. Isha i përqëndruar aq shumë pas emisionit dhe debateve me të ftuarit në emision. As vetë nuk e di se si sytë, krejt pa dashje, më vajtën në cep të ekranit ku po jepej me titra lajmi i fundit. Një ngjarje e rëndë kishte ndodhur në Shkodër. Një helikopter i forcave ushtarake ishte rrëzuar dhe kishte rënë në liqenin e Shkodrës. Viktimat ishin kapiten Floran Delia e toger Donald Hoxha. As vetë nuk e di se pse për momentin mbeta, shtanga. Emri i Floranit se si më gjëmoj fort në kokë. Një emër i njohur, një emër i dashur, një emër që më krijoi një pështjellim, një lëmsh të madh në zemër. Po, ishte e vërtetë, nuk mund ti largohesha realitetit. Florani ishte djali i shokut tim të mirë nga Radomira, Jahe Delia. Bëra të kap telefonin e të formoja numrin e Jahes, por duart m'u drodhën e telefoni më ra në tokë. Nuk ishte nevoja të pyesja më shumë, të interesohesha tek të tjerët. Për fat të keq gjama kishte ndodhur. Florani kishte rënë në krye të detyrës së bashku me shokun e tij të ngushtë nga Kuçova, Donald Hoxha. Mbaruan në TV titrat dhe filluan lajmet në të gjitha mediat. Krye- lajm ky ishte, por tashmë filluan të flasin edhe për jetën e pilotëve që ranë në krye të detyrës.

Atë ditë të zezë prilli Jahe Delia ndodhej në shtëpi, ndodhej vetëm me gruan e tij Shireten e sapo kishte filluar të hante drekën. Kafshata e parë e bukës i mbeti në duar. Nuk ishte e mundur të largohej nga lajmi tragjik që po jepte televizioni. E pa qartë se djali i tij, Florani, nuk jetonte më. Aksidenti që ndodhi në Shkodër kishte qenë fatal për jetën e tij. Trupi nuk po i bindej e këmbët nëpër dhomë i lëkundeshin siç lëkunden degët e pemëve nga era në stinën e vjeshtës. E kuptoi tragjedinë që ndodhi në familjen e tyre edhe nënë Shiretja. Nuk kishte nevojë të vinte kush dhe t'i gënjente, mashtronte siç bëjnë shpesh në të tilla raste. Jo! Fatkeqësia i kishte gjetur të dy prindërit e mirë të Floranit. Dera e shtëpisë u hap kat e kat e njerëzit vërshuan si ortek. Erdhën jo vetëm komshinjtë, por nga ana e anës. Në fakt nuk ka vdekje të mirë, por kjo i kalonte përmasat e një vdekjeje njerëzore. Ishte një tragjedi me përmasa të mëdha. Florani kishte lënë nusen e re, Besmirën, tashmë veshur gjithmonë me rroba të zeza dhe tri vajzat e vogla: Jehona 11 vjeçe, Klea 9 vjeçe, e më e vogla Fjolla, 4 vjeçe.

Besmira ishte në punë atë ditë, mësuese për gjuhë –letërsi në shkollën e Farkës. Lajmi është si era, ecën më shpejt se sa e mendon. Ajo e kishte marrë vesh pikërisht në shkollë se çfarë i kishte ndodhur, ndaj shkuan para kohe dhe e sollën në shtëpi. Dy vajzat,Jehona e Klea vazhdonin mësimin pasdite. Ishin mësuar t'i çonte në shkollë gjysh, Jahja e t'i merrte në darkë përsëri. Por jo, atë ditë prilli u ndodhi ndryshe. Dikush tjetër i solli në shtëpi. E kuptuan, edhe pse të vogla, se diçka nuk shkonte, diçka kishte ndodhur, por nuk mundën të kuptonin gjë. Në shtëpi kur panë njerëzit e shumtë që hynin e dilnin, nënën e tyre Besmirën që qante e kishte veshur rrobat e zeza, kuptuan se tani e tutje nuk do të shkonin në shkollë me buzëqeshjen e ëmbël të babait të tyre, nuk do ti priste më tek dera e shtëpisë kur ishte pushim, nuk do ti thonin më "fluturim të mbarë", kur kishte fluturim. Florani kishte vdekur fizikisht por shpirtërisht do të jetojë gjithmonë në zemrat e tyre. Jehona është më e madhja nga vajzat. Ajo hera herës tashmë që e di se babi i mungon, shprehet por, vetëm me mamin kur janë të dyja bashkë. Nuk do që t'i lëndojë zemrat e plagosura të gjyshit dhe nënë Shyretes. "Herë-herë bie në pesimizëm, kur dëgjoj shoqet që thonë: "Më erdhi babi. Ma solli babi një dhuratë. Po unë pse të mos kem babi? Pse të më mungojë prania e tij fizike, përpos asaj shpirtërore që nuk ka për të munguar kurrë? Pse më iku aq shpejt? Pse më mërziti kaq shumë?

Por jeta qenka e tillë. Disa plaken shumë e disa të tjerë më pak. Babi im ishte nga ata që nuk u plak fare. Zoti e deshi ta merrte me vete të ri, të bukur, vital e të hijshëm, ashtu si kundër ishte i tillë në jetë!

Sa shpejt ikin ditët, aq më shumë më merr malli për babin tim të shtrenjtë. Më merr malli të dëgjoj zërin e tij të ëmbël e kumbonjës. Më mungon shumë tingëllimi i zërit të tij që e kishte njëlloj me atë të bilbilit. Eh, jeta e tilla qenka. Tani e tutje do të jem edhe pa babin tim"

Unë vetë nuk e kam patur fat ta njoh nga afër pilotin e talentuar, kapitenin Floran Delija. Jo, asnjëherë nuk jam takuar nga afër, nuk kam shkëmbyer as një përshëndetje, asnjë buzëqeshje, asnjë kafe nuk e kisha pirë me të. Unë e njoha nëpërmjet Jahes, babait të tij, nga thënjet e tij, nga fotot që na sillte për gazetën kur i kishte marrë gjatë fluturimeve me helikopter. Kështu e njoha unë pilotin Floran Delia, Dëshmorin e Atdheut, rënë në krye të detyrës. Ai ashtu siç ishte i dashuruar pas fluturimeve, ishte i dashuruar edhe me natyrën e bukur shqiptare ku nuk la objekt që shikonte nga qielli pa rrokur në aparatin e tij që nga Qafa e Buallit e deri në Qafë të Vasies, që nga lieqenet e Lurës e në Qafë të Murrës. Sidomos pamjet nga vendlindja, nga Radomira e tij e shtrenjtë, nga fusha e Korabit, nga masivet e gjipsit ishin në epiqendër të tij. Edhe ditën e fundit, ditën që fati e ndau përgjithmonë nga jeta, me helikopter mbi Radomirë kaloi. Fluturonte poshtë, sipër shtëpive të fshatit e përshëndetej me bashkëfshatarët e tij. Ishin mësuar edhe vetë banorët e Radomirës se sa herë do të fluturonte ndonjë helikopter poshtë fshatit të tyre e dinin se do të ishte Florani, ndaj linin çdo punë që kishin në duar dhe vazhdonin të përshëndeteshin me të. E përcillnin ashtu me sy deri sa helikopteri zhdukej matanë Qafës së Vasijes. Edhe ditën që ndodhi aksidenti kështu e përshëndetën dhe e përcollën me sy deri sa aeroplani u zhduk matanë kodrave e nuk dukej më.


Floran Delia

PO KUSH ËSHTË KAPITEN FLORAN DELIA, DËSHMOR I ATDHEUT?

Lindi më 16 tetor 1973 në fshatin e bukur Radomirë të Kalasë së Dodës. Shkollën fillore dhe atë tetëvjeçare i përfundon me rezultate të larta në vendlindje. Në vitin 1991 mbaron shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" në Tiranë me nota shumë të mira. Në vitet 1992-1996 vazhdon shkollën e aviacionit në Vlorë të cilën e përfundon me rezultate të larta dhe fill pas përfundimit të shkollës caktohet në Regjimentin e Rinasit duke fluturuar për herë të parë me aeroplanin Mig-15 dhe vetëm pak kohë më vonë do të kryente fluturime me sukses edhe me aeroplanin Mig-19.

Ashtu si mijëra e mijëra shqiptarë, edhe Florani nuk mundi që t'i shpëtojë valës së madhe të emigracionit.Vargut të gjatë të të rinjve që kërkonin një jetë më të mirë iu bashkua Florani dhe në vitin 1999 arriti në Angli ku punoi në punë të ndryshme deri në vitin 2003.

Sapo kthehet nga emigracioni paraqitet pranë Forcave Ajrore. Komanda, duke parë përgatitjen dhe kualifikimin e tij, e mori pilot pranë Regjimentit të Farkës ku ishin dislokuar helikopterët e Forcave ushtarake ajrore. Në fillim filloi të fluturojë me helikopter të tipit AB-206 dhe pastaj kalon komandant ekuipazhi pranë këtij helikopteri. Fluturon edhe me helikopterin tip BO-105.

Në vitet 2011-2012 komandant ekuipazhi pranë këtij helikopteri.

Pas disa trajnimeve e kualifikimeve si në Turqi, Kroaci, Itali,Sllovaki. Shkon edhe në Gjermani, ku u specializua për tipin e fundit me të cilin ndodhi edhe aksidenti fatal, EC-145.

Gjatë viteve që ka shërbyer pranë Forcave Ajrore është dekoruar me dy medalje shërbimi si dhe me medaljen e karrierës. Mbante gradën kapiten dhe ishte një ndër pilotët më të përgatitur në të gjithë Regjimentin e Farkës. Gjuhët e huaja ishin pasioni i tij. Shkruante e fliste rrjedhshëm anglisht dhe italisht.

Kapiteni Floran Delia, biri i Radomirës ishte në kulmin e karrierës së tij në pilotim. Kolegu i tij Bedri Kaloshi do të shprehet:"Edhe ne miqtë e shokët e tij e kemi të pa mundur të mësohemi me mungesën e Floranit. Humbja e tij ishte e madhe për familjen, shoqërinë, por edhe për Forcat Ajrore Shqiptare. Pilotët janë pasuri kombëtare. Jemi pak e një humbje që ndodh është e madhe dhe e pa zëvendësueshme. Dikur ishte një shkollë aviacioni në Vlorë. Sot nuk është më. Florani ishte njeri korrekt në punë, korrekt në shoqëri e gjithmonë i qeshur dhe i dashur me të gjithë. Fluturimi për të ishte diçka e zakonshme. i pëlqente qielli kur ishte në tokë me rrezet e diellit por dhe kur kishte vranësina, me yjet e shumta që ndriçonin dhe dritën e hënës vezulluese. i pëlqente toka kur ishte në fluturim me bjeshkët e pyjet e vendit tonë, me lulet e bukura dhe burimet e ujërave, me fshatra e qytete e nuk la rast që të mos e rrokte në aparatin e tij fotografik që e mbante gjithmonë me vete". Fluturimi për të ishte një ditë si ditët e tjera e zakonshme pune dhe shërbimi. Shpesh u tregonte edhe në shtëpi për ditën që kishte fluturim. Një ditë më parë bënin stërvitje dhe ditën e dytë kryenin fluturimin. Edhe atë ditë të 6 prillit, në mëngjes i tha babait se kishte fluturim. U ndanë të dy bashkë si baba me djalin duke e ditur se Florani do të kthehej në mbrëmje si gjithmonë nga një fluturim i bukur, me plot mbresa e mjaft fotografi të ndryshme.

E ku do ta mendonte Jahe Delia se po ndahej për herë të fundit me djalin? Si mund t'i shkonte ndër mend se do ia sillnin të vdekur në arkivol? Por ja që edhe kjo ndodhi.

(Vijon në faqen 23)

(Vijon nga faqja 22)

Erdhi në shtëpi atë natë prilli edhe Ministrja e Mbrojtjes zonja, Mimi Kodheli, erdhi si nënë, si nënë e dhembshur e për asnjë çast nuk i mbajti dot lotët. Erdhi shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë gjeneral Jeronim Baze, zv ministri i mbrojtjes Petro Koçi. Erdhën oficerë e komandantë të Regjimentit të Farkës, kolegë e shokë të Floranit. Erdhën kolegët e tij me lot në sy; Çimi, Bedriu, Eduardi, Ylberi, Denardi, Aureli. Erdhën të gjithë që dhimbjen për këtë humbje të madhe ta ndanin së bashku.

Po atë natë u mblodh dhe komisioni i posaçëm qeveritar ku kapiten Floran Delia e toger Donald Hoxha u shpallën Dëshmorë të Atdheut. Homazhet u bënë në Pallatin e Kongreseve e trupat e pa jetë të këtyre dy pilotëve dëshmorë u varrosën me ceremoni shtetërore në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut.

Kaluan pesë muaj nga ajo ditë e zezë prilli. Kalova një ditë rastësisht nga Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut. E pashë varrin tënd. Mbi të akoma nuk është vendosur pllaka e ftohtë e mermerit, as mbi varrin e shokut tënd Donaldit. Varret tuaja akoma janë të mbuluara me kurora me lule të freskëta që çuditërisht shtohen nga njerëz të njohur dhe pa njohur, që lahen vazhdimisht me lot. Dielli ishte në perëndim. Ashtu ishte dhe atë ditë prilli kur t'i ike nga kjo botë. Ti bëre gjithçka për Atdheun, fale dhe jetën tënde, dhe vetë shteti e shoqëria të ngritën në piedestal, të shpallën "Dëshmor të Atdheut "e ndaj po prehesh këtu tek monumenti Nënë Shqipëri. Unë që në fillim të kërkova falje, por tashmë më duket vetja paksa i çliruar nga detyrimet që kisha ndaj teje. Dibra që të lindi dhe rriti nuk e di kur do ta shlyejë borxhin që të ka. Ky borxh nuk varet në dorën time. Le të shërbejnë këto radhë edhe si një apel për Këshillin Bashkiak Dibër. Gjithmonë ka kohë për Dëshmorët e Atdheut që të vlerësohen.

NË KUJTIM TË DËSHMORËVE TË ATDHEUT

Në muajin gusht ku vapa arriti në pikun më të lartë, përfaqësues të shoqatës "Bijtë e Shqipes" në Filadelfia të Amerikës zbritën në aeroportin e Rinasit me një mision vërtet patriotik e atdhetar. Ata kishin vendosur që në prag të 15 vjetorit të saj si shoqatë në mes të shumë takimeve e aktiviteteve të tjera që kanë zhvilluar e vazhdojnë të bëjnë në Filadelfia, të organizonin një takim në Bazën Ajrore Farkë, në kujtim të dëshmorëve më të rinj të kësaj Baze që ranë para pak kohësh në krye të detyrës kapiten Floran Delia e toger Donald Hoxha.

Takimi u organizua me datën 5 gusht ora 11 ku të pranishëm ishin familjarë të dëshmorëve të atdheut, shokë, miq e koleg të tyre. Ndodhej dhe komandanti i regjimentit të Farkës zoti Kuto Hasani. Përfaqësues nga shoqata kishin ardhur kryetari i kësaj shoqate zoti Tajar Domi, zv kryetari i Forumit të ushtarakëve dhe antari i kryesisë së shoqatës zoti Haki Çollaku, kryetari i shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve të Aviacionit, zoti Kujtim Serani etj.Moderator i këtij aktiviteti ishte zoti Aleksandër Çela. Në Bazën e Forcave Ajrore të Helikopterëve në Farkë data 5 gusht ishte disi ndryshe.U mblodhën në kujtim të dëshmorëve më të rinj Floranit dhe Donaldit. Lot në sy e dhimbje në shpirt nga të gjithë të pranishmit. Këtij reparti i mungonin dy pilotë, dy djem të rinj, dy bij nënash. Edhe vetë komandantin e repartit gjatë fjalës së tij e tradhëtuan lotët. Mes të pranishmëve në sallë gjejmë edhe Jehona, Klea, e Fjolla e vogël që janë si princesha por që dinë të mbajnë fort lotët. Ka ardhur halla e Floranit,Siria me djemtë e motra Hasije me fëmijët nga Anglia e shumë e shumë të tjerë brenda e jashtë atdheut. Pasi uroi të pranishmit për këtë mirë se ardhje, komandanti Kuto Hasani i njeh të pranishmit me programin që do të zhvillohej në repart në kujtim të Dëshmorëve Floran Delia e Donald Hoxha. Në fillim të pranishmit qëndrojnë para stendës me një titull mjaft domethënës: "Në kujtesën tonë, ju përherë në fluturim" e cila ishte me fotot e Dëshmorëve të aviacionit të viteve të fundit.Pas saj jeshilojnë dy ullinj të mbjellë për dy dëshmorët e fundit, para tyre dy lapidar të vegjël me pllakatin ku shkruhen emrat e pikotëve Floran Delia e Donald Hoxha.

Në fjalën e tij kryetari i shoqatës "Bijt e Shqipes" Tajar Domi ndër të tjera tha:

Sot ata nuk jetojnë më dhe lanë shumë ëndra e dëshira të pa realizuara. Por të gjitha ata që i kanë njohur, kanë punuar me ta, familjarët e tyre, do të jetojnë gjithmonë me kujtimet e këtyre dy djemve që u ndanë nga kjo jetë në një moshë tepër të re, sapo e kishin nisur atë.. Tragjedia e asaj dite u ndje dhe u përjetua me dhimbje të madhe edhe nga ne bashkëatdhetarët tanë me banim në Filadelfia.

Në emër të atyre njerëzve shprehim ngushëllimet për familjarët e Floranit dhe Donaldit, për miqtë dhe shokët e tyre, për këtë humbje të madhe e të pa zëvendësueshme.Vlerësojmë shtetin shqiptar për vlerësimin që u bëri duke i shpallur "Dëshmorë të Atdheut".

Shoqata atdhetare kulturore "Bijtë e Shqipes, në qytetin e Filadelfias, përveç ruajtjes e trashëgimisë të gjuhës shqipe në brezin e ri, nëpërmjet shkollës shqipe "Gjuha jonë", ka në qendër të punës së saj, përkujtimin e ngjarjeve e figurave tona kombëtare. Në këtë kuadër, kryesia e kësaj shoqate, mbështeti nismën e Forumit të ish ushtarakëve shqiptar që është krijuar brenda kësaj shoqate për të përkujtuar me një organizim të veçantë të dy pilotët e ndarë nga jeta. Me këtë rast, kryesia e shoqatës atdhetare kulturore "Bijtë e Shqipes" në Filadelfia, në përputhje me statutin e saj, vendosi tu akordojë kapiten Floran Delia e toger Donald Hoxha "Çertefikatë Mirënjohje"(pas vdekjes) që shoqërohet me kokën e shqiponjës të cilat po i prezantojmë para jush.I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre".

Përshëndeti të pranishmit edhe Haki Çollaku i cili në fund improvizoj edhe vargjet:

"Si shqipe mali u ngjitët përpjetë,
Lamtumirë na thatë përjetë.
Lamtumirë Donlad Hoxha e Floran Delia.
Titullin Dëshmorë u dha Shqipëria"

Në fund një vizitë në zyrën e komandantit, ku ai flet me respekt jo vetëm për dy pilotët dëshmorë por për të gjithë trupën që ndodhen në repart.Është mjaft i komunikueshëm dhe tregon se sa të impenjuar janë pilotët në detyrë. "Ata mërziten vetëm kur i le pa fluturuar, janë të dashuruar shumë me qiellin, thotë komandant Kuto Hasani, ky vlonjat që para se të jetë komandant, është një prind e vëlla për çdo pilot.Ai i njeh çdo problem të tyre dhe i ngre atje ku duhet. Në fund të pranishmit u ndanë me kolegët e Dëshmorëve më të rinj të Atdheut Floranit dhe Donaldit, u ndanë me dhimbjen e madhe e mallin që ndiejnë të gjithë për humbjen e tyre. U ndanë por do të kthehen përsëri pranë këtij reparti se këtu do të jetojë gjatë kujtimi i pilotëve dëshmorë.

Por për përfaqësuesit e shoqatës "Bijtë e Shqipes" aktiviteti i tyre nuk mbaroi këtu. Ditën e nesërme u nisën edhe në Kuçovë, në familjen e pilotit të rënë në krye të detyrës së bashku me Floranin, Donald Hoxha. Një pritje e madhe, emocionuese e herë -herë dhe lotët nuk mund t'i fshihnin. Së bashku me Tajarin, Hakiun e Kujtimin kishte ardhur edhe Jahe Delia, babai i Floranit.Tek porta e shtëpisë në Kuçovë i pritën Vesel Hoxha, babai i Donaldit së bashku me kunatin, Shyqyriun, gruan e tij, motrën si dhe djalin e vajzën. Ishte një pritje siç priten njerëzit e afërm, të njohur prej vitesh. Në fund, Vesel Hoxha nuk i la mysafirët e respektuar pa bërë një vizitë në qytetin e Beratit, në kalanë e këtij qyteti e pastaj një drekë miqësore tek lokali "Qafa e Mullirit".Kafen e fundit e pinë në Ura –Vajgurore ku dhe u ndanë, u ndanë për t'u takuar sërish me njeri tjetrit se tashmë janë djemtë e tyre, "Dëshmorët e Atdheut" që do t'i mbajnë përjetësisht këto dy familje të bashkuara.

I kishte hije fjala dhe pritja

Shefki Ramadan Devës i kishte hije fjala dhe pritja. Ai gjatë gjithë jetës qe i lidhur ngushtë me njerëzit dhe vendlindjen.U shërbeu atyre me përkushtim e devotshmëri.

Shefki Deva lindi në vitin 1943 në fshatin Hurdhë-Muhurr të Dibrës në një familje me tradita të spikatura bujarie dhe atdhetarie, e cila gjatë gjithë rrjedhave të historisë punoi dhe shërbeu duke shpalosur vlera atdhetarie, patrotizmi, trimërie, bujarie, besnikërie dhe pune.

Veçanërisht gjatë Luftës Nacionalçlirimtare familja e tij u shndërrua një nga bazat e para të kësaj lufte në Dibër. Ajo strehoi shumë personalitete të asaj kohe, midis tyre Haxhi Lleshin, Hysni Kapon etj. Gjyshi i tij Llan Deva vuri gjithçka të tij në shërbim të luftës për çlirimin e atdheut. Ai i dha asaj edhe djalin e tij, Ramadan Devën, i cili në moshë fare të re ra në fushën e betejë, për të mos u harruar kurrë, si dëshmor i atdheut. Ramadani ra si trimat e siç u kishte hije burrave të Dibrës, por la në pikëllim të thellë nënën dhe babain. E vetmja shpresë ishte djali i vetëm i vogël, dy vjeç, Shefkiu.

Nëna e Shefkiut, Nailja, qëndroi si burrëreshë duke punuar dhe edukuar djalin e vetëm Shefkiun. Edhe sot kujtohet e nderohet si grua e ndershme, me bujari e urtësi.

Shefkiut i erdhi jeta shumë e brishtë. Të dy prindërit i vdiqën shpejt dhe ai u rrit e u burrërua në shtëpinë e madhe të Devajve së bashku me Rustemin, si dy binjakë, që gjatë gjithë kohës e deshën, e ndihmuan dhe e mbështetën njëri-tjetrin tamam si vëllezër të mirë e të denjë, pavarësisht se në realitet ishin kushërinj të parë.

E rëndësishme qe se Shefki Deva edhe pse me vështirësi dhe me një tufë fëmijë, u qëndroi besnik dhe ruajti e çoi më tej traditat e të parëve të tij. Ai së bashku me bashkëshorten lindi dhe rriti 7 fëmijë, 5 djem dhe 2 vajza, të sjellshem, punëtorë dhe te gjendur. Të gjithë aktualisht janë rritur, kanë krijuar familjet e tyre dhe janë bërë me fëmijë. Secili prej tyre ka bërë vend mirë dhe gëzon respektin e komuniteteve ku banojnë e jetojnë.

Tashmë Shefkiu kishte filluar vitet e pleqërisë, një pleqëri të mbarë dhe të gëzueshme, me gjendje të mirë ekonomike, me syrin plot me fëmijë, reja, nipër e mbesa që i desh dhe e donin me gjithë shpirt. Pikërisht tani që ai bënte një jetë të kamur, gëzonte një autoritet të plotë në familje dhe në fshat e më gjerë, veçanërisht si pasardhës veterani, familje dëshmori dhe si pensionist aktiv u sëmur rëndë. Kaloi një paralizë, ra në agoni dhe për pak



Shefki Deva

ditë, më 28 korrik 2016 zemra e tij pushoi së rrahuri.

Qe shumë i shkathët dhe i gjendur për këdo e veçanërisht për njerëzit në nevojë. Punoi me plot vrull e pasion me të rinjtë për idealet e larta dhe traditat e mira të popullit tonë dhe si pensionist aktiv në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të kësaj grup-moshe. Për këtë edhe është nderuar me titullin e lartë "NDERI I ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LANÇ-it DIBËR"

Dëshmi e vlerave dhe reputacionit të tij qe edhe organizimi i cerominisë së lamtumirës ku pati një pjesëmarrje të madhe. Iu bënë të gjitha nderet si nga familjarët, bashkëfshatrët dhe të afërmit.

Nderuan me pjesëmarrjen e tyre ish- ambasadorët e Shqipërisë në Kinë, shkëlqesitë: Mehmet Elezi, Maxhun Peka dhe Kujtim Xhani, kjo edhe falë punës e ndihmesës së dhënë nga djali i Shefkiut, Ramadan Deva, punonjës edhe tani në atë ambasadë.

Shefkiut i pati hije fjala, ndenja dhe puna. Vdekja e tij qe e papritur, pasi ai qe shumë i gjallë e aktiv dhe pati akoma shumë gjëra për t'i dhënë komunitetit ku banonte, por edhe Organizatës së Veteranëve, Familjeve të Dëshmorëve dhe Shoqatës "Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë"

I paharruar qoftë kujtimi i Shefki Devës! U preftë në parajsë!

FAIK XHANI
Kryetar i Shoqatës "BPPSH"

NGUSHËLLIM

Redaksia e gazetës i shpreh ngushëllimet mikut dhe bashkëpunëtorit tonë, z. Ali Hoxha, për ndarjen e papritur nga jeta të bashkëshortes së tij, Suzana!
I qoftë dheu i lehtë!

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

Abdi Baleta, Abdi Shehu, **Abdurahim Ashiku**, Abdyl Koleci, Adela Halo, **Adem Bunguri**, Adi Darsi, Adrian Blackledge, Afrim Karoshi, Agim Baçi, Agim Boba, Agim Çadri, **Agim Deva**, Agim Gjini, Agim Kaba, Agim Kasa, Agim Shenjatari, Agim Vinca, Agron Sela, **Agron Tufa**, Agron Xhagolli, Agustin Gjinaj, Ahmet Çaushi, Ahmet Kamberi, Ahuna Përlleshi, Albert Vataj, Albert Zholi, Aleks Minga, Aleksandër Cipa, Ali Hoxha, Ali Koçeku, Ali R. Berisha, Alma Mile, Andi Balla, Andon Andoni, Aneta Cali, Aqif Ademi, Aqif Karaj, Aqif Xhemi, Arbana Qorri-Deda, Arben Muka, Arbër Lleshi, Ardian Reçi, Ardit Selami, Ardita Abdiu, Aria Sukniqi, Arian Avrazi, Arian Kadiu, Ariola Lami, Arjana Tollja, Arjeta Tafçiu, Armond Duraku, Arqile Teta, Arsim Kolari, Artan Gjyzel Hasani, Artan Hoxha, Artan Lame, Arthur Nelsen, Artin Spahiu, Astrit Balliu, Astrit Gjunkshi, Astrit Hoxha, Atli Dema, Avni Alcani, Axel Kronholm, Baftjar Gazidede, Bajram Hyseni, Bajram Xhafa, Bardhyl Agasi, Bardhyl Berberi, Bardhyl Marku, Bardhyl Xhama, Bashkim Alarupi, Bashkim Lami, **Bashkim Lleshi**, Bashkim Rama, Bedri Tahiri, Begzad Baliu, Behar Gjoka, Ben Andoni, Bena Kërluku, Beqir Ajet Shehu, Beqir Sina, Bernard Zotaj, Besnik Alku, Besnik Rama, Blerim Lazimi, Bleta Qormemeti, Bujar Kapexhiu, **Bujar Karoshi**, Bujar Leskaj, Bujar Plloshtani, Bujar Vitija, Dali Horeshka, Dali Noka, Dali Tërshalla, Dalip Greca, Danjel Bica, Dashmir Zace, Dashnor Kaloçi, Daut Shehi, Dedë Llesh Doçi, **Defrim Methasani**, Dejang Nova, Denis Lushi, Destan Rama, Dhimitër Shembari, Dhori Qirazi, **Dionis Xhafa**, Dita Tona, Dragash Kotorani, Driton Bocku, Dritan Murrja, Drite Ademi, Driton Zenku, Dukagjin Hata, Dylbon Reçi, Edibe Selimi - Osmani, Edison Balla, Edison Ypi, Edita Haxhymeri, Edmond Hasani, Edmond Zhulali, Eduard Abazi, Eduard Ilnica, Elliot Hasan Moglica, Elmaz Lala, Elona Mazari, Elvana Zaimi, Emrie Skuka, Engjëll Celibashi, Engjëll Musai, Enver Halili, Enver Hysa, Enver Kaloshi, Eqrem Basha, Eralda Skarra, Erisa Saraci, Ermir Dizdari, Ermïr Hoxha, Ermira Isufaj, Ermira Shehu, Esat Ruka, Eshref Ymeri, Esmeralda Bica, Esmeralda Ilnica, Eva Ohrai, Eva Zaimi, Evi Mertani, Fadil Bugi, Fadil Frenci, Faik Xhafa, Fatmir Kaba, Fatbardh Gera, Fation Pandovski, Fatmir Delishi, Fatmir Minguli, Fatmir Terziu, Fatmir Zhuzhi, Fatos Baxhaku, Fehmi Lleshi, Fejzulla Gjabri, Femi Sufaj, Ferit Fixha, Fitim Dika, Flamur Hadri, Flora Nikolla, Florika Bushi, Gafur Muka, Gafur Zota, Gafur Zoto, **Gazmend Kërkuti**, Genc Melonashi, Genci Luarasi, Genta Nishica, Geri Selenica, Gëzim Alpion, Gjergj Marku, Gjergji Mima, Gjokë Beci, Gjon Fierza, Gjon Ndreja, Grehans Uka, Hajredin Toca, Hajri Mandri, Hajri Shehu, Hajrush Mani, Haki Duka, Haki Kola, Haki Përnezha, Halil Rama, Halil Robi, **Halil Teodori**, Hamdi Hysuka, Hamdi Skeja, Hamit Taka, Hamit Vata, Hane Burnett, Hasan Leka, Hasan Lleshi, Hasan Pasha, Hekuran Vladi, Hilë Llanaku, Ilyqmet Qorraj, **Hysen Likdisha**, Hysen Mitku, Hysen Repa, **Hysen Uka**, Hysni Bruci, Hysni Stafasani, Ibrahim Egriu, Ibrahim Kolari, Ibrahim Milushi, Ida Nurçe, Idriz Xhomara, Ilir Krosi, Ilir Sinanaj, Ilir Spata, Ilirjana Sulkuqi, Iljaz Bobaj, Iljaz Kaca, Ilmi Dervishi, Ina & Erta Disha, Ina Xhaferi, Inva Halili – Kuhn, Isa Halilaj, Islam Cani, Islam Çenga, Islam Sharofi, Ismail Hysa, Isuf Miho, Isuf Salla, Iva Cipuri, Ivzi Çipuri, Jahe Delia (Selmani), Jani Thomai, Jera Isakaj, Jorgji Muzaka, Jorgo Bulo, Kadri Dauti, Kamber Farruku, Kastriot Çaka, Kozeta Kozeta Zela, Klara Kodra, Kosmare Ollogu, Kristo Zhaklalliu, Kristofor Bedulli, Kujtim Bozizi, Kujtim Osmani, Laura Peparaku, Lavrant Mara, Lavderim Shehu, Limon Hoxha, Lindita Çaku, Lisen Bashkurti, Llazar Semini, Lumi Dedaj, Lulzim Çoku, Lutfi Hanku, Lutfi Turkeshi, Mahir Jangulli, Mahmud Hysa, Majlinda Hoxha, Malvina Shehi, Marin Mema, Marius Dobrescu, Mark Tirta, Martin Cukalla, Mehdi Dema, Mehmet Dume, Melsi Tafa, Mendu Dema, Mentas Nasufi, Mentor Hoxha, Meral Ismaili, Mersin Hoxha, Metodija Velevski, Metush Skeja, Mevlud Buci, Mexhit Prençi, Mhill Velaj, Miftar Fana, Mimoza Erebara, Mimoza Shqeria, Mirela Hysa, Mira Ymeraj, Miran Tafa, **Miranda Goleci**, Musa Sula, Murvet Lala, Moisi Murra, Molnar Kolaneci, Monika Stafa, Muhamet Bitri, Murat Gecaj, Murat Koltraka, Musa Kraja, **Musa Riçku**, Mustafa Tola, Muzafer Korkuti, Myhyr Hoxha, Myslim Islami, Nadire Skënderi (Murra), Naim Berisha, **Naim Plaku**, Naim Zoto, Namik Selmani, Naxhi Hasa, Ndue Dedaj, Nefail Spahiu, Neki Feta, Neki Kaloshi, Nerilda Meda, Nexhi Baushi, Nexhmije Mehmeti, Nikoll Kola, Nikolla Madzinaj, Noli Ca Kaja, **Nuri Abdiu**, Nuri Koleci, Odise Plaku, **Osman Xhili**, Pajtim Përnezha, Pandeli Koçi, Perikli Jorgoni, Perparim Luca, Perparim Spahiu, Perparim Teneqini, Peti Hrobi, Petrit Dunga, Petrit Fetahu, Petro Luarasi, Pjetër Jaku, Qamil Sula, Qazim D. Shehu, Qazim Hata, Qazim Prejsi, Qemal Skendo, Qenan Hasani, Qeram Cibaku, **Rakip Suli**, Ramadan Ajazi, Ramadan Ndreka, Ramazan Biba, Ramazan Buci, Ramazan S. Ilnica, **Ramiz Gjini**, Ramiz Lushaj, Ramiz Zekaj, Rasim Buci, Renato Totraku, Resul Bendo, Rexhep Doda, Rexhep Ndreu, **Rexhep Torte**, Rezehana Hysa, Rifat Malaj, Robert Reci, Roland Çene, Roland Zisi, Rovena Vata, Rozi Tushaj, Rrenzi Noteri, Rrezarda Biba, Rustem Dreva, Ruzhdi Lala, Sabri Veseli, Sadik Lala, Samir Shaka, Sakip Cami, Sali Ajazi, Sali Bushi, Samet Zagradi, Sami Milloshi, **Sashenka Ndreka**, Sazan Goliku, Sazan Guri, Sefedin Shabani, Sefulla Kata, Sejdi M. Hashi, **Selman Mëziu**, Shaban Bitri, **Shaban Sinani**, **Shaqir Skarra,** Shefki Aliti, Shefqet Hoxha, Shehat Cami, Shehat Marku, Shemsi Daci, Shemsi Manjani, Shemsi Prençi, Sherif Delvina, Shinasi Rama, Shkelzen Lusha, Shkëlqim Shehu, Shpëtim Hatipi, Shpend Topolla, Shpetim Cami, Shpëtim Hyka, Shpëtim Pollozhani, Shuaip Haxhiu, Shuaip Haxhiu, Skënder Minxhozi, Sokol Çobo, Sokol Demaku, Spiro Xhavarra, Srecko Sekeljic, Stephen Scheartz, Suat Saqipi, Suela Lala, Sulejman Borova, Sulejman Tomçini, Syrja Stafa, Tefik Jegeni, Tefik Skera, Tefta Cami, Tefta Nuredini, Thanas Feka, Theodhori Karaj, Ulkie Sinani, Ullmar Qvick, Valbona Zunçe, Valeria Dedej, Valmir Gashi, Valter Shtylla, Vehbi Bajrami, Vehbi Hoti, Veip Proda, Veli Vraniçi, **Vesel Hoxha**, Vezir Muharremaj, Virion Graçi, Viron Kona, Vita Koja, Vojsava Leka, **Xhafer Martini**, Xhafer Seiti, Xhavit Deda, Xheladin Çelmeta, Xhelal Luca, Xhelal Marku, Xhelal Roci, Xhelal Zejneli, Xhelil Cibaku, Xhemail Ali Peci, Xhemal Domi, Xhemal Mato, Xhezair Abazi, Ylber Nuredini, Ylli Molla, Ylli Prapa, Ymer Keta, Ymer Stojku, Zabit Lleshi, **Zaim Elezi**, Zaim Korsi, Zamira Gjeleshi, Zef Çoba, Zejnel Sula

ATA E PREMTUAN NDËRTIMIN E RRUGËS SË ARBRIT POR NUK E MBAJTËN FJALËN. NË PUNUAM SË BASHKU PËR GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT" DHE E NDËRTUAM PËRMES LIRISË SË FJALËS DHE MENDIMIT, ME PËRKUSHTIM DHE DASHURI.

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

Klinika Mjekësore
"VENIS"

Klinika mjekësore "VENIS" është klinika e parë private e Shëndetit Mendor në Shqipëri, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një aktivitet i tatueshëm.

Në klinikën "VENIS" ofrohet një shërbim i standarteve bashkëkohore si përsa i përket diagnostikimit dhe opsioneve të trajtimit mjekësor jo vetem me skemat e mjekimeve më të reja me barna por dhe me aplikimin e terapisë biologjike të elektrokonvulsoterapise ECT-Thymatron IV (Teknologjia më bashkëkohore), për trajtimin e pacientëve, te të cilët trajtimi i mëparshëm me barna nuk ka dhënë rezultatet e duhura.

1. **DIAGNOSTIKIM**. Procesi i diagnostikimit të çrregullimeve psikologjike apo psikiatrike realizohet pas një ekzaminimi të kujdesshëm nga specialistët e shëndetit mendor të cilët janë psikiatrit ose psikologët klinikë.
2. **TRAJTIM I DEPRESIONEVE REZISTENTE.** Procedura e ECT-së është një procedurë që realizohet vetëm në klinikën "VENIS" në Shqipëri dhe në trojet e tjera shqiptare.
3. **TRAJTIM MJEKËSOR.** Në klinikët tonë ruhet privatësia e individit, respektohen dhe mirëkuptohen orientimi seksual, përkatësia etnike, gjinore, apo preferencat fetare.
4. **KONSULENCË PROFESIONALE LIGJORE.** Klinika mjekësore "VENIS" ju ofron informim dhe ndihmë konkrete ligjore mbi të drejtat e pacientëve.

MOS KINI PARAGJYKIME! Sa më herët të kërkohet ndihma e specializuar, aq më shpejt trajtohen çrregullimet e çdo lloji.

"Venis" ju ofron mbështetjen e duhur.
Klinika ofron shërbimet e saj vetëm në ditët e javës
Orari: 08:00 - 16:00 E Shtunë, E Diel dhe Festat zyrtare: PUSHIM
Vizitat kryhen me planifikim paraprak.
Kontakt: Sekretaria: **04 2400 669** dhe **068 23 96287**
E-mail: **sadikhlala@gmail.com**

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603